Deloitte.

EITI Extractive Industries Transparency Initiative
ALBANIA

Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse në Shqipëri

Raporti për vitin 2016

Shkurt 2018

Deloitte Audit Albania
sh.p.k
Rr. Elbasanit.
Pallati poshte Fakulteti
Gjeologji- Miniera
Tirana, Albania

Tel: +355 4 45 17 920
Fax: +355 4 45 17 990
www.deloitte.al

Grupi Ndërinstitucional i Punës
Ministria e Energjisë dhe Industrisë
Blv. "Dëshmorët e Kombit"
Tiranë, Shqipëri

Raport mbi gjetjet faktike – mbledhja dhe rakordimi i flukseve të parasë

Ne u angazhuam për të kryer procedurat e rëna dakord me ju në lidhje me rakordimin e flukseve të parasë nga aktivitetet e sektorit të naftës dhe gazit, sektorit minerar dhe sektorit të hidro-energjisë si dhe përpilimin informacionit kontekstual si pjesë e zbatimit të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse ("NTIN" ose "EITI") në Shqipëri për vitin 2016.

Ne e kryem punën tonë në përputhje me Standardin Ndërkombëtar për Shërbimet e Lidhura ("SNSL" ose "ISRS") 4400 "Angazhime sipas procedurave të rëna dakord në lidhje me Informacionin Financiar", publikuar nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve ("FNK" ose "IFAC").

Procedurat tona janë listuar në kapitullin 9 të këtij raporti. Gjetjet tona janë paraqitur në kapitullin 10 të këtij raporti dhe në shtojcat e tij siç tregohet në kapitullin 9.

Për shkak se procedurat e rëna dakord nuk përbëjnë auditim apo rishikim sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit apo Standardeve Ndërkombëtare për Angazhimet e Rishikimit, ne nuk shprehim asnjë siguri mbi informacionin financiar të paraqitur në këtë raport, përfshirë pagesat e raportuara nga shoqëritë e licencuara apo institucionet qeveritare. Informacioni i paraqitur në raportin tonë, ose informacioni i dhënë nga shoqëritë e licencuara apo institucionet qeveritare, nuk ka qenë objekt i procedurave të kontrollit apo verifikimit, përveçse kur në raport shprehet ndryshe. Nëse do të kishim kryer procedura shtesë, auditim apo rishikim sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit apo Standardeve Ndërkombëtare për Angazhimet e Rishikimit, mund të ishin identifikuar apo raportuar çështje të tjera.

Raporti EITI për vitin 2016 bashkëngjitur përbëhet nga njëmbëdhjetë kapituj që, ndër të tjera, paraqesin informacion mbi rregullimin dhe veprimtarinë e industrisë, procedurat për përpilimin dhe procesin e rakordimit dhe gjetjet e lidhura me të, si dhe mësimet e nxjerra nga procesi rakordimit për këtë vit dhe përmbledhjen e rekomandimeve.

Informacioni i paraqitur në kapitujt 1 deri në 6 dhe informacioni tjetër i paraqitur në raport përtej pagesave pjesë e rakordimit dhe procedurave tona, është mbledhur kryesisht nga EITI Shqipëri në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore në Shqipëri, shoqërinë Albpetrol, dhe Shërbimin Gjeologjik Shqiptar. Ne nuk kemi kryer procedura për të verifikuar plotësinë dhe saktësinë e informacionit të paraqitur në këto kapituj.

Qëllimi i këtij raporti është të përmirësojë transparencën në industrinë e naftës dhe gazit, atë minerare dhe të hidro-energjisë. Procedurat tona nuk janë hartuar për të identifikuar mashtrime ose gabime të bëra nga shoqëritë e licencuara dhe institucionet qeveritare.

15 shkurt 2018
Tiranë, Shqipëri

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touche Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see http://www.deloitte.com/al/about for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touche Tohmatsu Limited and its member firms.

©2016 Deloitte Audit Albania

Përmbajtja

Përmbajtja 4
Lista e tabelave, grafikëve dhe figurave 5
Përmbledhje ekzekutive 7
1. Hyrje 8
2. Pamje e përgjithshme e industrisë nxjerrëse dhe sektorit të hidro-energjisë në Shqipëri 10
3. Sektori i naftës dhe gazit 20
4. Sektori minerar 53
5. Sektori i Hidro-Energjisë 76
6. Alokimi i të ardhurave 95
7. Cilësia e të dhënave, siguria dhe raportimi 98
8. Pamje e përgjithshme e flukseve të raportuara dhe e shoqërive raportuese 110
9. Qasja, metodologjia dhe puna e kryer 114
10. Rezultatet e rakordimit 119
11. Komente dhe rekomandime 127
Fjalor dhe shkurtime 143
Shtojca 1 – Rakordimi i detajuar i Sektorit të Naftës dhe Gazit 145
Shtojca 2 – Rakordimi i detajuar i Sektorit Minerar 149
Shtojca 3 – Rakordimi i detajuar i Sektorit Hidroenergjetik 170
Shtojca 4 - Përmbledhje e aktivitetit të kërkimit në Shqipëri 174
Shtojca 5 – PSA e dhëna dhe transfertat në kërkimin dhe prodhimin e naftës dhe gazit gjatë dekadës së fundit 175
Shtojca 6 – Pasqyrat financiare, raportet e auditimit dhe raporti i sigurisë së EITI 184
Kontaktet 190

Lista e tabelave, grafikëve dhe figurave

Lista e tabelave

Tabela 1 – Të ardhurat e Shtetit nga sektori nxjerrës dhe hidro-energjia 13
Tabela 2 – Rezervat gjeologjike dhe të rikuperueshme të naftës bazuar në studime të viteve 1985-1990 dhe prodhimi kumulativ i naftës deri në 2016 21
Tabela 3 – Shoqëritë e naftës të angazhuara në aktivitete eksploruese gjatë dekadës së kaluar 23
Tabela 4 - Faktet kyçe në lidhje me prodhimin dhe eksportet e naftës në 2016 24
Tabela 5 - Shoqëritë e naftës të angazhuara në prodhimin e naftës dhe gazit gjatë dekadës së fundit 26
Tabela 6 - Të dhënat financiare kryesore të Albpetrol 38
Tabela 7 - Përmbledhje e ankandeve të organizuara 2013 – 2016 42
Tabela 8 - Përmbledhje e shitjeve të naftës së Albpetrol 2013-2016 42
Tabela 9 - Krahasimi i shitjeve të naftës të raportuara nga Albpetrol me pasqyrat financiare të audituara 43
Tabela 10 - Të ardhurat kryesore nga sektori i naftës 46
Tabela 11 – Përfshirja e Qeverisë Shqiptare në sektorin e minerar 53
Tabela 12 – Aktiviteti minerar 55
Tabela 13 – Afatet dhe sipërfaqet për lejet minerare 63
Tabela 14 – Të ardhurat kryesore nga sektori minerar 70
Tabela 15 – Renta e zbatuar për mineralet 71
Tabela 16 - Të dhëna kryesore financiare të shoqërive shtetërore 80
Tabela 17 –Vlera e krijuar nga prodhimi, furnizimi, transmetimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike 88
Tabela 18 - Të ardhurat kryesore nga sektori hidro-energjisë 89
Tabela 19 – Renta e mbledhur dhe shpërndarë gjatë vitit 2016 91
Tabela 20 – Rakordimi i Transfertës Kombëtare të Rentës Minerare 92
Tabela 21 – Lista e Transfertave Kombëtare të Rentës gjatë 2016 93
Tabela 22 – Rezultatet e rakordimit për vitin 2016 116
Tabela 23 - Përmbledhja e rakordimit të pagesave nga sektori i naftës dhe gazit në vitin 2016 117
Tabela 24 - Përmbledhja e rakordimit të pagesave nga sektori i naftës dhe gazit – sipas llojit të të ardhurave 117
Tabela 25 - Përmbledhja e rakordimit të pagesave nga sektori minerar 119
Tabela 26 - Përmbledhja e rakordimit të pagesave nga sektori minerar – sipas llojit të të ardhurave 119
Tabela 27 - Përmbledhja e rakordimit të pagesave nga sektori i hidro-energjisë në vitin 2016 121
Tabela 28 - Përmbledhja e rakordimit të pagesave nga sektori i hidro-energjisë – sipas llojit të të ardhurave 121
Tabela 29 - Përmbledhja e rakordimit të pagesave nga Albpetrol në Buxhetin e Shtetit në vitin 2016 123
Tabela 30 - Përmbledhja e pagesave arkëtuar nga Albpetrol në vitin 2016 123
Tabela 31 – Pagesat sipas subjekteve – nafta dhe gazi 142
Tabela 32 –Ndarja e Prodhimit të naftës 142
Tabela 33 - Renta minerare në shitjet brenda vendit 143
Tabela 34 - Renta minerare në eksport 143
Tabela 35 – Bonuset e Nënshkrimit 143
Tabela 36 – Penalitet Tatimore 143
Tabela 37 – TVSH 144
Table 38 – Tatimi mbi fitimin 144
Tabela 39 – Pagesat për sigurime shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimi mbi të ardhurat personale 144
Tabela 40 – Të tjera pagesa ndaj Shtetit 145
Tabela 41 – Pagesa të tjera – Pushteti Vendor 145
Tabela 42 – Lista e shoqërive në sektorin e naftës 145
Tabela 43 – Pagesat sipas Subjekteve – sektori minerar 146
Tabela 44 - Renta minerare – shitjet brenda vendit 149
Tabela 45 - Renta minerare – në eksport 151
Tabela 46 – Tatimi mbi fitimin 153
Tabela 47 – Pagesat për sigurime shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimi mbi të ardhurat personale 155
Tabela 48 – TVSH 155
Tabela 49 – Tatimi mbi dividentin 159
Tabela 50 – Penalitetet Tatimore 160
Tabela 51 – Pagesa te tjera -Shteti 162
Tabela 52 – pagesa te tjera –Pushteti Vendor 163
Tabela 53 – Lista e shoqërive në sektorin minerar 164
Tabela 54 – Pagesat sipas Subjekteve – hidro-energji 167
Tabela 55 – Tarifa koncesionare 167
Tabela 56 – Tarifa Rregulluese 168
Tabela 57 – Tatimi mbi fitimin 168
Tabela 58 – Penalitetet Tatimore 168
Tabela 59 – Pagesat për sigurime shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimi mbi të ardhurat personale 169
Tabela 60 – TVSH 169
Tabela 61 – Pagesa të tjera-Shteti 170
Tabela 62 - Pagesa të tjera-Pushteti Vendor 170
Tabela 63 – Lista e shoqërive në sektorin e hidro-energjisë 170
Tabela 64 – Përmbledhje e aktivitetit të kërkimit në Shqipëri 171
Tabela 65 – Lista e PSA-ve të dhëna dhe transfertat në kërkimin dhe prodhimin e naftës dhe gazit gjatë dekadës së fundit 172
Tabela 66 – Informacion mbi të dhënat e raportuara nga subjektet raportuese dhe dhënien e sigurisë për pagesat e raportit EITI 181

Lista e grafikëve

Grafiku 1 - Prodhimi në milionë Dollar në 2016	7
Grafiku 2 - Pagesat e rakorduara në miliard Lek	7
Grafiku 3 – Kontributi i energjisë dhe burimeve në PBB në %	10
Grafiku 4 – Eksportet nga industria nxjerrëse ndaj totalit të eksporteve	10
Grafiku 5 – Eksportet nga industria nxjerrëse sipas mineraleve	10
Grafiku 6 - Prodhimi historik i naftës 1993-2016	24
Grafiku 7 – Prodhimi sipas fushave naftëmbajtëse	24
Grafiku 8 - Prodhimi i Naftës Bruto në 2016	24
Grafiku 9 - Eksportet e naftës bruto 2011-2016	31
Grafiku 10 - Punësimi dhe prodhimi në sektorin e naftës 2011 - 2016	34
Grafiku 11 -Punësimi në sektorin e naftës 2011 - 2016	34
Grafiku 12 - Ndarja e Prodhimit alokuar Albpetrol 2011 - 2016 (ton'000)	48
Grafiku 13 -Të ardhurat e AKBN-së nga Marrëveshjet Hidrokarbure (2011-2015) në mijë USD	48
Grafiku 14 – Ndarja e të ardhurave nga sektori i Naftës	48
Grafiku 15 - Bonuset e mbledhura nga Albpetrol 2011-2016 (ne USD'000)	49
Grafiku 16 - Lejet sipas rretheve	53
Grafiku 17 - Lejet sipas mineralit	54
Grafiku 18 - Prodhimi Minerar 2011-2016 (M$)	54
Grafiku 19 - Punësimi në sektorin minerar 2011-2016	55
Grafiku 20 – Eksportet nga Sektori Minerar në Milion USD	56
Grafiku 21 - Prodhimi i Kromit 2011-2016	57
Grafiku 22 - Eksportet e Kromit 2011-2016	57
Grafiku 23 - Eksportet e Ferrokromit 2011-2016	58
Grafiku 24 - Numri i të punësuarve për prodhimin e kromit 2011-2016	58
Grafiku 25 - Cmimet ndërkombëtare të bakrit (mesatarja vjetore US$ / Mton)	59
Grafiku 26 - Prodhimi dhe punësimi në sektorin e bakrit 2011-2016	60
Grafiku 27 - Eksporti i Bakrit 2011-2016	60
Grafiku 28 - Prodhimi dhe punësimi në sektorin e nikelit ton'000	61
Grafiku 29 - Eksportet dhe Prodhimi ton'000	61
Grafiku 30 - Prodhimi dhe punësimi në sektorin guror në M$	62
Grafiku 31 - Prodhimi i HEC Fierzës, Komanit & V. Dejës krahasuar me prodhimin total 2000-2016	74
Grafiku 32 - Prodhimi hidroenergjetik dhe kapaciteti i instaluar 2000-2016	75
Grafiku 33 - Prodhimi dhe përdorimi i energjisë elektrike 2000 – 2016	75
Grafiku 34 - Numri i HEC-eve dhënë me koncesion (2002-2016)	86
Grafiku 35 - Vlera në % ndaj PBB dhe humbjet në %	88
Grafiku 36 - Transfertat Kombëtare të Rentës Minerare 2011-2016	92
Grafiku 37 – Struktura e flukseve të raportuara	100
Grafiku 38 – Siguria mbi flukset e raportuar	101

Lista e figurave

Figura 1- Institucionet kryesore publike dhe linjat e raportimit në vitin 2016	14
Figura 2 – Vendburimet e Naftës në Shqipëri	20
Figura 3 – Blloqet e lira të kërkimit	22
Figura 4 – Ndarja e të ardhurave nga sektori i naftës dhe gazit	45
Figura 5 – Depozitat e Kromit	57
Figura 6 – Depozitat e Bakrit	59
Figura 7 – Depozitat e Nikelit	61
Figura 8 – Depozitat e Gurit Gëlqeror dhe mineralet e tjera të ndërtimit	62
Figura 9 – Lumenjtë kryesorë në Shqipëri	74
Figura 10 – Flukset e energjisë dhe bashkëpunimi midis pjesëmarrësve të tregut	76
Figura 11 – Procesi i dhënies dhe monitorimit të koncesioneve	82
Figura 12 – Shpërndarja e të ardhurave nga sektori i hidro-energjisë	89
Figura 13 – Procesi i rakordimit	114

Përmbledhje ekzekutive

Shqipëria është një ndër 51 vendet anëtare të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse ("NTIN" ose "EITI"), e cila është një nismë globale që ka për synim të përmirësojë qeverisjen në industrinë nxjerrëse në botë.

Në zbatim të kësaj nisme, Qeveria Shqiptare publikon këtë raport informues mbi aktivitetin e nxjerrjes së naftës, gazit dhe mineraleve, kontributin e kësaj industrie në Buxhetin e Shtetit dhe ekonominë në vend. Raporti jep një pamje të aktiviteteve në sektorin nxjerrës të naftës, mineraleve dhe sektorin e hidro-energjisë, si dhe rakordimin e flukseve kryesore të paguara nga shoqëritë e licencuara e të mbledhura nga agjencitë qeveritare në këto sektorë dhe një vlerësim të përshtatshmërisë së zbulimeve në sektor në përputhje me standardin EITI.

Grafiku 1 - Prodhimi në milionë Dollar në 2016



Bazuar në të dhënat e raportuara nga agjencitë qeveritare, vlera e prodhimit e gjeneruar nga këta sektorë në vitin 2016 u vlerësua në 612 milionë USD (grafiku 1). Ndërsa Kontributi i të tre sektorëve sëbashku në Buxhetin e Shtetit përllogaritet rreth 5% të të ardhurave të regjistruara në Buxhetin e Shtetit në vitin 2016. Sipas statitistikave të AKBNs, shoqëritë e licencuara në sektorin nxjerrës të naftës, gazit dhe atë minerar, punësuan në total më pak se 1.5% të totalit të fuqisë punëtore të regjistruar në vend në vitin 2016.

Siç shihet në grafikun 1, nafta bruto përbën rreth 46% të vlerës totale të prodhimit të sektorit nxjerrës të naftës dhe sektorin minerar. Rreth 89% e naftës bruto u prodhua nga Bankers Petroleum që operon në vendburimin e Patos-Marinzës. Kapitujt 2 deri në 5 paraqesin një përmbledhje të kuadrit rregullator, regjimit fiskal, aktivitetit të kërkim-zbulimit dhe aktivitetit të prodhimit në të tre sektorët.

Rakordimi i flukseve të parasë

Procesi i rakordimit dhe raportimit sipas Standardit EITI përfshiu të gjitha shoqëritë që operonin me një licencë në kërkimin dhe prodhimin e naftës dhe gazit, 120 shoqëri minerare dhe 12 shoqëri në hidro-energji.

Deri në datën e këtij raporti, pagesat u rakorduan në masën e 98% të totalit të pagesave raportuar nga të licencuarit dhe Qeveria. Kapitulli 10 paraqet rakordimin në nivel të përmbledhur, ndërsa rakordimi i detajuar për çdo shoqëri paraqitet në shtojcat e këtij raporti.

Grafiku 2 - Pagesat e rakorduara *në miliard Lek*



Burimi: Raportet EITI 2011 - 2016

Grafiku 2 në të djathtë paraqet ecurinë e pagesave në rakordimim nga viti 2011 deri në vitin 2016. Flukset e rakorduara në vitet 2011 dhe 2012 përfshijnë të ardhurat e qeverisë nga sektorët nxjerrës të naftës dhe sektorin minerar. Në vitin 2013, qeveria shqiptare përfshiu edhe sektorin hidroenergjitik në objektivat e raportimit EITI. Krahas kësaj, flukset e rakorduara në vitin 2013 përfshijnë një transaksion material në lidhje me privatizimin prej 15 miliardë lekësh të tre hidrocentraleve hidroenergjitike në madhësi mesatare.

Pavarësisht rritjes së numrit të subjekteve të përzgjedhura për të raportuar, niveli i flukseve të rakorduara ka rënë në vitin 2016 për shkak të rënies së pagesave të rentës minerare.

1. Hyrje

Ky është raporti i shtatë i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse në Shqipëri dhe mbulon vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016.

1.1 Çfarë është EITI?

Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse ("NTIN" ose EITI") është një koalicion vullnetar ndërkombëtar i qeverive, shoqërive që operojnë në këtë industri dhe organizatave të shoqërisë civile të angazhuara në administrimin dhe përdorimin e burimeve natyrore, të tilla si nafta, gazi dhe minerale të tjera (shih gjithashtu: www.eiti.org). EITI ka për qëllim promovimin e transparencës për të parandaluar korrupsionin, si dhe t'i sigurojë qytetarëve një bazë për të kërkuar përdorimin e drejtë të të ardhurave.

Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse rregullohet nëpërmjet një standardi ndërkombëtar, "Standardi EITI" (https://eiti.org/document/standard), i cili përcakton parimet dhe raportimet minimale të nevojshme për të arritur transparencën dhe angazhimin efektiv të qeverive, shoqërive dhe shoqërisë civile.

Vendet aderuese do të bëjnë transparente bazën për shpërndarjen e licencave dhe të drejtave minerare, kontratave dhe të licencuarve, niveleve të prodhimit, përfitimeve të fituara nga përdorimi i burimeve natyrore, mënyrën se si këto të ardhura janë menaxhuar në dobi të shoqërisë civile dhe kontributin e dhënë në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit.



Standardi EITI 2016

1.2 EITI në Shqipëri

Shqipëria u bashkua si kandidate e EITI-t në maj 2009 dhe fitoi statusin e plotë të anëtarësisë në maj 2013. Që prej aderimit fillestar, Shqipëria ka publikuar raporte vjetore duke përmbledhur aktivitetet dhe pagesat e çdo viti duke filluar nga viti 2009 deri në vitin 2015. Ky raport mbulon aktivitetet dhe pagesat për vitin 2016.

Zbatimi i nismës në Shqipëri mbikqyret nga Grupi Ndërinstitucional i Punës ("MSG" ose "Grupi Shqiptar i Punës"), rregulluar nëpërmjet urdhërit nr. 71 të Kryeministrit datë 21 korrik 2011. Grupi Shqiptar i Punës përbëhet nga disa grupe interesi të EITI-t duke përfshirë Qeverinë, shoqëritë private, shoqërinë civile etj. dhe kryesohet nga Zv. Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë. Sekretariati i EITI-t në Shqipëri ("ALBEITI") mbështet Grupin Shqiptar të Punës në përmbushjen e detyrave të tij përgjatë zbatimit të nismës.

Raportet e EITI së bashku me aktivitetet e EITI në Shqipëri janë botuar në faqen e internetit ALBEITI: www.albeiti.org.

1.3 Raportimi vjetor

Standardi EITI kërkon që vendet dhe shoqëritë të raportojnë informacion mbi hapat kryesorë në qeverisjen e të ardhurave nga sektori nxjerrës i naftës, gazit dhe atij minerar duke përfshirë:

Së bashku me dhënien e informacioneve shpjeguese për kontratat, licencat, të dhëna për prodhimin, flukset e mbledhura dhe shpërndarjen e tyre dhe kontributin social dhe ekonomik, sipas standardit EITI, të licencuarit dhe institucionet qeveritare do të raportojnë përkatësisht pagesat e kryera dhe të ardhurat e arkëtuara çdo vit dhe të gjitha këto do të rakordohen nga një administrator i pavarur në kuadrin e zbatimit të vazhdueshëm të nismës EITI.

Në këtë kontekst, MSG analizoi dhe përzgjodhi flukset materiale, entitetet qeveritare marrëse dhe shoqëritë e angazhuara që kontribojnë një pjesë të madhe të aktiviteteve të prodhimit dhe kërkimit. Një pasqyrë e flukseve të zgjedhura, shoqërive dhe entiteteve qeveritare është paraqitur në kapitullin 8.

1.4 Falenderime

Shprehim falenderimet tona të sinqerta për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Grupin Shqiptar të Punës dhe Sekretariatin EITI në Shqipëri, të cilët na kanë ndihmuar në marrjen në kohë të përgjigjeve nga Shteti dhe shoqëritë pjesëmarrëse.

2. Pamje e përgjithshme e industrisë nxjerrëse dhe sektorit të hidro-energjisë në Shqipëri

2.1 Të dhënat kryesore

2.1.1 Energjia dhe burimet në Shqipëri

Shqipëria është e pasur me burime energjetike: naftë, gaz, qymyr, dru, bitumi, dhe potencial hidroenergjik, etj., të cilat kontribuojnë në forma të ndryshme për të plotësuar kërkesat për energji në vend.

Bazuar në rezultatet paraprake të publikuara nga INSTAT, të paraqitura në grafikun 3, sektori i energjisë dhe burimeve përbënte jo më shumë se 6% të prodhimit të brendshëm bruto (PBB-së) në vitin 2016, me vlerë 87,483 milionë Lek[1]. INSTAT nuk mundëson të dhëna analitike për sektorin nxjrrës minerar, të naftës, dhe sektorin e hidro-energjisë.

Eksportet nga sektori nxjerrës janë rritur ndjeshëm me mbi 100% deri në vitin 2013, kur arritën 96.7 miliardë lekë ose 39% të totalit të eksporteve. Kjo përqindje ka rënë në 19% të totalit të eksporteve në vitin 2016 (grafiku 4) ose 47.0 miliardë lekë (grafiku 5), e ndikuar njëkohësisht nga rënia e çmimeve ndërkombëtare të naftës dhe rritja e aktivitetit të rafinimit të naftës vendase.

Bazuar në të dhënat e raportuara nga të licencuarit e angazhuar në sektorin nxjerrës të naftës, minerar dhe sektori hidroenergjetik, numri i të punësuarve është rreth 16,500 punonjës, që përbëjnë 1,4% të fuqisë punëtore të regjistruar nga INSTAT në dhjetor 2016[2].

Grafiku 3 – Kontributi i energjisë dhe burimeve në *PBB,* në %



2015* Gjysëm-finale
2016** Flesh

Burimi: INSTAT- Llogaritë Kombëtare Vjetore (metoda e prodhimit)

Grafiku 4 – Eksportet nga industria nxjerrëse ndaj totalit të eksporteve



Burimi: Administrata Doganore Shqiptare

Grafiku 5 – Eksportet nga industria nxjerrëse sipas mineraleve



Burimi: Administrata Doganore Shqiptare

[1] Duke filluar nga viti 2016, INSTAT ka ndryshuar klasifikimin e PBB-së sipas sektorëve ekonomikë. PBB-ja e deklaruar për Energjinë dhe burimet përfshijnë: industritë nxjerrëse; furnizimin me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër dhe të tjera të lidhura me menaxhimin e tyre.

[2] Burimi: Tabela përmbledhëse e treguesve të tregut të punës vlerësuar në bazë të anketës tremujore të Forcës së Punës, T.1 / 14-T.4 / 17– www.instat.gov.al

Nafta dhe gazi

Nafta bruto përbënte burimin kryesor të energjisë së prodhuar në Shqipëri. Nafta bruto e prodhuar në vitin 2016 përfaqësonte 52% të energjisë së prodhuar nga burime parësore në vend, e ndjekur nga energjia elektrike me rreth 33% të energjisë nga burime primare[3].

Në vitin 2016, në sektorin e naftës dhe gazit operonin shtatë shoqëri në prodhimin e naftës bruto në pjesën jugore të Shqipërisë dhe katër shoqëri të angazhuara në kërkimin e naftës. Shteti u përfshi në sektorin e naftës përmes zotërimit direkt të shoqërisë Albpetrol, e angazhuar në kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e naftës dhe gazit. Albpetrol zotëron të drejta prodhimi, si i licencuar kryesor në të gjitha fushat e naftës të zbuluara deri në vitin 1993. Me qëllim përmirësimin e efikasitetit në prodhim, Albpetrol i ka deleguar të drejtat e tij tek shoqëritë private të naftës nëpërmjet marrëveshjeve hidrokarbure. Prodhimi i naftës bruto është rritur më shumë se dyfish që prej vitit 2003, kur shoqëritë private të naftës filluan punën në sektor.

Në vitin 2016, Albpetrol raportoi prodhim të naftës bruto prej 1,034 mijë ton, e vlerësuar 179.3 milionë USD bazuar në çmimet mesatare të eksportit në vitin 2016. Bankers Petroleum që operon në fushën naftë-mbajtëse të Patos-Marinzës, gjeneroi rreth 89% të totalit të prodhimit të naftës bruto në vitin 2016. Prodhimi i Albpetrol përbënte rreth 6% të prodhimit total të naftës bruto në këtë vit. Të ardhurat me natyrë fiskale dhe jo-fiskale nga sektori nxjerrës i naftës përbënin më shumë se 2.6% të totalit të të ardhurave të regjistruara në Buxhetin e Shtetit.

Pavarësisht rritjes së prodhimit, numri punonjësve në këtë sektor ra ndjeshëm gjatë gjashtë viteve të fundit. Kjo rënie erdhi si rezultat i transferimit të operacioneve të prodhimit nga Albpetrol tek shoqëritë private të naftës. Në vitin 2016, sektori nxjerrës së naftës dhe gazit punësoi rreth 0.3% të forcës punëtore të përgjithshme të regjistruar sipas INSTAT. Albpetrol mbetet punëdhënësi më i madh në këtë sektor në vitin 2016, me rreth 65% të punësimit total në sektorin nxjerrës të naftës dhe gazit.

Nafta e prodhuar në vend kryesisht eksportohet për t'u përpunuar jashtë vendit. Konsumi i brendshëm për nënproduktet e naftës përmbushet përmes importit. Siç tregohet në grafikun 5, eksportet e naftës bruto përbënin rreth 41% të totalit të eksporteve nga sektori nxjerrës në vitin 2016, duke kontribuar në totalin e eksporteve vendase me rreth 7.9%.

Sektori minerar

Si një vend tradicional minerar, Shqipëria ka një numër në rritje të shoqërive të vogla dhe të mesme në këtë sektor, si dhe numëron vetëm disa shoqëri të mëdha industriale. Në dhjetor 2016, AKBN raportoi 600 licenca minerare, ku 121 licenca prodhonin krom në minierat e Bulqizës.

Prodhimi minerar në vitin 2016 u vlerësua me rreth 214.1 milionë USD, duke përfshirë vlerën e shtuar në vend nëpërmjet përpunimit të mineraleve. Metodat dhe inputet për vlerësimin e vlerës së prodhimit minerar jepen në kapitullin 4.

Prodhimi i kromit zinte pjesën më të madhe të prodhimit minerar vendas me rreth 74% në vitin 2016. Guri gëlqeror dhe mineralet e tjera të ndërtimit përfaqësonin grupin e dytë më të madh të mineraleve pas kromit. Pesha e tyre në prodhimin minerar vendas ishte rreth 22% në vitin 2016.

Sektori minerar punësoi rreth 1% të fuqisë punëtore të regjistruar në vend në fund të vitit 2016, ku punësimi në nën-sektorin e kromit, në veçanti, zinte rreth 68% të totalit të fuqisë punëtore punësuar në sektorin minerar në vitin 2016.

[3] Burimi: Prodhimi dhe konsumi i energjisë primare, 2012-2016– (INSTAT: www.instat.gov.al)

Të ardhurat me natyrë fiskale dhe jo-fiskale nga sektori nxjerrës i naftës përbënin jo më pak se 1.4% të totalit të të ardhurave të regjistruara në Buxhetin e Shtetit.

Sektori i hidro-energjisë

Prodhimi hidro-energjetik në Shqipëri dominohet nga sektori publik. Në fund të vitit 2016, Shteti Shqiptar zotëronte dhe administronte Korporatën Elektroenergjetike Shqiptare (KESH), Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) dhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSHE).

KESH është prodhuesi më i madh në vend. Me një kapacitet të instaluar prej 1,350 MW, ndërtuar në kaskadën e lumit Drin në veri, KESH gjeneroi rreth 71.4% të prodhimit të energjisë në vitin 2016, raportuar në 7,134 GWh.

Volumi i prodhimit vendas të energjisë ishte rreth 101% e flukseve të energjisë së transmetuar dhe shpërndarë në vitin 2016, që përfshin edhe konsumin e brendshëm, edhe flukset e energjisë të humbura në rrjetet e transmetimit dhe shpërndarjes. Një pjesë e konsiderueshme e energjisë së transmetuar humbet për shkak të kushteve të dobëta teknike dhe lidhjeve informale në rrjet. Qeveria e Shqipërisë dhe OSSHE punojnë vazhdimisht për të ulur si humbjet teknike ashtu edhe humbjet financiare, të përllogaritura në 28.04% për vitin 2016.

Vlera e shtuar nga sektori i energjisë elektrike, duke përfshirë prodhimin e energjisë, transmetimin publik dhe shpërndarjen, vlerësohet në 54.75 miliardë Lek (ekuivalent me 441 milionë USD), megjithatë të ardhurat e krijuara vetëm përmes shitjes së energjisë arrijnë në 27.3 miliardë lekë (ekuivalente me 219 milionë USD). Kontributi fiskal i njohur i sektorit përbënte 1.1% të të ardhurave totale në Buxhetin e Shtetit në vitin 2016.

Qeveria e Shqipërisë kërkon vazhdimisht të shfrytëzojë potencialet hidroenergjetike në vend nëpërmjet investimeve private dhe me koncesion. Në fund të vitit 2016, AKBN raportoi rreth 545 HEC-e të dhëna më koncesion, nga të cilat vetëm 74 prodhuan energji përgjatë vitit. Sipas AKBN, një numër i madh i HEC-ve dhënë me koncesion nuk kanë filluar ende të ndërtohen ose janë në ndërtim e sipër në datën e këtij raporti, duke shfaqur vonesa me mbi dy vjet.

Në vitin 2016 dhe për shumë vite, Shteti shqiptar subvencionon sektorin e energjisë përmes rregullimit të çmimeve të prodhimit të energjisë, transmetimit dhe shpërndarjes. Ky fakt shpjegon kontributin relativisht të ulët të sektorit në të ardhurat fiskale. Aktualisht sektori energjisë në vend është në proces reformash drejt liberalizimit të plotë të tregut të energjisë. Në kontekstin e reformave të vazhdueshme në korrik të vitit 2016, Enti Rregullator i Energjisë në Shqipëri miratoi një model të ri të tregut të energjisë elektrike, i cili do të zëvendësojë gradualisht modelin e tregut të rregulluar. Në datën e hartimit të këtij raporti, Qeveria është në proces hartimi të masave për kalimin nga tregu i rregulluar drejt liberalizimit të plotë.

Të ardhurat e Shtetit nga sektori nxjerrës dhe hidro-energjia

Tabela 1 – Të ardhurat e Shtetit nga sektori nxjerrës

Lloji pagesës	Albpetrol	AKBN	ERE	KESH	Buxheti i Shtetit	Total në MLek	Total në M$
Ndarja e prodhimit të naftës	1,091	-	-	-	-	**1,091**	**8.8**
Bonuset	23	48	-	-	-	**71**	**0.6**
Tarifa koncesionare	-	-	-	689	-	**689**	**5.5**
Pagesat rregullatore ndaj ERE-s	-	-	117	-	-	**117**	**0.9**
Renta minerare	-	-	-	-	3,542	**3,542**	**28.5**
Tatimi mbi fitimin	-	-	-	-	3,044	**3,044**	**24.5**
Pagesat për sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat personale	-	-	-	-	4,130	**4,130**	**33.3**
TVSH	-	-	-	-	2,607	**2,607**	**21.0**
Dividendët	-	-	-	-	-	**-**	**0.0**
Të tjera	-	-	-	-	6,093	**6,093**	**49.1**
Total	**1,114**	**48**	**117**	**689**	**19,415**	**21,382**	**172.2**
Sektori naftës dhe gazi	1,114	48		-	9,858	**11,019**	**88.8**
Sektori minerar	-	-	-	-	5,948	**5,948**	**47.9**
Sektori i hidro-energjisë	-	-	117	689	3,609	**4,415**	**35.6**

Pagesat listuar më sipër përfaqësojnë pagesat kryesore nga shoqëritë e licencuara në Buxhetin e Shtetit, AKBN-së, ERE-s, KESH-it dhe shoqërisë Albpetrol, të cilat u përzgjodhën për rakordim në këtë raport. Kjo listë nuk përmbledh të gjitha pagesat e zbatueshme. Sistemet e informacionit të Qeverisë nuk e mundësojnë paraqitjen e totalit të të ardhurave arkëtuar nga tre sektorët.

Taksat e lidhura me listpagesën, duke përfshirë pagesat për sigurime shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat personale përbëjnë rrjedhën kryesore të të ardhurave që kontribuan në buxhetin e shtetit në mënyrë kolektive nga sektorët nxjerrës të naftës, gazit dhe minerar, si dhe sektorit hidroenergjetik.

Përsa i përket sektorit nxjerrës, **Renta minerare** përbën fluksin kryesor të të ardhurave nga sektori nxjerrës i naftës, gazit dhe minerar në Buxhetin e Shtetit. **Ndarja e prodhimit të naftës** përbën grupin e dytë më të madh të të ardhurave të mbledhura nga sektori i naftës. Shoqëritë private të naftës transferuan sasinë e prodhimit të naftës prej 52 mijë ton gjatë vitit 2016.

Të tjera përfshijnë taksat e mbledhura nga Administrata Doganore Shqiptare duke përfshirë TVSH-në e paguar për importet, taksën e karbonit, akcizën, taksën e qarkullimit dhe taksat e tjera doganore. Këto flukse parash përfshihen në kuadër të raportimit si flukse materiale nga licencat, si dhe ishin pjesë e rakordimit për vitin 2016. Megjithatë, TVSH-ja e mbledhur për importet është kthyer pjesërisht ose tërësisht tek operatorët e licencuar bazuar në kriteret e paracaktuara, si rrjedhojë nevojiten të dhëna shtesë për të përfunduar rakordimin në total me të ardhurat e raportuara nga institucionet shtetërore për sektorët në fokus.

Shifrat e paraqitura më sipër në lidhje me të ardhurat nga ndarja e prodhimit të naftës janë vlerësuar me çmimin mesatar të shitjeve vjetore të Albpetrol gjatë vitit 2016 në vlerën 159.04 $/ton.

Shumat në dollar janë konvertuar në Lek me kursin mesatar vjetor sipas Bankës së Shqipërisë, respektivisht 1 dollar i barabartë me 124.14 Lek.

2.1.2 Institucionet publike dhe entet që qeverisin sektorin

Figura 1- Institucionet kryesore publike dhe linjat e raportimit në vitin 2016



Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ("MIE" ose "Ministria")

MIE[4] është Ministria përgjegjëse për hartimin e politikave publike dhe mbikqyrjen e zbatimit të legjislacionit në sektorin e energjisë dhe të burimeve natyrore. Ajo operon nëpërmjet drejtorive përgjegjëse për zhvillimin e politikave publike në sektorin e naftës, minerar, elektro-energjisë, burimeve të ripërtëritshme dhe efiçencës së energjisë dhe drejtorinë e zhvillimit të industrisë dhe standardeve teknike.

MIE financohet kryesisht nga Buxheti i Shtetit në përputhje me ligjin e buxhetit.

Misioni i Ministrisë në sektorin e energjisë është promovimi i vazhdueshëm dhe zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik përmes:

- nxitjes së investimeve private, vendase ose të huaja, në sektorin e energjisë duke promovuar një klimë ligjore tërheqëse për këto investime, dhe
- zhvillimit të reformave të tregut në sektorin energjetik për të arritur objektivat kombëtare për integrimin në BE dhe zhvillimin e një Tregu Rajonal të Energjisë Elektrike.

MIE është përgjegjëse për dhënien e licencave për kërkim dhe prodhim në sektorin minerar, si dhe vlerësimin e aplikimeve për marrëveshjet hidrokarbure dhe të drejtat koncesionare për ndërtimin e hidrocentraleve në Shqipëri. Marrëveshjet hidrokarbure dhe koncesionet e hidro-energjisë miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, dhe nënshkruar nga Ministri përgjegjës për Energji në emër të Autoritetit Kontraktues.

MIE financohet kryesisht nga Buxheti i Shtetit në përputhje me ligjin e buxhetit. Të ardhurat e mbledhura nga sektori i energjisë përfshijnë tarifat e shërbimit dhe pagesat nga licencat.

Ministria operon përmes Sistemit të Thesarit te Shtetit, ku të ardhurat e mbledhura dhe disbursimet për shpenzime grumbullohen në llogaritë bankare të

[4] Faqja e internetit: www.infrastruktura.gov.al

përbashkëta të Shtetit. MIE publikon informacion financiar lidhur me shpenzimet sipas natyrës dhe programit në faqen e saj të internetit.

Agjensia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN)

AKBN është themeluar si një agjenci publike që raporton tek Ministri përgjegjëse për Energjinë në përputhje me VKM Nr. 547 datë 9 Gusht 2006, të ndryshuar. Qëllimi kryesor i AKBN është zhvillimi dhe mbikqyrja e shfrytëzimit racional të burimeve natyrore në sektorin minerar, naftës dhe mbarë sektorin e energjisë bazuar në politikat qeverisëse në fuqi.

AKBN është përgjegjëse për mbikqyrjen e aktivitetit të kërkimit dhe prodhimit në sektorin nxjerrës të naftës, atë minerar dhe të hidro-energjisë, planifikimin e nevojave për energji, hartimin e bilancit kombëtar dhe rajonal të energjisë sipas kërkesave të EUROSTAT[5] dhe Agjensisë Ndërkombëtare të Energjisë[6] etj.

AKBN vepron si institucion i specializuar teknik për studimet dhe projektet e zbatuara në të tre sektorët, negocion dhe mbikqyr zbatimin e marrëveshjeve hidrokarbure dhe lejeve minerare, si dhe mbikqyr zbatimin e marrëveshjeve koncesionare në sektorin e hidro-energjisë.

AKBN drejtohet nga Këshilli Drejtues i përbërë prej shtatë anëtarësh duke përfshirë Kryetarin dhe Drejtorin Ekzekutiv. Të gjithë anëtarët emërohen nga Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë. AKBN kryen funksionet publike përmes drejtorive të naftës, minerare, hidro-energjisë dhe energjisë së ripërtëritshme përgjegjëse për secilin sektor.

AKBN është organizuar si institucion jo-buxhetor dhe si i tillë administron llogaritë e veta bankare. AKBN nuk derdh para në Buxhetin e Shtetit dhe nuk merr financime prej tij, me përjashtim të rasteve kur zbaton projekte specifike të parashikuara në Buxhetin e Shtetit. Teprica e të ardhurave mbi shpenzimet vjetore, mbartet në vitet pasardhëse fiskale. AKBN financohet kryesisht nga të ardhurat e mbledhuara nga mbikqyrja e marrëveshjeve hidrokarbure, tarifat e zbatuara për oponencën teknike dhe nga projektet dhe shërbime të tjera.

Pasqyrat financiare të AKBN-së nuk ishin publike apo në dispozicion të EITI-t në datën e këtij raporti.

AKBN financohet kryesisht nga të ardhurat e mbledhura nga mbikqyrja e marrëveshjeve hidrokarbure, tarifat e zbatuara për oponencën teknike dhe nga projektet dhe shërbime të tjera.

Pasqyrat financiare të AKBN-së nuk ishin publike apo në dispozicion të EITI-t në datën e këtij raporti.

[5] http://ec.europa.eu/eurostat/ëeb/energy/data/energy-balances
[6] http://www.iea.org/

Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH)

Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH) vepron si institucion shkencor në fushën e gjeo-shkencave në përputhje me Ligjin Nr. 111/2015 "Për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar"[7]. SHGJSH është përgjegjës për shumë studime shkencore në fushën e hidrokarbureve, mineraleve, hidro-energjisë, etj.

Përveç të tjerave, SHGJSH është përgjegjës për promovimin dhe negocimin e licencave për kërkim në sektorin minerar dhe gjithashtu monitorimin e zbatimit të projektit për çdo licencë të dhënë. SHGJSH financohet nga Buxheti i Shtetit, tarifat e shërbimit dhe tarifat për konsulencën teknike dhe studimet gjeologjike.

SHGJSH publikon në faqen e internetit www.gsa.gov.al projektet e zbatuara, si dhe ato në zbatim.

Enti Rregullator i Energjisë (ERE)

ERE është një institucion i pavarur publik, përgjegjës për rregullimin e aktivitetit në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror, organizuar në përputhje me ligjin Nr. 43 /2015, datë 30 prill 2015 "Për sektorin e Energjisë Elektrike"[8], i ndryshuar, dhe ligjin Nr. 102/2015 datë 23 Shtator 2015 "Për Sektorin e gazit natyror"[9].

ERE është autoriteti përgjegjës për licencim në prodhim, transmetim, shpërndarje, furnizim dhe tregtim të energjisë elektrike. ERE drejtohet nga Bordi i Komisionerëve i përzgjedhur nga Parlamenti Shqiptar. ERE financohet nga tarifat për licencat dhe tarifat rregullatore të paguara nga të licencuarit në prodhimin, transmetimin, shpërndarjen, tregtimin e energjisë elektrike dhe të licencuarit në transmetimin dhe shpërndarjen e gazit etj.

ERE i raporton çdo vit Parlamentit Shqiptar "Për Situatën e Sektorit të Energjisë dhe Aktivitetin e ERE". Raporti i aprovuar nga Parlamenti publikohet në faqen e internetit të ERE: www.ere.gov.al brenda tre muajsh nga mbyllja e periudhës në raportim. Pasqyrat Financiare vjetore të ERE auditohen nga auditorë të pavarur ligjorë në përputhje me ligjin dhe rregulloret e auditimit të zbatueshme në Shqipëri dhe publikohen në raportin vjetor të ERE.

ERE është autoriteti përgjegjës për licencim në prodhim, transmetim, shpërndarje, furnizim dhe tregtim të energjisë elektrike.

ERE financohet nga tarifat për licencat dhe tarifat rregullatore të paguara nga të licencuarit në prodhimin, transmetimin, shpërndarjen, tregtimin e energjisë elektrike dhe të licencuarit në transmetimin dhe shperndarjen e gazit etj.

Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO)

Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve është një drejtori publike e themeluar në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE) në përputhje me VKM Nr.150, datë 22 mars 2007 "Për organizimin dhe funksionimin e agjencisë së trajtimit të kocesioneve (ATRAKO)", e ndryshuar. Kjo mbështet Autoritetin Kontraktues për vlerësimin dhe negocimin e koncesioneve, duke përfshirë koncesionet hidro-energjetike. ATRAKO publikon në faqen zyrtare të internetit kuadrin rregullativ të zbatueshëm për koncesionet, dhe një përmbledhje të instruksioneve për procedurat e zbatuara për identifikimin e koncesioneve dhe mundësive për alokimin e marrëveshjeve të Partneritetit Privat-Publik. www.atrako.gov.al.

Që prej vitit 2015, ATRAKO është përgjegjëse për mbajtjen e regjistrit të koncesioneve në përputhje me ligjin nr. 125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik-privat". Ky regjistër, së bashku me listën e koncesioneve në fuqi për hidrocentralet mund të aksesohet në faqen zyrtare të ATRAKO (link: http://www.atrako.gov.al/?page_id=112).

[7] Ky ligj shfuqizoi Ligjin nr. 8366, datë 2 korrik 1998 "Për Shërbimin Gjeologjik shqiptar", ndryshuar me ligj nr. 9221, datë 15 prill 2004 dhe ligj nr. 10227, datë 4 shkurt 2010.
[8] Ky ligj shfuqizoi Ligjin nr. 9072, datë 22.05.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar.
[9] Ky ligji shfuqizoi ligjin e parë Nr. 9946 datë 30 qershor 2008 "Për sektorin e gazit".

Ministria e Mjedisit

Ministria e Mjedisit (MM) është përgjegjëse për hartimin e politikave, strategjive dhe planeve të veprimit për mbrojtjen dhe administrimin e mjedisit, pyjeve, ujërave dhe peshkimit në mënyrë që të arrihet zhvillim i qëndrueshëm, të përmirësohet cilësia e jetës dhe t'i mundësojë vendit integrimin në BE.

MM lëshon licenca për përdorimin e ujit dhe mjedisit për të gjitha centralet përfshirë ato hidrike, të erës dhe biomasës, subjekt i miratimit të vlerësimit të ndikimit në mjedis në përputhje me Ligjin Nr. 10 440, datë 7 korrik 2011, të ndryshuar. ME gjithashtu shërben si institucioni kryesor ndërlidhës për qeverinë shqiptare nën Protokollin e UNFCCC dhe të Kiotos.

Shoqëritë në pronësi të Shtetit (SOE-të) në sektorin e energjisë dhe burimeve

Albpetrol është shoqëria shtetërore e angazhuar në kërkimin dhe prodhimin e naftës dhe gazit.

KESH është shoqëria shtetërore e angazhuar në prodhimin e energjisë elektrike.

Përkufizimi

Subjektet shtetërore përcaktohen nga neni 213 i ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", si subjekte tregtare që zotërohen dhe kontrollohen drejtpërdrejt ose tërthorazi nga qeveria qendrore apo ajo lokale, ku si kontroll është fuqia për të qeverisur aktivitetet e subjekteve tregtare[10]. Ky ligj sugjeron që në rast të çështjeve që kërkojnë shumicë të kualifikuar, Asambleja e Aksionarëve mund të marrë vendime të vlefshme nëse aksionarët mbajnë më shumë se gjysmën e aksioneve me të drejtë vote.

Për çështjet që kërkojnë një shumicë të thjeshtë, Asambleja e Aksionerëve mund të marrë vendime të vlefshme nëse janë të pranishëm vetë aksionerët ose përfaqësuesit e tyre që mbajnë më shumë se 30% të aksioneve me të drejtë vote.

Krahas kontrollit, ligji përcakton ndikim të rëndësishëm si mbajtja e të drejtave të votimit prej 30% ose e drejta për të emëruar anëtarë që përfaqësojnë 30% të të drejtave të votës[11].

Subjektet shtetërore

MIE ka përfaqësuesit e saj në Bordin e Drejtorëve të shoqërive në pronësi shtetërore në sektorin e energjisë dhe burimeve. Ministria e Financës dhe Ekonomisë përgjegjëse për politikat ekonomike, zotëron aksione në këtë sektor përmes zotërimit të:

- Albpetrol Sh.a (100% të aksioneve) – angazhuar në operacionet e sektorit të naftës dhe gazit
- Transnafta sh.a. (89% të aksioneve) – angazhuar në transportin e naftës dhe shërbimit të makinave.
- Uzina Mekanike e Naftes Sh.a. (100% të aksioneve) – angazhuar në shërbime mekanike të impianteve të gazit industrial.
- ARMO (në mënyrë efektive kontrollon shoqërinë me 15% të aksioneve) – rafinimi i naftës
- Korporata Elektroenergjetike Shqiptare Sh.a ("KESH") (100% të aksioneve) – angazhuar në prodhimin e energjisë elektrike
- Operatori i Sistemit të Transmetimit Sh.a. ("OST") (100% të aksioneve) – angazhuar në transmetimin e energjisë elektrike
- Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Sh.a. ("OSHEE") (100% të aksioneve) – angazhuar në shpërndarjen e energjisë elektrike

Roli i shoqërive Albpetrol, Transnafta, Uzina Mekanike e Naftës dhe ARMO shpjegohet në kapitullin 3 Sektori i naftës dhe i gazit. Roli i KESH, OST dhe OSHEE shpjegohet në kapitullin 5 Sektori i Hidro-energjisë.

[10] Ligji 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", neni 207, pika 1.
[11] Ligji 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", neni 207, pika 2.

Krahas kësaj, Qeveria ka në zotërim një përqindje të aksioneve të tre shoqërive minerare, duke përfshirë Elbasan Cement Factory sh.pk (21%), Italb - Mermeri - Muhur sh.p.k (25%) dhe United Quarries sh.p.k (13%). Informacioni mbi aksionerët dhe transferimet raportohet në kapitullin 4 Sektori Minerar.

2.1.3 Anëtarësimi në nismat Rajonale të Energjisë

Që nga viti 2006, Shqipëria është anëtare e Komunitetit Rajonal të Energjisë, pjesë e iniciativave të Bashkimit Europian për krijimin e tregut Europian të energjisë.

Komuniteti i Energjisë, si një organizatë ndërkombëtare, ka si qëllim bazë zhvillimin e një politike të përbashkët të energjisë në rajonin e Europës Juglindore dhe integrimin e saj në tregun e energjisë së Bashkimit Europian (BE), përmes krijimit të një tregu të integruar të energjisë për të lejuar tregtimin ndër-kufitar të energjisë dhe integrimin me tregun e BE-së.

Me nënshkrimin e Traktatit të Komunitetit të Energjisë, Shqipëria është angazhuar për zbatimin e legjislacionit të tregut të përbashkët bazuar në *"acquis communautaire"* duke zhvilluar një rregullore të përshtatshme dhe duke liberalizuar tregun e energjisë në përputhje me *"acquis"*. Detajet mbi qëllimet dhe aktivitetet e komunitetit mund të gjenden në: www.energy-community.org.

3. Sektori i naftës dhe gazit

3.1. Kërkimi, zhvillimi dhe prodhimi i naftës dhe gazit

Pamje e Përgjithshme e aktiviteteve të kërkimit

Sektori i naftës ka qënë historikisht sektor me rëndësi strategjike dhe kontribues i rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të vendit. Kërkimi i naftës në Shqipëri daton në vitin 1918. Që prej asaj kohe, u zbuluan disa fusha naftë-mbajtëse në zona tokësore e detare dhe u zhvillua industria e përpunimit me cikël të plotë të naftës gjatë viteve 1970-1980[12].

AKBN paraqet informacion në faqen e saj të internetit www.akbn.gov.al për strukturën gjeologjike të naftës, historinë e zhvillimit dhe mundësitë e investimit në vend, në publikimin "Mundësi për Kërkimin dhe Prodhimin e Naftës në Shqipëri".

Një përmbledhje e historisë së kërkimit dhe karakteristikave të fushave naftëmbajtëse dhe naftës në Shqipëri është paraqitur në Shtojcën 4.

Rezervat e naftës në vend

Vendburimet e naftës në Shqipëri shtrihen në pjesën perëndimore dhe jugperëndimore të vendit (figura 2). Ato janë kryesisht në dy struktura: vendburime ranore dhe vendburime gëlqerore. Aktualisht këto vendburime kanë rezerva të konsiderueshme, megjithatë shfrytëzimi i plotë i tyre kërkon metoda më të avancuara të nxjerrjes së naftës. Sipas studimeve të kryera nga shoqëritë e huaja dhe Albpetrol[13] për periudhën 1985 - 1990, rezervat e naftës në vendburimet ekzistuese në Shqipëri ishin në total rreth 437.6 milionë ton, ndërsa rezervat e rikuperueshme të vlerësuara me metodat e zbatuara në ato vite ishin 81 milionë ton. Rezervat gjeologjike në strukturat ranore përbënin pjesën kryesore, me rreth 77.4% të rezervave të përgjithshme, megjithatë për shkak të vështirësive në nxjerrje, rikuperimi i tyre vlerësohej në masën 13%. Rezervat gjeologjike nga strukturat gëlqerore kishin rikuperim, që varion prej 24% deri në 53%.

Bazuar në të njëjtat studime, rezervat e njohura të gazit natyror në Shqipëri janë vlerësuar në 18,164 milionë Nm3 dhe gjenden kryesisht në zonat e Kuçovës dhe Patosit. Albpetrol raportoi se gazi kumulativ i prodhuar deri në fund të vitit 2012 arrinte në 12,504 milion Nm3[14]. Albpetrol nuk raportoi asnjë aktivitet gazsjellës pas vitit 2012, pas nën-licencimit të të gjithë gazsjellësve nga shoqëri private të naftës (referojuni tabelës 2). Krahas kësaj, Albpetrol vlerësoi 3.2 milion Nm3 rezerva të mundshme të rikuperueshme të gazit që lidhen me nxjerrjen e naftës në fund të vitit 2016 (tabela 2).

Shteti shqiptar nuk ka ndërmarrë studime të mëtejshme për rivlerësimin e rezervave të naftës sipas standarteve bashkëkohore. Këto matje përdoren si pikë bazë dhe përditësohen rregullisht nga Albpetrol duke zbritur prodhimin vjetor të naftës dhe gazit.

Figura 2 – Vendburimet e Naftës në Shqipëri



[12] Burimi: "Mundësi për Kërkimin dhe Prodhimin e Naftës në Shqipëri", publikuar nga AKBN – www.akbn.gov.al

[13] Informacioni për rezervat dhe prodhimin kumulativ u raportua nga Albpetrol për përpilimin e këtij raporti. Të dhëna të përmbledhura në rang vendi paraqiten në adresën e internetit: http://www.albpetrol.al/rezervat-gjeologjike/

[14] http://www.albpetrol.al/rezervat-gjeologjike/

Tabela 2 më poshtë paraqet rezervat gjeologjike dhe të rikuperueshme sipas matjeve të kryera në vitet 1985-1990 dhe përllogatitjen e rezervave të rikuperueshme sot, pasi zbritet prodhimi kumulativ i naftës deri në fund të 2016.

Tabela 2 – Rezervat gjeologjike dhe të rikuperueshme të naftës bazuar në studime të periudhës 1985-1990 dhe prodhimi kumulativ i naftës deri në vitin 2016[15]

Vendburimet	Rezervat gjeologjike	Rezervat e rikuperueshme	Norma e rikuperimit	Prodhimi kumulativ deri në 2016	Prodhimi i naftës në vitin 2016 në 000'ton	Rezervat e rikuperueshme më 31 dhjetor 2016	Prodhimi i gazit në vitin 2016 në milion Nm3	Rezervat e rikuperueshme të gazit më 31.12.2016 në milion Nm3
Cakran-Mollaj	16,128.0	8,144.0	50%	4,307.3	16.2	3,836.7	1.8	1,580.7
Ballsh-Hekal	19,269.0	6,360.0	33%	5,103.1	23.8	1,257.0	0.5	165.0
Gorisht-Kocul	30,500.0	14,674.0	48%	12,054.3	29.8	2,619.7	0.1	86.4
Karbunarë	411.0	136.0	33%	94.5	0.4	41.5	0.1	42.5
Amonicë	2,836.0	1,503.0	53%	712.7	4.1	790.3	0.0	1.9
Visokë-Kolonjë	28,362.0	6,807.0	24%	6,266.6		540.5	0.7	-
Delvinë	335.0	134.0	40%	19.2	4.1	114.8	-	792.8
Finiq-Krane	1,027.0	154.0	15%	9.8	0.0	144.2	-	-
Drashovicë	80.0	24.0	30%	8.1		15.9	-	0.2
Total gëlqeror	**98,948.0**	**37,936.0**	**38%**	**28,575.5**	**78.4**	**9,360.5**		
Patos-Marinëz	258,394.0	31,120.0	12%	27,506.5	931.1	3,613.5	0.0	267.7
Kuçovë	78,332.0	11,772.0	15%	4,307.5	24.5	7,464.5	-	281.3
Rasë-Pekisht	1,970.0	197.0	10%	17.4	0.3	179.6	-	1.2
Total ranor	**338,696.0**	**43,089.0**	**13%**	**31,831.4**	**955.9**	**11,257.6**		
Total	**437,644.0**	**81,025.0**	**19%**	**60,407.0**	**1,034.4**	**20,618.0**	**3.2**	**3,219.6**

Burimi: Albpetrol

Shoqëritë private të naftës raportojnë sasi më të lartë të rezervave në faqet e tyre zyrtare, në krahasim me rezervat e raportuara nga Albpetrol të përmbledhura më lart. Për shembull, Bankers Petroleum, që vepron në fushën naftëmbajtëse Patos-Marinzë raportoi rezerva të provuara në 122.9 milionë fuçi (ekuivalente me 18.6 milionë ton[16] naftë bruto), si dhe rezerva të provuara dhe të mundshme në 190.3 milionë fuçi (ekuivalente me 28.9 milionë ton naftë bruto) në fund të vitit 2015. Këto shifra ishin mbi 6 herë më të larta në krahasim me rezervat e raportuara nga Albpetrol.

Bankers dhe MIE shpjegojnë se këto dallime lindin sepse zhvillimi i metodës horizontale të shpimit rrit mundësitë e rimëkëmbjes së disa prej rezervave gjeologjike të klasifikuara më parë si të pa-rikuperueshme.

[15] Informacion zyrtarisht i raportuar nga Albpetrol për qëllim të këtij Raporti.
[16] 1 Metrik Ton i naftës së papërpunuar konvertohet në 6.5939 fuçi siç raportohet nga Administrata e Informacionit e Energjisë e SHBA për Shqipërinë në: http://www.eia.gov/cfapps/ipdbproject/iedindex3.cfm?tid=94&pid=57&aid=32&cid=AL,&syid=2010&eyid=2014&unit=BCOPMT

Siç është publikuar në raportin EITI për vitin 2015, zyrtari qeveritar përgjegjës për Zhvillimin e politikave në sektorin e naftës në MIE njoftoi se MIE planifikon të rivlerësojë rezervat sipas standardeve të aplikueshme në BE deri në vitin 2020[17].

Aktivitetet e kërkimit në dekadën e fundit

Gjatë dekadës së fundit, Qeveria e Shqipërisë ka dhënë disa PSA për blloqet e kërkimit në Shqipëri (tabela 3) dhe numëron vetëm një zbulim të naftës në pusin Shpiragu-2, të shpallur nga sipërmarrja e përbashkët e Petromanas Albania GmbH dhe Shell Upstream Albania B.V. në vitin 2013.

Shpenzimet kuazi-fiskale përfshijnë angazhime me anë të të cilave entitetet shtetërore ndërmarrin shpenzime publike, siç janë pagesat për shërbimet sociale, infrastrukturën publike, subvencionet e karburanteve dhe shërbimin e borxhit kombëtar, etj., jashtë procesit buxhetor kombëtar. MIE dhe Albpetrol informuan se ligji dhe rregulloret që rregullojnë veprimtarinë e Albpetrol nuk përfshijnë marrëveshje të tilla. Megjithatë, siç shpjegohet në seksionin 3.1, Albpetrol punëson pjesën më të madhe të punëtorëve të naftës, pavarësisht aktivitetit të saj në rënie, kjo mund të tregojë angazhimin e Albpetrol për të punësuar fuqinë punëtore më të madhe në koston e efikasitetit të saj të operacioneve, e nxitur nga objektivat shoqërore.

Privatizimi i pritshëm i Albpetrol

Parlamenti shqiptar vendosi të privatizojë Albpetrolin me ligjin nr.10490, datë 15 dhjetor 2011. Sipas këtij ligji, të drejtat e kërkimit dhe të prodhimit të Albpetrolit, si i licencuar primar do t'u nënshtroheshin kushteve të rregullta të referuara në Ligjin e Naftës për operatorët ekonomikë të naftës dhe gazit dhe do të bëhen efektive nga data e privatizimit. Në bazë të këtij vendimi, në prill 2012, Ministria përgjegjëse për sektorin e energjisë i dha Albpetrolit blloqe të reja kërkimi në zonën e Delvinës, Panajës, Velcës, Dumresë, 1, 4, 5, 6, 7 dhe 8 dhe blloqet e kërkimit në det të hapur Adriatik 2, Adriatik 3, Adriatik 4, dhe Rodoni Veri[53]. Ndërsa, në prill të vitit 2015, Këshilli i Ministrave vendosi[54] që në atë datë të rialokonte në MIE blloqet e kërkimit të lira të Dumresë, Panaja, 1, 4, 5, 6, 8 dhe C të mbajtura nga Albpetrol. Albpetrol mbajti bllokun e kërkimit të Delvinës dhe Velçës.

Në datën e këtij raporti, MIE informoi se Albpetrol po ristrukturohet dhe se Qeveria ende nuk ka vendosur për rolin e saj në këte proces apo mundësinë e privatizimit në të ardhmen.

Procesi i alokimit të marrëveshjeve hidrokarbure

Industria e naftës ka dy sisteme kryesore për dhënien e kontratave: oferta konkurruese, ku shoqëritë konkurrojnë kundër njëra-tjetrës për të ofruar kushtet më të mira në lidhje me një ose më shumë variabla të përcaktuara, si dhe negociatat e veçanta, ku investitorët negociojnë termat me anë të propozimeve për projekte të mundshme.

Sistemi i përdorur varet nga gjendja e sektorit të naftës. Marrëveshjet e veçanta zakonisht zbatohen në rastet kur të dhënat gjeologjike nuk janë të disponueshme, fushat e naftës nuk janë zbuluar ose në rast të zonave të vështira për t'u arritur.

Marrëveshjet e hidrokarbureve në Shqipëri janë negociuar në përputhje me "Rregulloren për procedurat e miratimit të marrëveshjeve hidrokarbure dhe licencë-marrëveshjeve, si dhe afatet përkatëse". Kjo rregullore paraqet hapat dhe afatet për vlerësimin e propozimeve. MIE[55], AKBN[56] dhe Albpetrol[57] paraqesin një përmbledhje të procesit sipas rregullores në faqet e tyre të internetit.

[53] VKM nr. 279, datë 12.4.2012 "Për miratimin e listës së blloqeve të operimit të naftës, pjesë e Marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë dhe Albpetrol të datës 26 korrik 1993"
[54] VKM nr. 335, datë 22 Prill 2015 "Për disa ndryshime në VKM nr. 279 të datës 12 prill 2012
[55] MIE: http://www.energjia.gov.al/al/publikime/blloqet-e-lira-te-kerkimit
[56] AKBN: http://www.akbn.gov.al/rregullore-per-procedurat-e-miratimit-te-marreveshjeve/
[57] Albpetrol: http://www.albpetrol.al/marreveshjet-hidrokarbure/baza-ligjore/

Fillimi i procedurave të licencimit miratohet me urdhër të Ministrit përgjegjës për energjinë. MIE publikon në faqen e saj të internetit zonat e lira të kërkimit dhe fushat e naftës si dhe urdhërat e Ministrit për fillimin e procedurave të aplikimit dhe afatet përkatëse: http://www.energjia.gov.al/al/publikime/blloqet-e-lira-te-kerkimit.

Kriteri kryesor për vlerësimin e aplikimeve është kapaciteti teknik , teknologjinë, personelin, dhe përvojat e mëparshme, kapaciteti financiar dhe burimet e financimit në dispozicion, termat financiarë dhe planin e propozuar të punës dhe çdo aspekt tjetër në interes të publikut.

Për rastet e zonave të administruara nga AKBN, PSA-ja miratohet dhe nënshkruhet nga Ministri i MIE, ndërsa për zonat e administruara nga Albpetrol, PSA nënshkruhet nga përfaqësuesi ligjor i Albpetrol.

Kur dy ose më shumë subjekte konkurojnë për të njëjtën zonë nafte, AKBN apo Albpetrol i dërgon MIE-së dokumentat e shoqërive që aplikojnë, vlerësimin në bazë të kapacitetit teknik dhe financiar. Nëse propozimi miratohet nga MIE, ato mund të fillojnë negociatat me subjektin e zgjedhur.

Alokimi i PSA-ve

PSA të shumta jepen në sektorin e gazit dhe të naftës qëkur sektori i është kushtuar shoqërive private të naftës. Në raportin e EITI për vitin 2015, MIE njoftoi se pothuajse të gjitha PSA-të e nënshkruara deri në fund të vitit 2015, janë dhënë përmes marrëveshjeve të veçanta. Kushtet teknike dhe financiare të negociuara nuk janë bërë publike për shkak të kushteve të konfidencialitetit**.** Përfaqësuesi i MIE u shpreh në favor të publikimit të kushteve, duke iu nënshtruar miratimit të negociuar me shoqëritë e naftës. Negociatat për publikime kanë më pak të ngjarë të jenë të suksesshme në rast të shoqërive të mëdha të naftës dhe kanë më shumë gjasa për të arritur sukses në rastin e shoqërive më të vogla të naftës.

Gjatë viteve 2016 dhe 2017, MIE caktoi dy PSA të reja në bllokun eksplorues 8 dhe Velca. Metodat dhe kriteret e aplikuara për ndarjen e PSA-ve nuk janë publikuar. Sidoqoftë, versioni në gjuhën shqipe i PSA-ve është publikuar bashkangjitur miratimit të Qeverisë në gazetën zyrtare siç është udhëzuar në dhënien e kontratës**.**

Alokimi i koncesioneve të rafinimit të naftës

Koncesionet e licencave për rafineritë jepen në përputhje me ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar edhe me VKM nr. 19, datë 04.01.2015 "Procedurat dhe afatet për ndarjen dhe ripërtëritjen e licencave të koncesionit për rafinimin e naftës dhe prodhimin e nënprodukteve të naftës".

Në vitin 2016, MIE njoftoi për dhënien e dy koncesioneve të reja për rafinimin e naftës siç shpjegohet më sipër në seksionin 3.2. Metodat dhe kriteret për alokimin e këtyre koncesioneve nuk janë publikuar. Qeveria nuk mban një regjistër publik të koncesioneve të rafinimit, prandaj nuk mund të përcaktohet dot nëse koncesione të tjera të rafinimit janë dhënë më herët.

Ndarja e prodhimit të Albpetrolit

Albpetrol zotëron pjesë në naftën e prodhuar nga shoqëritë që veprojnë në zonat nën administrimin e saj, bazuar në prodhimin e supozuar (prodhimi i paregjistruar kur u transferua pusi - PEP) dhe prodhimi në rritje (prodhimi i lëshuar nga investimi i kontraktorit - ASP).

Aktualisht, kushtet e miratuara në lidhje me PEP dhe ASP për marrëveshjet e alokuara para 2016 nuk janë publikuar për shkak të klauzolave të konfidencialitetit. Versioni i vjetër i PSA-ve të caktuara, që publikohet në: http://www.resourcecontracts.org/countries/al tregon që:

- PEP është dakorduar si një pjesë neto e naftës bruto të prodhuar në gjashtë muajt para datës së transferimit të pusit. Kjo pjesë është zvogëluar në baza mujore eksponenciale.
- ASP-ja është dakordësuar si një pjesë e naftës së prodhuar që varion në bazë të nivelit të prodhimit dhe fazës së rikuperimit të kostos të matur me faktorin R[58].

Krahas PEP dhe ASP, disa marrëveshje përfshijnë edhe naftën e Qeverisë të alokuar bazuar në nivelin e faktorit R. Asnjë nga shoqëritë dhe as Qeveria nuk zbuluan pagesat e naftës së Qeverisë për periudhën 2011-2016.

Pjesa e prodhimit të alokuar për Albpetrol mund të paguhet në para ose në natyrë[59], megjithatë marrëveshjet e tanishme të naftës në fazën e prodhimit parashikojnë pagesa të bëra në naftë në vend të parasë. Me qëllim që pagesat të ekzekutohen, Albpetrol dhe shoqëritë e naftës duhet të bien dakord për këto ndryshime me shkrim. Bankers Petroleum deklaroi se nuk do të binte dakord të ndryshonte mënyrën e pagesës në para, me përjashtim nëse procedurat e dorëzimit në para konsiderojnë të gjitha kostot e trajtimit dhe financiare që lindin për shkak të këtij ndryshimi në mënyrën e pagesës[60].

Marrëveshja e licencimit të Albpetrol

Albpetrol dhe MIE firmosin një Licencë-Marrëveshje ku reflektohen termat dhe kushtet e Marrëveshjes së miratuar për hidrokarburet për zonat e administruara nga Albpetrol.

Marrëveshja e licencimit negociohet njëkohësisht me PSA-në dhe firmoset brenda 10 ditëve pas miratimit përfundimtar të MArrëveshjes së Hidrokarbureve (PSA-së).

Marrëveshjet hidrokarbure dhe Marrëveshjet e lidhura të licencimit për Albpetrol hyjnë në fuqi pas miratimit nga Këshilli i Ministrave.

Shitja e naftës së Albpetrolit (tregtia e mallrave)

Albpetrol shet naftën që nxjerr nga PSA nëpërmjet operacioneve të veta përmes ankandeve të hapura publike[61] në përputhje me ligjin dhe rregulloren për ankandet publike dhe rregullat e procedurat e vendosura në Urdhrin nr. 83, datë 10 shkurt 2012, i ndryshuar, i nxjerrë nga Ministri përgjegjës për sektorin e energjisë. Prandaj, Albpetrol organizon ankande të hapura për shpërndarjen e kontratave vjetore të naftës. Sasia e naftës së shitur bazohet në parashikimet vjetore të prodhimit të naftës dhe pjesës së naftës që rrjedh nga PSA. Albpetrol transferon naftë dhe mbledh pagesat e kontratës bazuar në një skemë të përcaktuar gjatë vitit.

Komisioni që drejton ankandin përbëhet nga 7 anëtarë duke përfshirë 3 përfaqësues nga MIE, 2 përfaqësues nga Albpetrol, 1 përfaqësues nga Inspektorati Teknik dhe Industrial i Shtetit ("STII") dhe 1 përfaqësues nga AKBN. Komisioni është kryesisht përgjegjës për hartimin e kushteve të ofertës, mbikëqyrjen e procesit dhe vlerësimin e ofertave.

Çmimi i nisjes së ankandit është vendosur në lidhje me çmimet e naftës Brent nëpërmjet një formule që konsideron cilësinë e naftës që do të tranferohet, qasjen në tregjet ndërkombëtare etj. Çmimi përfshin rregullime

[58] Faktori R llogaritet duke ndarë të ardhurat e grumbulluara të naftës që nga fillimi i operacioneve të PSA ndaj kostove të naftës të akumuluara për të njëjtën periudhë. Kuotat e grumbulluara gjatë periudhës zbriten nga të ardhurat.
[59] Udhëzimi i MIE dhe MF nr. 1, datë 26.5.2015 "Për rregullat dhe procedurat për arkëtimin në para të gatshme të vlerës së korrigjimit të PPE-së së transferueshme dhe pjesës së Albpetrolit"
[60] Informacion i deklaruar nga Bankers Petroleum për qëllim të këtij raporti
[61] Ligji nr. 9874, datë 14 shkurt 2998 "Për ankandin publik" dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1719, datë 17 dhjetor 2008 "Miratimi i rregullave të ankandit publik", i ndryshuar

për kostot e transportit duke konsideruar pikën e shpërndarjes. Çmimi vendoset nga një grup ekspertësh nga Albpetrol, AKBN, MIE dhe STII.

Tabela më poshtë përmbledh detajet e ankandeve të organizuara në 2013 dhe 2016.

Tabela 7 - Përmbledhje e ankandeve të organizuara 2013 - 2016

Viti i Ankandit	Sasia në ton	Cmimi fillestar	Oferta Fituese	Aplikantët Jo-Fitues	Qasja në procedurë
2013	200,000	Brent/1.65 $bbl. + K	Konsorciumi midis "TPD-Trading Petrol & Drilling (NUIS L21807013N)" dhe "Interpetrol Ltd (NUIS L52013058A)" me K = 0.12 $/bbl.	Europetrol Durres Ltd	Paraqitur në arkivin e MIE
2013	30,000	Brent/1.65 $bbl. + K ekuivalent me Brent x 60.61% $bbl. + K	Liona Sh.a. (NUIS L31731005C) me K = 0.1 $/bbl.	Asnjë aplikues tjetër	Paraqitur në arkivin e Albpetrol
2015	100,000	Brent x 72.52% - 5.55 $/bbl. + K	TPD-Trading Petrol & Drilling (NUIS L21807013N) me K = 0.1 $/bbl.	Asnjë aplikues tjetër	http://www.albpetrol.al/njoftim-ankandi-per-shitjen-e-naftes-brut-sasia-100-000-ton/
2016	30,000	Brent x 69.54% - 3.53 $/bbl. + K	Porto Romano Oil Sh.a. (NUIS K51625501O) K = 0 $/bbl.	Asnjë aplikues tjetër	Paraqitur në arkivin e Albpetrol
2016	167,000	Brent x 70.48% - 4.12 $/bbl. + K	Porto Romano Oil Sh.a. (NUIS K51625501O) K = 0.1 $/bbl.	Asnjë aplikues tjetër	Paraqitur në arkivin e Albpetrol

Detajet e sasive dhe vlerave të shitjeve për secilin kontraktues gjatë viteve 2013-2016 janë si më poshtë.

Tabela 8 - Përmbledhje e shitjeve të naftës së Albpetrol 2013-2016

Viti	Kontraktori	Sasia (ton)	Cmimi Mesatar US$/ton	Vlera e shitjeve në US$
2013	"Duçellari 2010" Sh.A	36,976.00	470.00	17,410,844.00
2013	"Niti Petrol Company" Sh.A	9,971.00	485.00	4,835,915.00
2013	Interpetrol Ltd	31,754.00	416.50	13,189,167.00
2013	LIONA Sh.A	15,171.00	435.00	6,578,108.00
2013	TPD Trading Petrol & Drilling Sh.A.	33,870.00	430.71	14,265,384.00
		127,742.00	**438.79**	**56,279,418.00**
2014	LIONA Sh.A	10,482.00	433.00	4,482,997.00
2014	*Pa Raportuar*	8,961.00	426.50	3,831,983.00
2014	TPD Trading Petrol & Drilling Sh.A.	108,216.00	385.13	42,269,051.00
		127,659.00	**400.00**	**50,584,031.00**
2015	TPD Trading Petrol & Drilling Sh.A	84,623.5	181.36	15,347,387
2015	Bankers Petroleum Albania Ltd.	17,676.2	213.97	3,782,225
2015	Sherwood International Ltd.	2,026.8	242.08	490,648
		104,326.50	**188.1**	**188.07**
2016	TPD Trading Petrol & Drilling Sh.A	37,786.4	132.10	4,991,560
2016	Porto Romano Oil Sh.a.	39,450.8	184.85	7,292,425
		77,237.20	**159.0**	**159.04**

Shitjet e mësipërme të deklaruara rrjedhin nga raportimi i Albpetrol-it të dorëzuar për raportin EITI. Të ardhurat e deklaruara më lartë u krahasuan dhe u përputhën me ato të raportuara nga Albpetrol në pasqyrat e saj financiare për vitet 2015 dhe 2016 siç tregohet në tabelën 9 më poshtë:

Tabela 9 - Krahasimi i shitjeve të naftës të raportuara nga Albpetrol me pasqyrat financiare të audituara

Viti	Të ardhurat në USD (sipas tabelës 8 më sipër)	Kursi i këmbimit i aplikuar për vitin 2015 dhe 2016	Të ardhurat (sipas tabelës 8 më sipër) të konvertuar në Lek '000	Të ardhurat sipas Pasqyrave Financiare të Albpetrol në Lek '000	Diferencat në Lek '000	Diferencat në %
2015	15,407,550	125.96	2,471,393	2,471,393	-	0%
2016	7,245,184	124.14	1,524,934	1,524,934	-	0%

Publikimi i kontratës

Të gjitha marrëveshjet e naftës në fuqi gjatë 2016 dhe 2017 u zhvilluan si marrëveshje për ndarjen e naftës ("PSA"). Lista e PSA-ve në fuqi dhe shoqëritë e naftës paraqitet në Shtojcën 5.



Ligji i naftës nuk përfshin dispozita për publimin ose mospublikimin e kontratës. Përfaqësuesit e MIE informuan se vendimi për publikimin e kontratave është rezultat i negociatave midis Qeverisë dhe shoqërive të naftës. Qeveria e Shqipërisë shprehet pozitive ndaj publikimit të kontratave, megjithatë deklarimi i kontratës nuk është përcaktuar si kusht i pakontestueshëm. Nuk ka ndryshime të planifikuara rregullatore në afat të shkurtër për dhënien e informacioneve shpjeguese të kontratës.

Kushtet e detajuara të marrëveshjeve të nënshkruara të naftës para vitit 2016 konsiderohen konfidenciale dhe nuk janë publikuar aktualisht për qasjen e publikut. Për publikimin e PSA-ve, duhet që MIE dhe shoqëritë private të naftës të japin autorizimin e tyre.

Në vitet 2016 dhe 2017, Qeveria e Shqipërisë publikoi versionin në shqip të dy PSA-ve në bllokun eksplorues 8 dhe Velca. Kopjet e kësaj kontrate i bashkëngjiten miratimit të VKM-së dhe mund të aksesohen në faqen zyrtare të gazetës www.qpz.gov.al:

- PSA në Bllokun 8 të miratuar nga VKM nr. 266 datë 6.4.2016, të botuar në gazetën zyrtare 63/2016;
- PSA në Bllokun Velca të miratuar nga VKM nr. 685, datë 22.11.2017, të botuar në gazetën zyrtare nr. 210/2017.

Kopjet e vjetra të disa PSA-ve të dhëna në blloqet e kërkimit dhe fushat e naftës në Shqipëri para 2016 janë botuar në faqet e mëposhtme:

Resource contract -http://www.resourcecontracts.org/countries/al

ResourceContracts.org është një arkivë e kontratave të disponueshme publikisht të naftës, gazit dhe minerare, që ka për qëllim promovimin e transparencës mbi investimet në industritë nxjerrëse dhe lehtëson kuptueshmërinë e kontratave që i qeverisin ato. Arkiva numëron 1,514 kontrata të dhëna për 45 burime të naftës dhe mineraleve në 90 qarqe.

Organizata mbështetet nga shumë partnerë të zhvillimit ndërkombëtar duke përfshirë Bankën Botërore.

Open data - http://open.data.al/sq/corporates/list/

Open Data Albania është një projekt i ndjekur nga Instituti Shqiptar i Shkencave me qëllim promovimin e transparencës dhe llogaridhënies së sektorit publik dhe angazhimin e pjesëmarrjes së qytetarëve.

Arkiva ofron detaje të kontratave publike të koncesioneve, prokurimeve dhe shpenzimeve të qeverisë lokale, dhe mbështetet nga disa donatorë ndërkombëtarë.

Regjistri i licencave

Ministria nuk publikon një regjistër të plotë të përditësuar të licencave në përputhje me kërkesat e EITI 2.3. Informacioni mbi fushat dhe blloqet e kërkimit të naftës dhe gazit është shpërndarë nëpër faqet e internetit të MIE, AKBN, Albpetrol dhe ALBEITI.

AKBN dhe Albpetrol sigurojnë listën e azhornuar të PSA-ve nën administrimin e tyre dhe mbajtësit e licencave në faqet e tyre zyrtare www.akbn.gov.al dhe www.albpetrol.al. Sidoqoftë, këto lista nuk përmbajnë datën e aplikimit, datën e dhënies së kontratës, koordinatat e zonave të kontratës. Regjistrat e publikuar nga MIE dhe AKBN në fund të vitit 2017, nuk përfshinin PSA që iu dha Albanides Energy Sh.a në vitin 2016. Ky fakt tregon se këto lista nuk janë përditësuar për më shumë se një vit.

Për më tepër, këto lista ofrojnë emrat fillestarë të operatorëve që iu është dhënë PSA-ja, por nuk përfshijnë përditësime për shitjet dhe transferimet e pronësisë pas dhënies së PSA-së fillestare. Regjistri, për shembull, nuk informon që operacionet në fushat e naftës të Cakran-Mollaj, Ballsh-Hekal dhe Gorisht-Kocul kontrollohen nga GBC Oil Ltd që nga shkurti i vitit 2016.

Përfshirja dhe roli i ALBEITI-t

Për të përmbushur kërkesën 2.3 të standardit EITI, ALBEITI mban një regjistër publik të të licensuarve që mbajnë PSA në naftë dhe gaz, në adresën e internetit të ALBEITI-t (http://www.albeiti.org/licensat-hidrokarbure/) dhe përmban informacionet e mëposhtme:

- Emri i plotë i kontraktorit duke përfshirë numrin e tij tatimor,
- Data në të cilën hyri në fuqi marrëveshja hidrokarbure,
- Afati i kontratës në vite,
- Lloji i licensës (kërkim dhe/ose prodhimi)
- Fusha(t) e naftës dhe/ose blloqet e kërkimit të dhëna, dhe koordinatat respektive
- Minerali/komoditeti i prodhuar
- Informacioni mbi transferimin e mëtejshëm të të drejtave, dhe
- Informacione shtesë, si vendndodhja e selisë, numri i punonjësve, etj.

ALBEITI mbledh informacione nga MIE, AKBN, dhe Albpetrol, dhe azhornon regjistrin cdo gjashtë-muaj. Respektivisht:

- Në fund të korrikut duke përfshirë informacionin e azhornuar deri në qershor, dhe
- Në fundt të janarit, duke përfshirë informacionin e azhornuar deri nl dhjetor të vitit paraardhës raportues.

Regjistri publik i ALBEITI-t publikon te gjitha informacionet e kërkuara nga kërkesa 2.3 e standardit EITI, me përjashtim të datës së aplikimit. MIE, AKBN dhe ALBEITI nuk e disponojnë këtë infomacion, për shkak se ka kaluar kohës e gjatë nga praktika e dhënies së PSA-së.

Pronarët përfitues

MIE nuk mban apo publikon një regjistër të pronarëve përfitues të angazhuar në kërkimin dhe prodhimin e naftës në Shqipëri.

Në datën e këtij raporti, Qeveria e Shqipërisë është në proces miratimi të ndryshimeve të reja rregullatore për të siguruar publikimin e plotë të pronarëve përfitues deri më 1 janar 2020 (referojuni seksionit 7.2). Siç është analizuar në seksionin 3.1, pronarët përfitues që zotërojnë shoqëri nafte në Shqipëri nuk janë publikuar ende.

3.3. Të ardhurat e qeverisë nga sektori i naftës dhe gazit

Shteti shqiptar mbledh të ardhura nga sektori i naftës dhe gazit nëpërmjet ndarjes së prodhimit të naftës, bonuset, rentën minerare, tatimit mbi fitimin dhe të ardhurave nga investimet direkte në sektor.

Qeveritë gjithashtu gjenerojnë të ardhura nga tarifat dhe licencat. MIE nuk ka raportuar të ardhurat e fituara nga licencat në vitin 2016, ndërsa raporti i AKBN dhe SHGJSH nuk ka dhënë të dhëna për të ardhura e përfituara nga të licencuarit e naftës dhe gazit në vitin 2016. Megjithatë, bazuar në informacionet e raportuara në raportet e mëparshme të EITI, këto shuma nuk përbëjnë të ardhura materiale.

Figura 4 më poshtë tregon shpërndarjen e të ardhurave totale të gjeneruara nga operacionet e naftës midis Qeverisë Shqiptare, shoqërisë Albpetrol, AKBN-së dhe shoqërive private të naftës. Interesi i Shtetit Shqiptar në PSA-të administrohet nga Albpetrol dhe AKBN, të cilat përfitojnë bonuse të nënshkrimit dhe trajnimit si dhe pjesë nga prodhimi i naftës dhe të ardhurave të tjera të cilat rrjedhin nga moszbatimi i termave të kontratave si gjoba dhe garanci të ekzekutuara, etj.

Figura 4 – Ndarja e të ardhurave nga sektori i naftës dhe gazit



(*) PSA-të nën administrimin e AKBN nuk kanë hyrë në fazën e prodhimit. Për këtë arsye nuk ekziston praktika aktuale e grumbullimit të pjesës së prodhimit nga AKBN dhe nuk ekzistojnë marrëveshje aktuale ndërmjet AKBN-së dhe Qeverisë për transferimin e naftës ose të ardhurave nga shitja e naftës nga AKBN tek Qeveria.

Të ardhurat kryesore nga sektori naftës dhe gazit në vitin 2016 paraqiten si më poshtë:

Tabela 10 - Të ardhurat kryesore nga sektori i naftës dhe gazit

Shoqëritë e naftës dhe gazit	Të ardhura nga sektori privat në MLek	Të ardhura nga Albpetrol në MLek	Të ardhura nga sektori privat në M$	Të ardhura nga Albpetrol në M$	Të ardhura (M$) alokuar		
					Buxheti i Shtetit	Albpetrol	AKBN
Renta minerare	2,136.9	139.5	17.2	1.1	18.3	(1.1)	-
Tatimi mbi fitimin	906.9	7.4	7.3	0.1	7.4	(0.1)	-
TVSH	5.3	234.3	0.0	1.9	1.9	(1.9)	-
TVSH në import (*)	4,743.6	-	38.2	-	38.2	-	
Pagesat për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	368.7	288.8	3.0	2.3	5.3	(2.3)	-
Tatimi mbi të ardhurat personale	687.8	82.0	5.5	0.7	6.2	(0.7)	-
Tatimi mbi dividendin		-	-	-	-	-	-
Tatimi në Burim	189.9	-	1.5	-	1.5	-	
Akciza (*)	431.9	-	3.5	-	3.5	-	-
Taksa e Karbonit (*)	35.0	-	0.3	-	0.3	-	-
Taksa e Qarkullimit (*)	315.0	-	2.5	-	2.5	-	-
Detyrime Doganore (*)	35.6	-	0.3	-	0.3	-	
Penalitete tatimore	1.0	149.3	0.0	1.2	1.2	(1.2)	-
Ndarja e prodhimit		1,090.9		8.8		8.8	-
Bonuset		70.5		0.6		0.2	0.4
Total	**9,857.7**	**2,062.8**	**79.4**	**16.6**	**86.7**	**1.7**	**0.4**

Këto të ardhura përbënin rreth 2.6% të të ardhurave totale të regjistruara në buxhetin e shtetit në 2016.

(*) Këto taksa paguhen për importet e aseteve dhe furnizimeve të bëra nga të licencuarit dhe mund të lidhen me inputet në aktivitetet e nxjerrjes sesa në tatimin e përfitimeve. TVSH-ja e paguar për importet mund të kreditohet ose rimbursohet plotësisht ose pjesërisht në varësi të kritereve të caktuara. Këto taksa nuk u zgjodhën për rakordim në 2016.

Renta minerare

Renta minerare përfaqëson zërin kryesor të të ardhurave të gjeneruara nga sektori i naftës dhe gazit në Buxhetin e Shtetit. Renta minerare përllogaritet mbi vlerën e tatueshme (ose vlerën fiskale) të të ardhurave nga aktiviteti i nxjerrjes, në bazë të ligjit "Për taksat kombëtare" nr. 9975, datë 28 korrik 2008, i ndryshuar. Renta minerare për eksportet mblidhet nga Administrata Doganore Shqiptare dhe renta minerare për shitjet brenda vendit mblidhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Sipas ligjit për taksat kombëtare, renta minerare nga shitja e naftës dhe gazit përllogaritet në masën 10% të vlerës së tatueshme.

Bazuar në ligjin për taksat kombëtare, renta minerare njihet në Buxhetin e Shtetit dhe shteti i transferon një pjesë të rentës minerare pushtetit vendor, (5% të rentës së paguar), përkatësisht njësisë së qeverisjes vendore prodhuese që gjeneron rentën (shih kapitullin 6).

Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin në sektorin hidrokarbur, i cili rregullohet nga Dekreti nr. 782 "Mbi sistemin fiskal në sektorin e hidrokarbureve", datë 22 shkurt 1994 ("Ligji për tatimin e naftës") përllogaritet në masën 50% mbi fitimin e tatueshëm. Sipas këtij ligji, në përllogaritjen e fitimit të tatueshëm merren parasysh të ardhurat dhe shpenzimet operative dhe kapitale të akumuluara sipas marrëveshjes së hidrokarbureve. Tatimi mbi fitimin zbatohet kur të ardhurat e akumuluara nga nafta tejkalojnë shumën e kostove kapitale dhe operative të naftës së akumuluar që prej fillimit të operacioneve.

Gjatë vitit 2016, buxheti i Shtetit arkëtoi tatim mbi fitimin nga Albpetrol dhe Bankers Petroleum.

Asnjë nga shoqëritë e tjera private nuk ka raportuar fitim të tatueshëm gjatë vitit 2016.

TVSH

Tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH) zbatohet në masën 20% mbi shitjet fiskale brenda vendit dhe 0% për eksportet në përputhje me Ligjin Nr. 92/2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar".

Me përjashtim të Albpetrol që e shet naftën brenda vendit, asnjë nga shoqëritë private të naftës nuk ka raportuar pagesa për TVSH-në, kjo si rrjedhojë e dominimit të shitjeve në eksport.

Pagesat për sigurime shoqërore dhe shëndetësore

Kontributet e detyrueshme për sigurimin e detyrueshëm shoqëror dhe shëndetësor përllogariten dhe paguhen bazuar në Ligjin Nr. 9136, datë 11.9.2003, "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Ligjin Nr. 10383, datë 4.2.2011 "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë". Këto ligje përcaktojnë kontributet minimale për përfitimin e pensionit shtetëror dhe kujdesin shëndetësor publik që janë të zbatueshme në sektorin e naftës. Siç shpaloset në seksionin 3.2, në vitin 2017, Qeveria paraqiti ligjin e ri mbi punonjësitt e naftës që do kenë ndikim në kostot e PSA në të ardhmen.

Tatimi mbi të ardhurat personale

Tatimi mbi të ardhurat nga punësimi përllogaritet dhe paguhet në përputhje me Ligjin Nr. 8438, Datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. Bazuar në këtë ligj të ardhurat nga punësimi deri në 30,000 Lek tatohen me normën 0%, të ardhurat e fituara mbi shumën 30,000 dhe deri në shumën 130,000 Lek tatohen me normën 13%, ndërsa të ardhurat e fituara mbi shumën 130,000 Lek tatohen me 23%.

Interesat e Shtetit në industrinë nxjerrëse

Shteti ka të drejtë të përfitojë dividentët dhe të ardhurat nga privatizimi i mundshëm i Albpetrol. Albpetrol është gjithashtu subjekt i tatimit dhe taksave të zbatueshme për shoqëritë tregtare si tatimi mbi fitimin, renta minerare, TVSH, etj.

Krahas shpërndarjes së dividentëve, nuk ka politika të tjera transferimi midis Shtetit dhe Albpetrol.

Të ardhurat e gjeneruara nga Albpetrol nga administrimi i PSA-ve

Të ardhurat kryesore që Albpetrol gjeneron nga PSA-të përfshijnë:

- Ndarja e prodhimit të naftës që i shkon Albpetrol-it, dhe
- Bonuset e trajnimit dhe të nënshkrimit.

Në dhjetor 2016, MIE prezantoi disa ndryshime në ligjin për hidrokarburet me qëllim që Shoqëritë e naftës të paguajnë tatim mbi fitimin që në fillim të fazës së prodhimit.

Rrjedhimisht, të gjitha PSA-të e lidhura pas këtij ndryshimi do të alokojnë 10% të të ardhurave si fitim neto dhe do paguajnë tatim fitim në masën 50% mbi këtë fitim.

Të ardhurat nga ndarja e prodhimit të naftës[62]

Të ardhurat nga ndarja e prodhimit të naftës përfaqësojnë fluksin kryesor të të ardhurave të mbledhura nga Albpetrol dhe zërin e dytë më të madh të të ardhurave nga sektori privat i naftës në vitin 2016. Albpetrol shet naftën e prodhuar dhe të përftuar nga marrëveshjet hidrokarbure nëpërmjet ankandeve publike vjetore. Detaje të ankandeve të organizuara nga Albpetrol për shitjet e paraqiten në seksionin 3.2 më sipër.

Sic tregohet në Grafikun 12, në vitin 2016, Albpetrol mblodhi 52.151 ton naftë[63] nga ndarja e prodhimit të naftës. Ky fluks është dukshëm më i ulët krahasuar me ndarjen e prodhimit të mbledhur në vitet 2011-2014, çka shpjegohet kryesisht nga një rënie e prodhimit të naftës bruto në vitet 2015 dhe 2016.

Grafiku 12 - Ndarja e Prodhimit alokuar Albpetrol 2011 - 2016 *(ton'000)*



Burimi: Albpetrol

Bonuset e nënshkrimit dhe trajnimit

Bonuset e nënshkrimit dhe trajnimit janë pagesa tipike të marrëveshjeve hidrokarbure. Ato përcaktohen brenda termave dhe kushteve specifike të kontratës (sipas negociatave të marrëveshjes) në momentin e dhënies së lejes së kërkimit ose prodhimit të naftës dhe gazit.

Të ardhurat e gjeneruara nga Albpetrol gjatë viteve 2011-2016 nëpërmjet PSA-ve paraqiten në Grafikun 13.

Lista e PSA-ve të nënshkruara për blloqet e naftës nën administrimin e Albpetrolit është paraqitur në Shtojcën 6.

Grafiku 13 - Bonuset e mbledhura nga Albpetrol 2011-2016 (ne USD'000)



Burimi: Albpetrol

Grafiku 14 – Ndarja e të ardhurave nga sektori i naftës



Sic është paraqitur në grafikun 14, përafërsisht 89.5% e të ardhurave të gjeneruara nga sektori privat i naftës dhe gazit u regjistruan drejtpërdrejt në Buxhetin e Shtetit. Rreth 10.1% e të ardhurave nga PSA-të u mblodhën nga Albpetrol, dhe një pjesë e vogël prej 0.4% nga AKBN. Albpetrol derdhi rreth 7.3 milion USD në Buxhetin e Shtetit, nëpërmjet pagesave të tatimit mbi fitimin, rentës minerare, TVSH-së etj.

Të ardhurat e gjeneruara nga AKBN nga administrimi i PSA-ve

AKBN punëson dhe zhvillon ekspertizën teknike në sektorin e naftës dhe gazit në mbështetje të rolit të saj për negocimin e marrëveshjeve hidrokarbure, oponencën teknike të projekteve të hidrokarbureve dhe monitorimin e zbatimit të këtyre projekteve etj.

[62] Ky informacion u raportua nga AKBN për përpilimin e këtij raporti.
[63] Ky informacion u raportua nga Albpetrol për përpilimin e këtij raporti

AKBN përfaqëson Shtetin në të gjitha marrëveshjet hidrokarbureve për blloqet dhe vendburimet e reja dhe përfton të ardhurat që rrjedhin nga PSA-të. Kur këto marrëveshje do të hyjnë në fazën e prodhimit, AKBN do të përfitojë të ardhura nga ndarja e prodhimit të naftës.

Grafiku 15, paraqet të ardhurat që përftoi AKBN nga PSA-të gjatë viteve 2011-2016. Gjatë kësaj periudhe, AKBN përftoi të ardhura kryesisht nëpërmjet mbledhjes së bonuseve të nënshkrimit dhe trajnimit, me përjashtim të vitit 2014, në të cilin përfshihen të ardhurat nga ekzekutimi i garancisë për përfundimin e PSA-ve për zonat A, B, D dhe E.

Asnjë nga PSA-të dhënë për zonat e administruara nga AKBN nuk ka hyrë në fazën e prodhimit prandaj, AKBN nuk ka të ardhura nga ndarja e prodhimit të naftës në këtë periudhë. Lista e PSA-ve të nënshkruara për blloqet e naftës nën administrimin e AKBN-së është paraqitur në tabelat 3 dhe 5.

Grafiku 15 -Bonuset e mbledhura nga AKBN 2011-2016 (në mijë USD)



Burimi: AKBN

3.4 Pagesat sociale dhe ekonomike

Pagesat Sociale

Shpenzimet sociale janë shpenzime sociale materiale të bëra nga shoqëritë në dobi të publikut dhe shoqërisë civile, siç është mandatuar me ligj ose me kontratën me Qeverinë.

Qeveria dhe shoqëritë e naftës të përfshira në sektorin e naftës informuan se aktualisht Marrëveshjet hidrokarbure në fuqi nuk përfshijnë pagesa sociale të detyrueshme që duhet të kryhen nga shoqëritë e naftës në dobi të komuniteteve.

Koha dhe shuma e pagesave sociale vendosen nga shoqëritë e naftës në diskrecionin e tyre. Shoqëritë duhet t'i shpalosin shpenzimet e buxhetuara për AKBN / Albpetrol për miratim si pjesë e miratimit vjetor të buxhetit.

Këto deklarime u konfirmuan edhe me versionet e kontratës të publikuara.

Provizionet për investime në infastrukture dhe marrëveshjet e shkëmbimit

Provizionet për investime në infastrukturë dhe marrëveshjet e shkëmbimit përfshijnë prokurimin e të mirave dhe shërbimeve (duke përfshirë hua, grante dhe punime civile ose infrastrukturë), në shkëmbim të plotë apo të pjesshëm për të drejtat e zbulimin apo prodhimin e naftës, gazit ose mineraleve. Kjo marrëdhënie mund të përfshijë gjithashtu shkëmbimin e të mirave të prodhuara.

Qeveria dhe shoqëritë e përfshira në sektorin e naftës informojnë se marreveshjet hidrokarbure në fuqi nuk përmbajnë marrëdhënia shkëmbimi *"barter"*. Përkrah konfirmimeve ne analizuam marrëveshjet e naftës të pubikuara në internet.

Bankers Petroleum, prodhuesi më i madh i naftës, informon se ka bërë investime në infrastrukturë, si aktivitete të zhvilluara në kuadrin e përgjegjësisë sociale.

3.5 Projektet e gazit dhe infrastruktura në vend

Projekti Trans-Adriatic Pipeline (Projekti TAP)

Burimi: www.tap-ag.al

Shqipëria është pjesë e vendeve transit të Trans Adriatic Pipeline (TAP). TAP do të transportojë gaz natyror nga fusha Shah Deniz II në Azerbajxhan për në Europë (www.tap-ag.al). TAP pritet të nxisë zhvillimin ekonomik dhe krijimin e vendeve të punës përgjatë rrugës së gazsjellësit, duke përfshirë Shqipërinë. Ky do të jetë një burim i madh i investimeve të huaja direkte që nuk varet nga grantet ose subvencionet. TAP filloi ndërtimin e infrastrukturës së tubacionit në 2016 dhe pret të fillojë tranzitin e gazit në vitin 2020.

TAP është aktualisht kontribuesi më i madh i investimeve të huaja direkte në vend. Që nga fillimi i ndërtimit deri në fund të vitit 2016, TAP ka investuar rreth 1.5 miliardë euro, nga këto 1 miliard euro janë investuar në 2016. Siç është vendosur në Marrëveshjen e Qeverisë Pritëse midis TAP dhe Qeverisë Shqiptare, TAP do të shpenzojë 14 milionë euro në infrastrukturë dhe investime të tjera në dobi të shoqërisë civile dhe komuniteteve.

Investimet e TAP dhe aktivitetet sociale të kësaj korporate mund të gjehen në faqen e saj zyrtare www.tap-ag.al.

Burimi: www.tap-ag.al

Ionian Adriatic Pipeline (Projekti IAP)[64]

TAP ka hyrë në disa Marrëveshje Mirëkuptimi dhe Bashkëpunimi (MoUC) me sipërmarrësit e projektit Ionian Adriatic Pipeline (IAP), me qëllim që të sjellë gazin Kaspik në tregjet e vendeve të pa-gazifikuara si Shqipëria, Mali i Zi, Kroacia Jugore dhe Bosnjë-Hercegovina. Projekti IAP përbën një pjesë të rendësishme strategjike të rrjetit shpërndarës të gazit në Shqipëri, për shkak të rrugës së planifikuar dhe kapacitetit transportues.

Mbështetje e mëtejshme për lidhjen TAP-IAP erdhi në maj 2013 kur Qeveria e Shqipërisë, Bosnje-Hercegovina, Kroacia dhe Mali i Zi nënshkruan një Marrëveshje Mirëkuptimi në mbështetje të dy gazsjellësave, si dhe deklaratën e mbështetjes nga Këshilli i Iniciativës Adriatiko-Joniane (Adriatic Ionian Initiative Council).

[64] Burimi: https://www.tap-ag.al/lajme-dhe-evente/2013/05/27/the-adriatic-and-ionian-initiative-council-signs-a-declaration-in-support-of-tap

Bazuar në të dhënat e studimit të fizibilitetit, tubacioni 515 km me kapacitet vjetor prej 5 miliard m3 gazi (5 bcm), do të lidhë stacionin TAP në Fier me Kroacinë me një kosto totale të vlerësuar prej 618 milion euro.

Infrastruktura e gazit në Shqipëri

Qeveria Shqiptare miratoi ligjin për sektorin e gazit natyror Nr.102 / 2015 "Për sektorin e gazit" në mars të vitit 2015. Ky ligj do të qeverisë zhvillimin e infrastrukturës për transmetimin dhe shpërndarjen e gazit në Shqipëri.

Në vitin 2016, Qeveria themeloi Operatorin Shqiptar të Transmetimit të Gazit (Albgaz Sh.a.) dhe prezantoi draft master-planin për rrjetin e shpërndarjes së gazit[65]. Ky studim i ndërmarrë nga COWI, kushtoi rreth 1.1 milion euro dhe u financua nga BE.

Drafti i master-planit analizon përdorimin e gazit në industri, transport dhe konsumatorët familjarë etj. TAP do të jetë burimi kryesor i furnizimit me gaz, ndjekur nga Ionian-Adriatic Pipeline (IAP) dhe rezerva të tjera potenciale të vendit. Drafti konsideron mundësinë e lidhjes së Kosovës dhe Maqedonisë me rrjetin Shqiptar të shpërndarjes së gazit. Gjithashtu, plani konsideron dhe mundësinë e depozitimit të gazit në nëntokën e Divjakës, në Dumre.

Sipas studimit, konsumi vendas i gazit parashikohet të jetë rreth 2,167 milion m^3 në vitin 2040 (duke përfshirë bujqësinë dhe transportin). Në të njëjtin vit, përdorimi potencial i gazit për prodhimin e energjisë elektrike vlerësohet të jetë rreth 770 milion m^3, ndërsa përdorimi potencial i gazit në proceset e rafinerimit të naftës parashikohet të jetë 89 milion m^3.

Tirana (kryeqyteti) dhe Durrësi pritet të zënë rreth 32% të konsumit vendas të gazit, ndërsa i gjithë sektori industrial si i tërë pritet të jetë 37% të konsumit total vendas të gazit.

Drafti i plotë i master-planit është publikuar në faqen e internetit të MIE dhe mund të aksesohet në linkun e mëposhtëm: http://energjia.gov.al/master-plani-i-gazit-natyror-per-shqiperine/.

Në vitin 2016, qeveria vendosi të themelojë "Albgaz" sh.a. si një degë nga operacionet e gazit, që mbaheshin më parë nga Albpetrol. Albgaz ka një kapital aksionar prej 359,068,000 Lekë dhe zotërohet 100% nga Qeveria e Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Albgas do të kryejë funksionin e operatorit të transmetimit të gazit në përputhje me Ligjin nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit".

[65] Burimi: http://www.energjia.gov.al/al/njoftime/lajme/masterplani-i-gazit-gjiknuri-piketat-e-zhvillimit-te-20-30-viteve-te-ardhshme&page=4

4. Sektori minerar

Shqipëria ka një histori të gjatë në sektorin minerar të nxjerrjes së kromit, nikelit, bakrit dhe gurit gëlqeror. Studimet gjeologjike të kryera në vitet 1945-1995, kanë zbuluar depozita të konsiderueshme të mineralit të kromit, bakrit, hekur-nikelit, bitumit, dhe minerale jo-metalore si gur gëlqeror dhe gurë dekorativë etj. Sektori i dominuar më parë nga shoqëri me pronësi shtetërore u hap ndaj investimeve private në vitin 1994, pas miratimit të Ligjit për sektorin minerar.

4.1 Kërkimi, zhvillimi dhe prodhimi në sektorin minerar

Në 2016, sektori dominohej nga shoqëritë private, të cilat operonin 600 leje në shfrytëzim minerar dhe vepronin kryesisht në rrethet e Bulqizës (123), Beratit (44), Krujës (34), Kukësit (42), Matit (34), Tropojës (30) dhe 261 leje të tjera shpërndara në 29 rrethe të vendit (grafiku 16).

Qeveria e Shqipërisë është e angazhuar në sektorin e minerar duke qënë aksionere në shoqëritë në vijim.

Grafiku 16 - Lejet sipas rretheve

Burimi: MIE

Tabela 11 – Përfshirja e Qeverisë Shqiptare në sektorin e minerar

NUIS	Entiteti	Aksionet e Qeverisë Shqiptare	Aksionet e Investitorëve Privatë	Comments
J81920006K	ALB BAKRI SH.A.	100.00		Ish ndërmarrja industriale shtetërore e bakrit në likuidim që nga viti 2011
K72120014C	ALBMINIERA sh.a.	100.00		Ish ndërmarrje minerare shtetërore hyri në likuidim në janar 2016
J61827513H	ALBKROMI SH.A.	100.00		Ish ndërmarrja shtetërore e kromit në likuidim që nga viti 2010
J82816206B	ELBASAN CEMENT FACTORY sh.p.k	20.69	79.31	Investimi i krijuar në vitet 90 si rezultat i privatizimit të ish shoqërisë shtetërore "çimento" Sh.A
J66703740S	ITALB - MERMERI - MUHUR sh.p.k.	25.00	75.00	
J62904210Q	UNITED QUARRIES sh.p.k.	13.09	86.91	Investimi i krijuar në vitet '90 si rezultat i privatizimit të ish shoqërisë shtetërore "guri gëlqeror" Sh.A

Këto subjekte shtetërore janë nën likujdim. MIE informoi se ka për qëllim privatizimin e pjesëmarrjes shtetërore në shoqëritë e tjera. Këto shoqëri nuk i kanë paguar asnjë dividend shtetit në 6 vitet e fundit, siç tregohet në raportin e dividentit të publikuar nga Ministria e Financave në faqen e saj të internetit: http://www.financa.gov.al/al/raportime/thesari/shpenzimet-dhe-te-ardhurat/dividenti-sipas-periudhave.

Grafiku 17 - Lejet sipas mineralit



Burimi: MIE

Aktiviteti minerar në vend është fokusuar kryesisht në nxjerrjen e mineraleve të kromit, bakrit, hekur-nikelit dhe nikel-silikatit, zhavorrit dhe rërave bituminoze, gurit gëlqeror, argjilës, gëlqeror pllakor etj. Përpunimi i mineraleve në vend është i ulët. Koncesionet dhe investimet private në vend mundësojnë pasurimin e mineralit të kromit dhe bakrit, prodhimin e ferrokromit, çimentos, tullave, betonit dhe materialeve të tjera ndërtimore. Hekur-nikeli dhe nikel-silikat eksportohet siç nxirret nga nëntoka. Vendimi për përpunimin e mineralit në vend ndikohet nga cilësia e mineralit të prodhuar dhe kërkesa në tregun ndërkombëtar.

Sic tregohet në grafikun 17, numri më i madh i shoqërive punojnë në sektorin guror me 282 leje në shfrytëzim, ndjekur nga sektori i kromit me 261 leje në shfrytëzim, hekur-nikel e nikel-silikat me 31 leje në shfrytëzim dhe bituminozët dhe bakri, përkatësisht me 15 dhe 11 leje shfrytëzimi.

SHGJSH raporton aktivitet minimal në kërkimin e mineralit të kromit, hekur-nikelit, nikel-silikat, bakrit dhe arit. Asnjë nga këto të licencuar nuk kanë raportuar një zbulim në këtë fushë gjatë vitit 2016. Lista e të licencuarve të angazhuar në aktivitetet e kërkimit ofrohet nga ALBETI në faqen e saj të internetit: www.albeiti.org.

Prodhimi minerar

Grafiku 18 - Prodhimi Minerar 2011-2016 (M$)



Burimi: AKBN and Administrata Doganore Shqiptare

Grafiku 18 në të djathtë paraqet prodhimin minerar sipas grupeve kryesore të mineraleve në vend nga viti 2011 deri në vitin 2016. Viti 2013 shënoi një vit të sukseshëm për sektorin minerar me një prodhim të vlerësuar rreth 235 milion USD. Në vitin 2016 vlera e prodhimit minerar u ul në 214.1 milion USD.

Kromi dhe ferrokromi zinin peshën krysore të prodhimit minerar gjatë vitit 2016 me rreth 69%.

Materialet ndërtimore kryesuar nga çimento përbënin nën-sektorin e dytë më të rëndësishëm pas kromit me rreth 20%. Bakri, përbërjet e nikelit, dhe rëra e zhavorri bituminoz zinin së bashku 4% të vlerës së prodhimit minerar në vitin 2016.

Shpenzime Kuazi-Fiskale

Shpenzimet kuazi-fiskale përfshijnë marrëveshje me anë të të cilave subjektet shtetërore ndërmarrin shpenzime publike shoqërore, siç janë pagesat për shërbimet shoqërore, infrastrukturën publike, subvencionet e karburanteve dhe shërbimin e borxhit kombëtar, etj. të cilat janë jashtë procesit buxhetor kombëtar. Qeveria ka përfshirje në sektorin e minerar nëpërmjet zotërimit 100% të aksioneve të ish shoqërive minerare që tani janë në likuidim apo nëpërmjet pjesëmarrjes duke zotëruar 25% të aksioneve, të rezultuara nga privatizimi i objekteve minerare / aseteve të zotëruara më parë nga shteti / SoEs.

MIE konfirmoi se nuk ka marrëveshje të tilla në sektorin minerar.

Tabela 12 më poshtë përmbledh të dhëna kryesore për prodhimin dhe rajonet kryesore prodhuese sipas mineraleve në vend.

Tabela 12 – Aktiviteti minerar

Mineral	Prodhimi për vitin 2016 *(në mijë ton)*	Vlera në M$	Numri i shoqërive në prodhim	Rajonet kryesore prodhuese	Rezervat gjeologjike[66] *(milion ton)*
Kromi	730	148.7	261	Bulqizë, Kukës, Tropojë, Pukë	10
Ferrokromi	49		1		
Bakri	14	0.2	11	Pukë	50
Hekur-nikel & nikel-silikat	440	8	30	Kukës, Librazhd, Pogradec	300
Bitum ranor & Zhavorr	25	0.6	15		
Çimento	855	43.4	2	Krujë, Fushë-Krujë, Berat, Tiranë, Lezhë, Vlorë, Kavajë	-
Gur gëlqeror dhe të tjera	3,409 ton & 3,161 mijë m^3	13.2	282		
Total		**214.1**	**600**		

Punësimi në sektorin minerar

Bazuar në të dhënat e AKBN të përmbledhura në grafikun 19, sektori minerar punësoi afërsisht rreth 5,500 punonjës në vitin 2016. Nën-sektori i kromit dhe ai guror punësuan përkatësisht rreth 68% dhe 26% të forcës punëtore në vitin 2016.

Grafiku 19 - Punësimi në sektorin minerar 2011-2016



Burimi: AKBN

Numri i punonjësve të siguruar nga AKBN është dukshëm më i ulët se numri i të punësuarve të deklaruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për të njëjtën periudhë prej 11,000. AKBN nuk ka dhënë një shpjegim për këtë mospërputhje. Këto mospërputhje mund të jenë për shkak të gabimeve të trashëguara në metodat e përdorura nga AKBN për të mbledhur dhe për të prodhuar statistikat e punësimit ose burimin e informacionit i cili bazohet në vetë-deklarimet e paraqitura nga të licencuarit në vend të informacionit të verifikuar. Në mënyrë alternative, informacioni i ofruar nga DPT mund të përfshijë numrin e punonjësve të angazhuar në aktivitete të tjera jo-nxjerrëse kur të licencuarit regjistrojnë aktivitete nxjerrëse dhe jo-nxjerrëse nën të njëjtin numër tatimor (NUIS).

[66] VKM 479, datë 29 qershor 2011 "Për aprovimin e Strategjisë Minerare në Republikën e Shqipërisë".

Për të sqaruar dhe zgjidhur këtë mospërputhje, AKBN duhet të kryejë rekordime periodike me DPT-në për të verifikuar informacionin e dhënë nga të licencuarit.

Rezervat

Studimet për rezervat dhe hartat minerare janë kryer përpara vitit 1990. Që prej asaj kohe, MIE dhe SHGJSH nuk janë angazhuar më në studime të mëtejshme për rivlerësimin e rezervave për depozitat ekzistuese sipas standarteve bashkëkohore ndërkombëtare.

Informacioni zyrtar për rezervat gjeologjike është publikuar në Strategjinë Minerare për vitet 2010-2025 miratuar me VKM nr. 479 më datë 29 qershor 2011.

Eksportet nga sektori minerar

Eksportet nga sektori minerar ishin rreth **27.69 miliardë Lek** (ekuivalente me 223.09 milion USD) dhe përfaqësonin rreth 11.4% të totalit të eksporteve.

Pavarësisht nga ndryshimet e pafavorshme në çmimet ndërkombëtare për mineralet e kromit, ferrokromit dhe çimentos, eksportet e tyre u rriten në pesë vitet e fundit si rezultat i rritjes së aktivitetit minerar në këta nën-sektorë.

Grafiku 20 – Eksportet nga Sektori Minerar në Milion USD



Burimi: Autoritetet Doganore

4.2 Aktiviteti minerar sipas mineraleve

Minerali i kromit

Kromi është minerali kryesor i prodhuar në vend dhe kontribuesi kryesor në punësim në sektorin minerar.

Rezervat e rikuperueshme të kromit (me cilësi mesatare 30.8% Cr_2O_3) vlerësohen rreth 10 milion ton[67], dhe janë përqëndruar kryesisht në rajonin e Bulqizës, Kukësit, Hasit, Matit dhe Pogradecit. Strategjia aktuale në këtë sektor fokusohet në tërheqjen e investimeve të mëdha strategjike në përpunimin e mineraleve të kromit (Figura 5).

Në fund të vitit 2016, nën-sektori kromit numëroi 261 leje shfrytëzimi për nxjerrjen e kromit nga vendburimet e zbuluara para viteve '90 dhe dy leje për shfrytëzimin e mbetjeve të kromit (sterilet) dhe ferro-kromit (skorjet), të depozituara përkatësisht në rrethin e Bulqizës dhe Elbasanit.

Aktivitetet e prodhimit janë përqëndruar në rajonin e Bulqizës me rreth 121 leje aktive për shfrytëzim gjatë vitit 2016.

Prodhimi shqiptar i kromit eksportohet si mineral ose përpunohet për prodhimin e ferrokromit. Me qëllim nxitjen e përpunimit të mineralit në vend, në nëntor 2014, Shteti shqiptar uli rentën e zbatuar për mineralet metalike në masën 2/3 e normës nominale të zbatuar për mineralet e përpunuara në vend. Gjatë vitit 2015 u vu re një rritje e prodhimit të ferro-kromit me 31% krahasuar me një vit më parë. Në fund të vitit 2016, Qeveria reduktoi më shumë rentën e zbatuar për mineralet metalike në masën ½ të normës nominale të zbatuar për mineralet e përpunuar në Shqipëri.

Albchrome[68] Sh.p.k. është Shoqëria më e madhe industriale dhe punëdhënësi më i madh në sektorin e kromit në Shqipëri. Albchrome zotëron një kontratë koncesioni me Qeverinë Shqiptare që nga viti 2001 për prodhimin dhe përpunimin e mineralit të kromit dhe ferrokromit. Pasuritë e Shoqërisë përfshijne minierat e kromit në Bulqizë, fabrikat e ferrokromit në Elbasan dhe Burrel, fabrika e pasurimit të kromit në Klos, dhe elementë të tjerë të infrastrukturës minerare dhe metalurgjike.

Prodhimi kromit

Grafiku 21 prezanton prodhimin e kromit për vitet 2011-2016. Sipas AKBN[69], **prodhimi i kromit** nga lejet aktive ishte rreth **729,946 ton në vitin 2016**, ku Bulqiza kontribuoi me rreth 434,713 ton ose 60% e prodhimit të kromit, ndjekur nga Kukësi me 15% dhe Tropoja me 10% të prodhimit të kromit. Rreth 43% e prodhimit të kromit u gjenerua nga 10 prodhuesit më të mëdhenj kryesuar nga Albchrome me 12%. Gjithë kromi i prodhuar në vend eksportohet në formën e xeherorit të kromit ose ferro-kromit.

Figura 5 – Depozitat e Kromit



Burimi: AKBN – www.akbn.gov.al

Grafiku 21 - Prodhimi i Kromit 2011-2016



Burimi: AKBN

Grafiku 22 - Eksportet e Kromit 2011-2016



Burimi: Administrata Doganore Shqiptare

[67] Burimi: VKM nr.479, datë 29 qershor 2011 "Për miratimin e Strategjisë Minerare të Republikës së Shqipërisë".
[68] Informacioni për Albchrome gjendet në faqen zyrtare të internetit – www.balfin.al dhe www.albchrome.al.
[69] Informacioni për prodhimin, vendburimet, numri i punonjësve është bazuar në të dhëna të raportuara nga AKBN për analiza në këtë raport.

Eksportet e mineralit të kromit në vitin 2016 ishin rreth **591,936 ton** me vlerë **11.6 miliardë Lek** (ekuivalente me 93.3 milion USD)[70]. Sic paraqitet në grafikun 22, Kina përfaqëson destinacionin kryesor të kromit shqiptar, me 62% të eksportit të kromit. Destinacione të tjera kryesore të mineralit të kromit shqiptar ishin Zvicra (7%), Turqia (7%), Ishujt Cayman (6%), Hongkongu (6%), etj.

Gjatë vitit 2016, Albchrome, shoqëria e vetme e nxjerrjes së ferrokromit në Shqipëri, **prodhoi** dhe **eksportoi** rreth **42 mijë ton Ferrokrom** në vlerën **6.9 miliardë Lek** (ekuivalente me 55.4 milion USD)[71]. Grafiku 23 tregon që Italia ishte destinacioni kryesor i eksportit për ferrokromin shqiptar(34%), i ndjekur nga Hollanda (13%), Austria(10%), etj.

Grafiku 23 - Eksportet e Ferrokromit 2011-2016



Burimi: Administrata Doganore Shqiptare

Për shkak të mungesës së statistikave të sektorit, vlera e prodhimit të kromit dhe ferrokromit është e bazuar në vlerat e eksportit. Së bashku, prodhimi i kromit dhe ferrokromit të eksportuar kishte vlerën e **18.5 miliardë lek** (ekuivalentë me 148.7 milion USD).

Punësimi

Sipas AKBN-së[72], në vitin 2016 kromi punësoi rreth 3,745 punonjës ose rreth 68% të totalit të të punësuarve në sektorin minerar.

10 prodhuesit më të mëdhenj me 43% të prodhimit të kromit kishin 1,324 të punësuar ose 35% të totalit të të punësuarve në sektorin e kromit. Albchrome punësoi rreth 819 punonjës ose 22% të totalit të të punësuarve në sektorin e kromit.

Sipas grafikut 24, numri i të punësuarve në krom është rritur vazhdimisht gjatë periudhës 2011-2016, pavarësisht luhatjeve në sasinë e prodhuar. Të licencuarit në zonën e Bulqizës punësuan rreth 77% të fuqisë punëtore të punësuar në sektorin e kromit.

Bazuar në të dhënat e raportuara për sasinë e prodhuar dhe numrin e të punësuarve, rezulton se sektori i kromit prodhoi mesatarisht 195 ton për të punësuar gjatë vitit 2016. Ky raport mendohet të jetë edhe më i lartë duke patur parasysh se një pjesë e të punësuarve janë angazhuar në fabrikat e pasurimit dhe prodhimit të ferro-kromit. Vlera e shtuar në vend, referuar

Grafiku 24- Numri i të punësuarve për prodhimin e kromit 2011-2016



Burimi: AKBN

[70] Informacioni për sasinë, vlerën dhe destinacionin e eksportit u raportua nga Administrata Doganore Shqiptare për qëllime të analizave në këtë raport.
[71] Informacion mbi sasitë, vlerat dhe vendet e eksportit u raportuan nga Administrata Doganore Shqiptare për këtë raport
[72] Informacioni për prodhimin, vendburimet, numrin e punonjësve është bazuar në të dhëna të raportuara nga AKBN për analiza në këtë raport.

vlerës në eksport, përllogaritet në 39.7 mijë USD për të punësuar në 2016[73].

[73] Vlera e shtuar në vend për të punësuar në vitin 2016 u përftua nga pjestimi i vlerës në eksport me numrin e punonjësve.

Minerali i bakrit

Gjatë viteve 1980, industria e bakrit ishte industria më e suksesshme në sektorin nxjerrës në Shqipëri.

Rezervat gjeologjike të mineralit të bakrit (përfshirë Cu 1.3-2.65%, zink, ar dhe argjend) vlerësohen rreth 50 milionë ton[74]. Gjithsesi, rezervat e rikuperueshme vlerësohen të jenë 27 milionë ton. Depozitat e bakrit ndodhen në gjashtë rajone: Puka, Mirdita, Korça, Shkodra, Hasi dhe Kuksi.

Rezervat e rikuperueshme në minierat aktuale të bakrit arrijnë rreth 4.7 milionë ton (Cu 1.39%). Rezervat e rikuperueshme në zonat e reja vlerësohen në 13.4 milionë ton, ku 7.9 milion ton (Cu 1.85%) ndodhen në Munellë dhe 5.6 milionë ton (Cu 2.65%) ndodhen në Lak-Rosh, Perlatin e Jugut, Karmë 2 dhe Bregun e Gështenjës.

Aktiviteti i nxjerrjes dhe pasurimit të bakrit është përqëndruar në rrethin e Pukës, ku vepron Beralb, shoqëria më e madhe industriale për nxjerrjen e bakrit (www.beralb.com). Beralb zotëron një marrëveshje koncesioni që nga viti 2001 dhe ishte e vetmja shoqëri industriale që nxirrte bakër deri në shtator 2015, kur njoftoi një pezullim të përkohshëm të operacioneve.

Beralb ka licensa për shfrytëzimin e minierave të Munellës, Lak-Roshit, Karmës dhe Fush-Arrësit, si edhe tre miniera të tjera që ndodhen në krahinën e Pukës. Beralb pasuron bakrin përmes Fabrikës së Pasurimit në Fushë-Arrëz me një kapacitet vjetor prej 600,000 ton në vit, që prodhon rreth 45,000 ton koncentrat bakri. Shoqëria ka realizuar studime të ndryshme për të përmirësuar parametrat e cilësisë në trajtimin e xeherorit sidomos për rikuperimin e zinkut, arit, argjendit dhe elementëve të tjerë të çmuar.

Beralb raporton për investimet kumulative në aktivitet që kapin vlerën 70 milionë USD, nga të cilat 40 milionë USD u investuan në minierën e Munellës dhe rreth 30 milionë USD në kapacitetet e pasurimit.

Aktiviteti i biznesit të bakrit ka pësuar humbje të konsiderueshme për shkak të rënies së çmimeve ndërkombëtare të bakrit. Sic tregohet në grafikun 25, çmimet ndërkombëtare të mineraleve të bakrit[75] ranë me 45% nga viti 2011 në 2016. Çmimi mesatar për bakër (LME), grada A arriti pikën më të ulët në janar 2016 në 4,472 dollarë për ton. Që atëherë, çmimet janë rikuperuar vazhdimisht dhe kanë arritur në 6,808 USD në shtator 2017.

Në shtator 2015, Beralb njoftoi vendimin për të pezulluar veprimtaritë e tij për një periudhë të paktën 1 vjeçare derisa tregu i bakrit të rikuperohej. Shoqëria raportoi se për shkak të kostove të ekstraktimit dhe cilësisë së ulët (përqëndrimit) të mineralit, prodhimi do të mbulojë kostot operative kur çmimi ndërkombëtar i bakrit është rreth 6,000 USD për ton[76].Qeveria akordoi një periudhë pezullimi deri në Maj 2017. Bazuar në termat e pezullimit, Beralb i paguan 400 punonjësve të tij një shpërblim prej 220 USD për të punësuar.

Në vitet 2011-2015, Beralb ishte punëdhënësi më i madh industrial në nënsektorin e bakrit. Megjithë rikuperimin e lehtë të çmimeve të bakrit (grafiku 25), nuk kishte ndryshime pozitive në situatën e Beralbit. Në vitin

Figura 6 – Depozitat e Bakrit



Burimi: AKBN – www.akbn.gov.al

Grafiku 25 - Cmimet ndërkombëtar të bakrit US$ / Mton



Burimi: World Bank Commodity Price Data (The Pink Sheet)

[74] Burimi VKM nr.479, datë 29 qershor 2011 "Për miratimin e Strategjisë Minerare të Republikës së Shqipërisë"
[75] Burimi për çmimin ndërkombëtar të bakrit: http://databank.worldbank.org/data
[76] Informacion i deklaruar nga Prof. Sokol Mati, anëtar i Bordit të Drejtorëve të Beralbit për qëllim të këtij raporti

2016, Beralb nuk raportoi asnjë aktivitet nxjerrës dhe kishte vetëm 7 punonjës nëpër të shtatë njësitë minerare. Kjo shpjegon uljen e konsiderueshme në numrin e punonjësve të raportuar në nënsektorin e bakrit në 2016.

Gjatë këtyre viteve, Beralb eksportoi prodhimet tek partnerët e saj strategjikë në Kinë dhe Turqi.

AKBN[77] raporton se prodhimi bakrit në vitin 2016 ra në **14,265 ton** vlerësuar **në 87.6 milionë Lek** (ekuivalente me 0.7 milionë USD) bazuar në çmimet e eksportit në vitin 2016. Ky prodhim është nxjerrë në Gjegjan, Kukës përmes Trade Minerals Sh.p.k. që kishte një fuqi punëtore prej 75 personash në vitin 2016 (77% e totalit të fuqisë punëtore të nën-sektorit të bakrit në vitin 2016).

Në 2016, Administrata Doganore Shqiptare[78] raportoi ekportet e bakrit në **3.5 mijë ton**, vlerësuar me **20.5 milionë Lek** (ekuivalente me 0.2 milionë USD). Ishujt e Virgjër Britanikë (59%) dhe Kina (11%) ishin vendet kryesore për eksportet e bakrit në 2016.

Grafiku 26- Prodhimi dhe punësimi në sektorin e bakrit



Burimi: AKBN

Grafiku 27 - Eksporti i Bakrit 2011-2016



Burimi: Administrata Doganore Shqiptare

[77] Informacioni për prodhimin, vendburimet, numrin e punonjësve është bazuar në të dhëna të raportuara nga AKBN për analiza në këtë raport.
[78] Informacioni mbi sasitë, vlerat dhe vendet e eksportit u raportuan nga Administrata Doganore Shqiptare për këtë raport.

Minerali i hekur-nikelit dhe nikel-silikat

Vendi ynë është i pasur me hekur-nikel dhe nikel-silikat me përmbajtje Ni 0.85-1.15%. Rezervat e nikelit gjenden kryesisht në afërsi të Pogradecit, Librazhdit, Bilishtit, Kukësit dhe Peshkopisë dhe vlerësohen të jenë rreth 300 milionë ton[79] (figura 7).

Sektori i nikelit është relativisht i pashfrytëzuar në krahasim me potencialin e tij. AKBN[80] raportoi 30 të licencuar që përdorin hekur-nikel dhe nikel-silikate në minierat dhe guroret ekzistuese. Në vitin 2016, vetëm 17 shoqëri nga 27 të licencuarit deklaruan një **prodhim** të mineralit të hekur-nikel dhe nikel silikat **në 440,432 ton**.

AKBN nuk jep detaje të përbërjes dhe / apo përqëndrimit të mineralit të prodhuar brenda grupit. Megjithatë, duke marrë parasysh që i gjithë minerali eksportohet pa u përpunuar, prodhimi u vlerësua në **1.1 miliardë Lek** (ekuivalent me 8.7 milionë USD), bazuar në çmimet në eksport gjatë vitit 2016.

AKBN raportoi gjithsej 127 të punësuar në aktivitetin e nikelit, dhe gjeneroi një prodhim mesatar prej 3,468 ton minerali për punonjës deri në vitin 2016.

Nikeli është nxjerrë kryesisht në formën e hekur-nikelit dhe nikel-silikatit,

Grafiku 28 - Prodhimi dhe punësimi në sektorin e nikelit ton'000



Burimi: AKBN

në rrethet Librazhd 45%, Kukës 27%, dhe Pogradec 16%, etj.

Figura 7 –Depozitat e Nikelit



Burimi: AKBN – www.akbn.gov.al

[79] VKM 479, datë 29 qershor 2011 "Për aprovimin e Strategjisë Minerare në Republikën e Shqipërisë".
[80]Informacioni për prodhimin, vendburimet, numrin e punonjësve është bazuar në të dhëna të raportuara nga AKBN për analiza në këtë raport

Autoritetet doganore[81] raportuan **eksporte** të mineralit të hekur-nikelit dhe nikel-silikat rreth **347 mijë ton** në vlerën **0.9 miliardë Lek** (ekuivalente me 6.9 milionë USD) në vitin 2016 (grafiku 29).

Eksportet në vitin 2016 përbëjnë rreth 79% të prodhimit vendas.

Eksportet e nikelit gjatë vitit 2016 kishin destinacion kryesor Kosovën (68%) dhe Maqedoninë (32%).

Grafiku 29 - Eksportet dhe Prodhimi ton'000



Burimi: AKBN

[81] Informacioni për sasinë, vlerën dhe destinacionin e eksportit u raportua nga Administrata Doganore Shqiptare për qëllime të analizave në këtë raport.

Prodhimi i gurit gëlqeror dhe mineraleve të tjera

Siç është paraqitur në figurën 8, studimet gjeologjike në Shqipëri në vitet 1995 zbuluan rreth 32 lloje të ndryshme të gurëve dhe mineraleve industrialë për ndërtim të shpërndarë në gjithë sipërfaqen e vendit duke përfshirë: gëlqerorët, ranorët, dolomitet, gurët dekorativë, argjilës, granitet, gipset, etj. Këto minerale përfaqësojnë burimin kryesor të lëndëve të para për industrinë e ndërtimit në Shqipëri.

Sektori guror është mjaft i fragmentizuar me 282 licenca, nga të cilat 227 leje janë dhënë për shfrytëzimin e gurit gëlqeror dhe gëlqeror pllakor. Gjatë vitit 2016, 273 subjekte nga 282 të licencuar raportuan prodhim të gëlqerorëve (3.4 milionë m^3 dhe 2.1 milionë ton), argjilave (0.8 milionë ton), gips alabastër (131 mijë ton), ranorëve (18.9 mijë m^3) etj.

Prodhimi nga nën-sektori i materialeve të ndërtimit, duke përfshirë vlerën e shtuar nëpërmjet përpunimit ishte rreth **1.6 miliardë Lek**[82] (ekuivalente me 13.2 milionë USD) në vitin 2016. Bazuar në të dhënat e AKBN, nënsektori punësoi rreth 1,416 punonjës në 2016.

Eksportet[83] kapën shifrën **8.4 miliard Lek** (ekuivalente me 67.3 milionë USD) në vitin 2016, ku ekportet e çimentos kishin një vlerë prej **855 mijë ton** me vlerë **5.4 miliard Lek** (ekuivalente me 43.4 milionë) (grafiku 30). Eksportet kishin për destinacion vendet e rajonit: Kosovë, Mali i Zi, Maqedoni, etj. Eksportet e çimentos përbënin 83% të vlerës së eksporteve

Grafiku 30 - Prodhimi dhe punësimi në sektorin guror në M$



Burimi: AKBN

nga sektori guror me një sasi të përgjithshme prej 855 mijë tonësh.

Prodhimi i bitumit, rërës dhe zhavorrit bituminoz

Depozitat shqiptare të bitumit dhe asfaltit ndodhen afër Selenicës dhe në luginën e lumit Vjosa. Nën-sektori i bitumit dhe bituminozëve numëron rreth 15 subjekte të licencuar për shfrytëzimin e rërave dhe zhavorrit bituminoz. Gjatë vitit 2016, 8 subjekte raportuan prodhimin e **25,4 mijë ton rërë dhe zhavorr bituminoz**, i cili u vlerësua me rreth **78 milionë Lek** (ekuivalente me 0.6 milionë USD). Nën-sektori punësoi rreth 70 punonjës në vitin 2016. Prodhimi i nën-sektorit u shit në tregun e brendshëm vendas.

Figura 8 – Depozitat e Gurit Gëlqeror dhe mineraleve të tjera të ndërtimit.



Burimi: AKBN – www.akbn.gov.al

[82] Vlera e shtuar është përcaktuar duke përdorur çmimet e përftuara nga të dhënat e raportuara nga AKBN dhe në rastin e çimentos kur për sasinë dhe të ardhurat nga prodhimi dhe kur prodhimi u eksportua janë përdorur çmimet e përftuara në eksport bazuar në të dhënat e raportuara nga Administrata Doganore Shqiptare.
[83] Informacioni për sasinë, vlerën dhe destinacionin e eksportit u raportua nga Administrata Doganore Shqiptare për qëllime të analizave në këtë raport.

4.3 Organizimi dhe qeverisja e sektorit minerar

Sektori minerar në Shqipëri rregullohet nga Ligji nr. 10304 "Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", datë 15 korrik 2010 ("Ligji Minerar"), i cili hyri në fuqi në gusht të vitit 2010 dhe shfuqizoi Ligjin Minerar të mëparshëm nr. 7796, datë 17 shkurt 1994. MIE dhe AKBN paraqesin një përmbledhje të ligjeve dhe rregulloreve në fuqi për sektorin minerar në faqet e tyre të internetit, përkatësisht www.akbn.gov.al dhe www.energjia.gov.al.

Ligji Minerar i grupon mineralet në katër kategoritë e mëposhtme:

1. Metalet, jo-metalet, qymyri dhe bitumi;
2. Mineralet që përdoren në ndërtim;
3. Mineralet të çmuara dhe gjysëm të çmuar;
4. Mineralet radioaktive.

Ligji minerar dhe aktet rregullative shoqëruese paraqesin kushtet kryesore të lejeve minerare për aktivitetet e kërkimit dhe shfrytëzimit për secilin grup mineralesh.

Në vitin 2016, të gjitha shoqëritë minerare ishin licencuar në kërkim dhe / ose shfrytëzim të mineraleve të klasifikuar në dy grupet e para, me përjashtim të Jab Resources sh.p.k, i cili në bazë të informacionit të dhënë nga SHGJSH ishte duke operuar një licencë kërkimi në ar. SHGJSH njoftoi se asnjë nga të licencuarit që operojnë një licencë kërkimi nuk raportojnë zbulime në vitin 2016.

Rregullorja e miratuar me VKM nr. 364 në 4 maj 2011 "Për përcaktimin e kritereve, të vlerës minimale të sipërfaqes së zonës së lejuar minerare dhe të vlerës minimale të investimit e të prodhimit për një leje minerare". Këto përcaktime variojnë nga tipi i mineralit, sidoqoftë sipërfaqja maksimale nuk mund të tejkalojë limitet e vendosura në ligj si më poshtë:

Tabela 13 – Afatet dhe sipërfaqet për lejet minerare

	Metalet, jo-metalet, qymyri dhe bitumi	Mineralet që përdoren në ndërtim
Afati për lejet e kërkimit	3 vite (deri në 2 vite shtesë)	1 vit
Sipërfaqja maksimale në kërkim	jo më e madhe se 100 km^2	jo më e madhe se 10 km^2
Afati për lejet e shfrytëzimit	25 vite (deri në 10 vite shtesë)	
Sipërfaqja maksimale në shfrytëzim	jo më e madhe se 10 km^2	jo më e madhe se 5 km^2

Leja për shfrytëzim i jep të licencuarit të drejtën ekskluzive për zhvillimin e infrastrukturës, nxjerrjen dhe zotërimin e mineralit të prodhuar në zonën e licencuar. MIE mund të japë gjithashtu leje për përpunimin e mbetjeve minerare. Të licencuarit inkurajohen të investojnë në impiantet e përpunimit.

Mbikqyrja dhe garancitë financiare

Sipas Ligjit të ri Minerar (2010), të licencuarit në këtë sektor nuk janë të detyruar të paguajnë taksën mbi sipërfaqen në shfrytëzim. Në vend të saj, ligji i ri paraqet konceptin e përfshirjes së planit të rehabilitimit mjedisor dhe të planit vjetor të punës dhe investimeve.

Në përputhje me kuadrin e ligjit minerar, të licencuarit prezantojnë çdo vit planin vjetor për investimet dhe rehabilitimin e mjedisit tek AKBN dhe SHGJSH, të cilat miratojnë planet për të licencuarit nën mbikqyrjen e tyre. Në vijim, të licencuarit depozitojnë çdo vit garanci financiare në favor të

MIE, në përputhje me planet vjetore të miratuara. Rregullat për depozitimin dhe kthimin e garancive financiare dhe vlerave minimale përcaktohen në Rregulloren e miratuar me VKM nr. 440, datë 16 qershor 2011, ndryshuar[84], dhe Urdhërin e Ministrit përgjegjës për energjinë nr. 718, datë 3 tetor 2011.

Depozita për garancinë financiare për investimet përcaktohet në vlere jo më të vogël se 10% e planit vjetor të investimit. Garancia i kthehet e plotë të licencuarit nëse investimi kryhet i plotë dhe brenda afatit të përcaktuar. Nëse i licencuari realizon më pak se 90% të investimit, MIE mund të përvetësojë garancinë dhe të regjistrojë të ardhurat në buxhetin e saj.

Depozitat financiare për garancinë për planin minimal të investimit për lejet në kërkim përcaktohen në një shumë të barabartë me planin e miratuar për lejet për kërkim përgjatë afatit të lejes, në çdo rast jo më pak se vlerat minimale të investimit e përcaktuara në VKM nr. 364, datë 4 maj 2011.

Depozita për garancinë financiare për rehabilitimin e mjedisit përcaktohet në bazë të planit të miratuar të prodhimit vjetor. Këto depozita kthehen kur i licencuari rehabiliton zonën e dëmtuar në përputhje me planin. Në të kundërt, MIE mund të përvetësojë garancinë dhe të kontraktojë rehabilitimin e mjedisit në atë zonë.

Ligji minerar kërkon që përzgjedhja e nën-kontraktorëve për aktivitetet minerare të miratohet nga MIE në përputhje me kriteret tekniko-financiare që janë zbatuar për alokimin e lejes minerare.

Gjithashtu, ligji minerar parashikon edhe punësimin e stafit teknik për kohëzgjatjen e licencës së kërkimit dhe / ose prodhimit.

Perspektiva e operatorëve në kërkim-zbulim[85]

Siç përmendet në raportin e EITI për vitin 2015, Shoqata e Investitorëve të Huaj në Shqipëri (FIAA), ka informuar në disa raste se shuma minimale e kërkuar për tu investuar dhe depozituar si garanci për liçensat e kërkimit në Shqipëri ishin jashtëzakonisht të larta (të paarsyeshme), krahasuar me vendet fqinje si Kosova.

Krahas kërkesave të investimeve, sipas shoqatës FIAA, afati për lejen minerare në kërkim-zbulim duhet të jetë jo më pak se 6 vite, duke patur parasysh kushtet e ftohta klimaterike të blloqeve të kërkimit në verilindje të vendit.

Dhënia e lejeve minerare

AKBN dhe SHGJSH mbështesin MIE-n në procedurat para dhe pas licencimit, përkatësisht AKBN për lejet e prodhimit dhe SHGJSH për lejet e kërkimit.

MIE i jep lejet minerare përmes konkurrimit publik për zonat minerare konkurruese dhe nëpërmjet negociatave të veçanta, ku aplikimi i parë shqyrtohet i pari për licencim në zonat e hapura minerare. Zonat minerare konkurruese dhe të hapura përcaktohen në planin vjetor bazuar në kriteret e mëposhtme:

- Procedurat konkuruese zbatohen aty ku rezervat gjeologjike paraqesin interes të rëndësishëm ekonomik;

[84] VKM nr. 440, datë 16 qershor 2011, ndryshuar nga VKM nr. 741, datë 9 shtator 2015.
[85] Ky informacion u konfirmua nga Z. Përparim Aliaj, Drejtues i shoqatës së investitorëve të huaj në Shqipëri (FIAA) për qëllime të këtij raporti.

- Negociatat e veçanta zakonisht zbatohen për zona me informacion të kufizuar mbi rezervat, ose kur të licencuarit prezantojnë një plan të zgjeruar të aktivitetit në zonat fqinje, si dhe strategji të tjera me interes të rëndësishëm publik.

Me vendim të Këshillit të Ministrave, MIE mund të japë koncesione minerare për projektet e vlerësuara me interes të rëndësishëm ekonomik dhe social.

MIE publikon planin vjetor të kadastave minerare për vitin pasardhës në faqen e saj të internetit: http://infrastruktura.gov.al/planifikimi-minerar/.

Plani jep specifikime teknike të kadastrave minerare, duke përfshirë:

- Numrin kadastral, sipërfaqen, koordinatat dhe vendndodhjen,
- Minerali dhe përqërndrimi në %,
- Rezervat gjeologjike,
- Tipi i liçensave (kërkim ose prodhim),
- Prodhimi minimal i kërkuar në ton ose m^3,
- Investimi minimal i kërkuar në USD,
- Proçedura e alokimit të ofertave (baza konkurruese ose negociuese)

Zona Shfrytëzimi — Plani 2018

Nr. Rendor	Nr. i Zonës	Qarku	Të Dhëna për Vendburimin: Emri i Vendburimit	Lloji i Mineralit	Rezervat Gjeologjike në Ton/m3	Cilësia në %	Lloji i Veprimtarisë Minerare	Lloji i Zonës Minerare	Sipërfaqja Minimale	Prodhimi Minimal	Investimi Minimal	Sipërfaqja e Zonës km2	Kordinatat e Zonës: Pika	Y	X
1	12/1	Kukes	Gostil	Argile	94 000 t	12% Al2O3	Konkurruese	Shfrytezimi	0.02	10 000 m3	21.0 mln	0.202	1	4462111	4657564
													2	4461897	4657556
													3	4461474	4657858
													4	4461726	4658184
2	132/6	Korce	Mborje	Gelqeror	750 000 m3	44.5% CaO	Konkurruese	Shfrytezimi	0.02	10 000 m3	21.0 mln	0.203	1	4483262	4495409
													2	4484062	4495400
													3	4484059	4495151
													4	4483257	4495150
3	152/1	Permet	Banja	Ranor Silicor	150 000 m3	54.6% SiO2	Konkurruese	Shfrytezimi	0.02	1 000 m3	28.0 mln	0.050	1	4436899	4469927
													2	4437075	4469968
													3	4437178	4470067
													4	4437294	4470125
													5	4437382	4470165
													6	4437365	4470005
													7	4437194	4469920
													8	4436910	4469880
4	201/6	Elbasan	Shushice	Bazalte	5 000 000 m3	46.9% SiO2	Konkurruese	Shfrytezimi	0.02	10 000 m3	21.0 mln	0.231	1	4429325	4551336
													2	4429011	4551095
													3	4428628	4551523

Bazuar në interesin e treguar, MIE publikon njoftimet për procedurat konkurruese, përfshirë termat e referencës dhe kriteret e vlerësimit të ofertës, në faqen saj zyrtare http://infrastruktura.gov.al/procedurat-konkurruese-per-zonat-minerare/.

Ofertat konkurruese minerare ndahen në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik nr. 24/2017. Njoftimet për ofertat individuale publikohen në faqen e agjencisë së prokurimit publik: www.app.gov.al.

Agjencia e Prokurimit Publik (APP), e cila raporton drejtpërsëdrejti te Kryeministri, mbikqyr aktivitetin e prokurimit publik duke përfshirë dhënien e lejeve dhe koncesioneve minerare.

Çdo njoftim individual i ofertës ofron të njëjtat të dhëna të përfshira më herët në planin vjetor dhe liston kriteret teknike dhe financiare që duhet të plotësohen nga kandidatët e suksesshëm, siç përmblidhen më poshtë.

- Kapaciteti teknik dhe eksperienca e firmës dhe e stafit të saj — Deri në 15 pikë
- Kapaciteti financiar duke përfshirë flukset e parasë dhe mundësitë e financimit — Deri në 20 pikë
- Parashikimi i prodhimit për kohëzgjatjen e licencës — Deri në 15 pikë
- Parashikimi i vlerës së prodhimit për kohëzgjatjen e licencës — Deri në 10 pikë
- Parashikimi i prodhimit për përpunim — Deri në 20 pikë
- Investimet e projektuara në zonë — Deri në 10 pikë
- Norma e brëndshme e kthimit të projektit (IRR) — Deri në 10 pikë

Kryetari i komisionit të vlerësimit, brenda 20 (njëzet) ditëve nga komunikimi me ofertuesit, përgatit raportin përmbledhës dhe ia propozon fituesin, dhe radhën e subjekteve sipas pikëve të fituara, titullarit të autoritetit kontraktues. Bazuar në këtë raport, APP informon kandidatët zyrtarisht nëpërmjet postës elektronike, mbi detajet si më poshtë:

a) Emrat e të gjithë aplikantëve;
b) Emrin e ofertës fituese dhe vlerën e ofertës fituese;
c) Emrat e aplikantëve jo-fitues dhe arsyet e mos kualifikimit;
d) Ankesat e paraqitura gjatë proçesit

Pjesëmarrësit mund t'i paraqesin ankesat e tyre pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 5 ditëve nga njoftimi i rezultateve të ofertave nga APP.

Komisioni i Prokurimit Publik (KPP) është një autoritet i pavarur i ngarkuar për trajtimin e ankesave, diskriminimin e pretenduar dhe mospërputhjen me procedurat rregullatore. KPP i raporton direkt Parlamentit shqiptar. APP dhe Autoriteti Kontraktues nuk mund të vazhdojnë me ndarjen e licencave para përfundimit të procedurave të hetimit nga KPP. Vendimi i KPP-së mund të ndryshojë rezultatet e ofertës dhe çdo njoftim të kontratës të bërë nga Autoriteti Kontraktues ose APP në emër të tij.

Pajtueshmëria me kërkesën 2.2 të EITI-t

Procedurat e ndjekura plotësojnë kërkesën 2.2 të standardit EITI, me përjashtim të deklarimit publik të emrit të aplikantëve që nuk janë fitues. MIE informon se një deklarim i tillë nuk lejohet nga ligji për prokurimin publik dhe çfarëdo ndryshimi duhet të konsiderohet me kujdes nga perspektiva e aplikantëve që nuk janë fitues. MIE argumentoi zyrtarisht se përfshirja e APP dhe KPP në mbikëqyrjen e alokimit të drejtë dhe në baza jodiskriminuese të licencave minerare, duhet të jetë e mjaftueshme për të parandaluar ndonjë praktikë korruptive ose diskriminuese dhe adresimin e shqetësimeve të pjesëmarrësve në kohën e duhur.

MIE informoi se nuk janë në plan ndryshime rregullatore për publikimin e plotë të aplikantëve jo-fitues.

Regjistri i licencave

MIE mban një regjistër publik të licencave në adresën e mëposhtme: http://www.infrastruktura.gov.al/lejet-minerare-ekzistuese. Ky regjistër nuk jep datën e aplikimeve dhe koordinatat e licencës në përputhje me kërkesat e EITI 2.3. Për më tepër, regjistri siguron vetëm emrin e licencës dhe jo numrin tatimor. Bazuar në përvojën lokale, numri unik i taksave do të ishte i nevojshëm për të ndihmuar lexuesit e interesuar të kenë qasje në informatat e publikuara në qendrën kombëtare të regjistrimit duke përfshirë: pronarët ligjorë, pasqyrat financiare, raportet e auditimit[86]. Frekuenca me të cilën MIE përditëson këtë regjistër nuk është e qartë. Versioni më i azhornuar i regjistrit të botuar përfshin licencat e reja të dhëna deri në shkurt 2016, duke listuar 643 licenca aktive.

MIE nuk ka njoftuar zyrtarisht apo komentuar se cilat janë pengesat për publikimin e informacionit të plotë në përputhje me standardin EITI 2.3. Kërkesat me përfaqësuesit e MIE zbuluan se informacioni nuk grumbullohet dhe përpunohet në formën e sugjeruar nga Standardi dhe kërkon përpjekje dhe kohë shtesë.

Përfshirja dhe roli i ALBEITI-t

Në përpjektje për të përmbushur kërkesën 2.3 të standardit EITI, ALBEITI mban një regjistër publik të të licensuarve në sektorin e kërkimit dhe prodhimit minerar. Ky regjistër është në faqen e tij në internet (http://www.albeiti.org/regjistri-minerar/) dhe përmban informacionet e mëposhtme:

- Emri i plotë i kontraktorit duke përfshirë numrin e tij tatimor,
- Numri i licensës,

[86] Kur subjektet i nënshtrohen auditimit sipas Ligjit për Auditimin nr. 10091 "Për auditimin ligjor, organizimin e auditorit të regjistruar dhe profesionin e kontabilitetit të akredituar", të datës 5 mars 2009

- Data e aplikimit (nga viti 2012),
- Data e dhënies së liçensës,
- Afati i kontratës në vite,
- Lloji i licensës (kërkimi dhe/ose prodhimi)
- Kadastra(t) minerare të dhëna, dhe sipërfaqet, koordinatat dhe rrethet respektive ku janë vendosur,
- Minerali i prodhuar
- Informacioni mbi transferimin e mëtejshëm të të drejtave, dhe
- Informacione të tjera shtesë, etj.

ALBEITI mbledh informacione nga MIE, AKBN, dhe Albpetrol, dhe azhornon regjistrin cdo gjashtë muaj. Respektivisht:

- Në fund të korrikut duke përfshirë informacionin e azhornuar deri në qershor, dhe
- Në fundt të janarit, duke përfshirë informacionin e azhornuar deri nl dhjetor të vitit paraardhës raportues.

Përveç përpilimit të regjistrave, ALBEITI kryen kontrolle dhe verifikime të informacionit në dokumentet e publikuara në Qendrën Kombëtare të Biznesit ose të dhëna nga MIE, AKBN dhe SHGJSH. Para publikimit të regjistrave, ALBEITI ballafaqon informacionin që do të publikohet me listat e publikuara në faqet e internetit të MIE dhe AKBN. Çdo mospërputhje e konstatuar konfirmohet me MIE dhe AKBN para se regjistrat të përditësohen në faqen e internetit të ALBETI-t.

Regjistri publik i ALBEITI-t përmbledh të gjitha informacionet e listuara nga kërkesa 2.3 e standardit EITI, me përjashtim të datës së aplikimit për liçensat e dhëna përpara vitit 2012. MIE, AKBN dhe ALBEITI nuk e disponojnë këtë infomacion, për shkak se ka kaluar kohës e gjatë nga praktika e dhënies së liçensës.

Të dhënat rreth kontratave

Shteti shqiptar planifikon të publikojë termat e plota të licencave për akses publik, në Qendrën Kombëtare të Biznesit në faqen e mëposhtme: http://qkb.gov.al/search/search-in-the-register-of-licenses-permits-and - authorizations / licencave të lëshuara-jashtë-NBC/ . Shumë dokumenta të licencës dhe vendime shoqëruese dhe ndryshime janë ngarkuar tashmë në këtë portal dhe mund të arrihen përmes kërkimeve dhe shkarkimeve të



funksioneve siç ilustrohet më poshtë:

Kontratat e koncesioneve minerare nuk janë bërë zyrtarisht publike. Ligji në fuqi as e lejon, as e ndalon publikimin e kontratave. MIE informoi se këto terma nuk mund të zbulohen për shkak të konfidencialitetit. MIE nuk ka njoftuar ndonjë ndryshim të planifikuar rregullator në këtë drejtim.

Duke marrë parasysh zhvillimet e ndërmarra me zbulimin e kontratave në sektorin e naftës dhe hidroenergjisë, MIE mund të konsiderojë zbatimin e kësaj praktike të mirë edhe në sektorin minerar.

Transporti i mineraleve

Aktualisht, mineralet transportohen nëpërmjet kamionëve nga minierat në destinacion vendas ose eksport.
Nuk ka njësi shtetërore që operojnë në transportin e mineraleve.



4.4 Pagesat sociale dhe ekonomike

Pagesat Sociale

Shpenzimet sociale janë shpenzime sociale materiale të bëra nga shoqëritë në dobi të publikut dhe shoqërisë civile, siç është mandatuar me ligj ose me kontratën me qeverinë.

Qeveria dhe shoqëritë më të mëdha minerare të angazhuara në sektorin minerar informuan se aktualisht Marrëveshjet në fuqi të licencave dhe koncesioneve minerare nuk përfshijnë pagesa sociale të detyrueshme që duhet të kryhen nga subjektet minerare në dobi të komuniteteve.

Koha dhe shuma e pagesave sociale vendosen nga shoqëritë minerare në diskrecionin e tyre.

Këto deklarime u konfirmuan edhe me versionet e kontratës të publikuara nga ALBEITI si dhe me marrëveshjet e koncesioneve të deklaruara publikisht.

Provizionet për investime në infastrukture dhe marrëveshjet e shkëmbimit

Provizionet për investime në infastrukturë dhe marrëveshjet e shkëmbimit përfshijnë prokurimin e të mirave dhe shërbimeve (duke përfshirë hua, grante dhe punime civile ose infrastrukturë), në shkëmbim të plotë apo të pjesshëm për të drejtat e zbulimin apo prodhimin e naftës, gazit ose mineraleve ose shkëmbimin e të mirave të prodhuara.

Qeveria dhe shoqëritë më të mëdha minerare të angazhuara në sektorin minerar informuan se aktualisht në fuqi marrëveshjet e koncesionit minerar dhe licencat minerare nuk përfshijnë marrëdhënia shkëmbimi *"barter"*.

Këto deklarime u konfirmuan edhe me versionet e liçensave të publikuara nga ALBEITI si dhe me marrëveshjet e koncesioneve të deklaruara publikisht.

4.5 Të ardhurat në Buxhetin e Shtetit nga sektori minerar

Shteti gjeneron të ardhurat e tij nga sektori minerar përmes mbledhjes së rentës zbatuar mbi vlerën e shitjes së mineraleve, tatimit mbi fitimin dhe taksave të tjera. Të ardhurat kryesore nga sektori minerar të analizuara më poshtë u regjistruan të gjitha në Buxhetin e Shtetin për vitin 2016:

Tabela 14 – Të ardhurat kryesore nga sektori minerar

	Të ardhura fiskale në MLek	Të ardhura fiskale në M$	Struktura në %
Renta minerare	1,265.1	10.2	21%
Tatimi mbi fitimin	948.1	7.6	16%
TVSH	847.5	6.8	14%
TVSH në import (*)	628.9	5.1	11%
Pagesat për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	1,485.0	12.0	25%
Tatimi mbi të ardhurat personale	329.3	2.7	6%
Tatimi mbi dividendin	59.8	0.5	1%
Tatimi në burim	61.5	0.5	1%
Akciza (*)	107.6	0.9	2%
Taksa e Karbonit (*)	160.9	1.3	3%
Detyrimet doganore (*)	16.2	0.1	0%
Penalitete tatimore	38.4	0.3	1%
Total	**5,948.4**	**47.9**	**100%**

Këto të ardhura përbënin rreth 1.4% të totalit të të ardhurave tatimore në Buxhetin e Shtetit në vitin 2016.

(*) Këto taksa paguhen për importet e aseteve dhe furnitorëve të bëra nga të licencuarit minerar dhe mund të lidhen me inputet në aktivitetet e nxjerrjes sesa në tatimin e përfitimeve. TVSH e paguar në import mund të kreditohet ose rimbursohet plotësisht ose edhe në mënyrë të pjesshme sipas kritereve të përcaktuara. Këto taksa nuk janë zgjedhur për rakordim në 2016.

Të ardhurat e tjera të gjeneruara nga AKBN dhe SHGJSH për shërbimet e kryera janë në total më të ulëta se 50 milionë lekë.

Renta minerare

Renta minerare përbën fluksin kryesor të të ardhurave nga aktiviteti minerar. Ajo përllogaritet mbi vlerën e tatueshme (ose vlerën fiskale) të të ardhurave nga aktiviteti nxjerrës, në bazë të ligjit Nr. 9975, datë 28 korrik 2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar. Renta për eksportet mblidhet nga Administrata Doganore Shqiptare dhe për shitjet vendase nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Në përputhje me ligjin për taksat kombëtare, renta minerare regjistrohet në Buxhetin e Shtetit dhe një pjesë të rentës së mbledhur transferohet tek njësitë e qeverisjes vendore që gjeneruan prodhimin minerar. Kjo pjesë është përllogaritur në 5% e prodhimit minerar të gjeneruara nga secila njësi (referoju kapitullit 6).

Norma e rentës minerare mesatare e zbatuar për mineralet kryesore në vend tregohet në tabelën 15 më poshtë:

Tabela 15 – Renta e zbatuar për mineralet

Mineral	Renta e zbatuar në 2011-2016
Krom	6%
Bakër	6%
Nikel - Silikat	6%
Hekur-nikel	5%
Qymyret dhe bitumet	200 – 19,940 Lek / ton
Gëlqerorë	47 Lek / m^3
Ranorët	491 Lek /m^3
Gips - Alabastër	21 Lek / ton - 423 Lek / m^3

Në nëntor të vitit 2014, Qeveria paraqiti një rentë të reduktuar me 2/3 e normës nominale të aplikuar për mineralet metalike të përpunuara në Shqipëri dhe pritet të reduktohet më tutje në gjysmën e normës nominale.

Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin mblidhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve si përqindje mbi të ardhurat neto të shoqërisë. Deri në dhjetor 2013, në përputhje me Ligjin Nr. 8438, Datë 28 dhjetor 1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, tatimi mbi fitimin në Shqipëri është ngarkuar me 10% të fitimit neto. Nga 1 Janar 2014, norma e zbatueshme e tatimit mbi fitimin është 15%. Kërkesat e këtij ligji janë plotësisht të zbatueshme për sektorin minerar.

TVSH

Tatimi mbi vlerën e shtuar zbatohet në masën 20% mbi shitjet fiskale brenda vendit dhe 0% për eksportet në përputhje me Ligjin Nr. 92/2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar". TVSH e paguar gjatë vitit 2016 përbën vetëm 2.9% të prodhimit minerar, kjo si rrjedhojë e dominimit të shitjeve në eksport.

Pagesat për sigurime shoqërore dhe shëndetësore

Kontributet e detyrueshme për sigurimin e detyrueshëm shoqëror dhe shëndetësor përllogariten dhe paguhen bazuar në Ligjin Nr. 9136, datë 11.9.2003, "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republiken e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Ligjin Nr. 10383, datë 4.2.2011 "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Ligji Nr. 150/2014, "Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë". Këto ligje përcaktojnë kontributet minimale për përfitimin e pensionit shtetëror dhe kujdesit shëndetësor publik dhe janë të zbatueshme në sektorin minerar. Kontributet për sigurimet shoqërore të punonjësve të nën-tokës përfshijnë një pagesë shtesë prej 5% mbi pagën e sigurueshme dhe parashikojnë përfitimin e pensionit shtetëror në moshën 55 vjeç.

Pagesat e paraqitura më sipër paraqesin njëkohësisht kontributin shtesë paguar nga punëdhënësit dhe pagesat e ndaluara nga të ardhurat e punëmarrësve. Ky fluks është relativisht i lartë në krahasim me pagesat e tjera sepse lidhet me numrin e madh të të punësuarve në këtë sektor.

Tatimi mbi të ardhurat personale

Tatimi mbi të ardhurat personale (TAP) përllogaritet dhe paguhet në përputhje me Ligjin Nr. 8438, Datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. Bazuar në këtë ligj të ardhurat nga punësimi deri në 30,000 Lek tatohen me normën 0%, të ardhurat e fituara mbi shumën 30,000 dhe deri në shumën 130,000 Lek tatohen me normën 13%, ndërsa të ardhurat e fituara mbi shumën 130,000 Lek tatohen me 23%.

Tatimi mbi dividentin

Tatimi mbi dividentin përllogaritet dhe paguhet në përputhje me Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar në masën 15% të dividentit të shpërndarë. Ky tatim mbahet në burim nga shoqëria në momentin e deklarimit të dividendit në rastet kur aksionarët e shoqërisë nuk janë të regjistruar si subjekte tatim-paguese në Shqipëri.

5. Sektori i Hidro-Energjisë

Energjia elektrike renditet burimi i dytë energjetik më i rëndësishëm në vend pas naftës dhe nën-produkteve të saj, me rreth 33% të energjisë së prodhuar në vend dhe 24% të energjisë së vlefshme për konsum. Sistemi elektroenergjetik në vend mbështetet tërësisht në prodhimin hidroenergjetik. Ai dominohet nga sektori publik, dhe disa HEC-e të dhëna me koncesion që janë shtuar nga 2016.

5.1 Vështrim i përgjithshëm i sektorit hidro-energjetik

Shqipëria është e pasur me burime hidrike të konsiderueshme që ka një rol të rëndësishëm zhvillimor për vendin. Territori hidrografik në Shqipëri përllogaritet të jetë 44,000 m^2, rreth 57% më shumë se sipërfaqja gjeografike e vendit. Siç tregohet në Figurën 9, në vend numërohen tetë lumenj kryesorë: Drini, Buna, Vjosa, Semani, Mati, Shkumbini, Ishmi dhe Erzeni. Formimi i kaskadave përgjatë rrjedhës paraqet potencial të lartë hidroenergjetik në lumenjtë kryesorë.

Sipas Strategjisë Kombëtare të Energjisë, vendi ynë vlerësohet të ketë një kapacitet prodhues hidro-energjetik prej 16-18 TWh që mund të përftohet nga vënia në punë e HEC-ve me kapacitet 4,500 MW[87].

Tre hidrocentralet më të mëdha në vend: Fierza, Komani dhe Vau i Dejës u ndërtuan në formë e kaskadës mbi lumin Drin nga viti 1971 deri në vitin 1985 me një kapacitet të instaluar prej 1,350 MW. Këto hidrocentrale kanë qënë tri shtyllat kryesore të prodhimit hidro-energjetik në vend me prodhim mesatar vjetor prej 4,300 GWh që mbulonte rreth 90% të prodhimit të energjisë elektrike në vend në 15 vitet e fundit. Në vitin 2016, prodhimi energjisë elektrike në vend ishte 7,134 GWh, ku prodhimi i tre HECve kryesore ishte 5,091 GWh ose 71.4% të prodhimit total elektro-energjetik

Figura 9 – Lumenjtë kryesorë në Shqipëri

Burimi: AKBN – www.akbn.gov.al

Grafiku 31 - Prodhimi i HEC Fierzës, Komanit & V. Dejës krahasuar me prodhimin total 2000-2016



Burimi: Raportet e ERE 2009-2016 – www.ere.gov.al

[87] Strategjia Kombëtare e Energjisë 2013-2020, publikuar në faqen e internetit të MIE: www.infrastruktura.gov.al.

(Grafiku 31).

Grafiku 32 paraqet prodhimin e energjisë elektrike (MWh) dhe kapacitetin prodhues (fuqinë e instaluar në MW) në vitet 2000 – 2016. Prodhimi hidro-energjetik në vend lidhet ngushtë me kushtet hidrologjike. Në 15 vitet e fundit, prodhimi vjetor i energjisë arriti majën e tij në vitin 2010 me 7,674 GWh dhe sasinë më të ulët në vitin 2007 me 2,826 GWh, ku prodhimi

Grafiku 32- Prodhimi hidro-energjetik dhe kapaciteti i instaluar 2000-2016



Burimi: Raportet ERE 2009-2016 – www.ere.gov.al

maksimal ishte 2.7 herë më i lartë se prodhimi minimal përgjatë periudhës.

Deri në vitin 2007, vendi ynë kishte një kapacitet prodhues 1,350 MW, që administrohej tërësisht nga prodhuesi publik i energjisë elektrike, Korporata Elektro-Energjetike Shqiptare (KESH). Me ndërtimin e HEC-ve të reja me koncesion, fuqia e instaluar e HEC-ve në vend u rrit në 1,990 MW në fund të vitit 2016.

Grafiku 33 - Prodhimi dhe përdorimi i energjisë elektrike 2000 – 2016



Burimi: Bilanci i Energjise, 2000 -2016 - INSTAT

Pavarësisht nga potenciali hidro-energjetik, në 15 vitet e fundit, Shqipëria ka qenë kryesisht një importues neto i energjisë elektrike për të kompensuar bilancin e vazhdueshëm negativ të energjisë.

Ky bilanc negativ i energjisë vjen kryesisht si rezultat i nivelit të lartë të humbjeve në rrjet. Bazuar në të dhënat e raportuara nga INSTAT prodhimi vjetor mesatar për periudhën nga viti 2000 deri në vitin 2016 përbën rreth 77%[88] të energjisë vjetore transmetuar në rrjet, duke përfshirë humbjet. Nëse humbjet teknike dhe financiare në rrjet do të eliminohen plotësisht, siç tregohet ne Grafikun 33, bilanci i energjisë do të përmirësohej në

[88] Përllogaritur si mesatare e thjeshtë vjetore e raportit prodhim – përdorim përgjatë viteve 2000 - 2016. Burimi i të dhënave nga "Bilanci energjisë elektrike, 2000 -2016" - www.instat.gov.al.

mënyrë të ndjeshme dhe do të arrinte një prodhim mesatar në masën 123%[89] të totalit të nevojave për energji elektrike në vend.

[89] Llogaritur si një mesatare e thjeshtë vjetore e prodhimit / konsumit të raporteve gjatë viteve 2000 - 2016. Të dhënat nga "Bilanci i energjisë, 2000 -2016" - www.instat.gov.al.

5.2 Organizimi dhe rregullimi i sektorit të energjisë elektrike

Sektori i prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, duke përfshirë energjinë e prodhuar nga burime hidrike, termike dhe burime alternative të rinovueshme, rregullohet nëpërmjet ligjit për sektorin e energjisë. Në Prill 2015, Kuvendi i Shqipërisë aprovoi ligjin e ri Nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" (Ligji për sektorin e energjisë)[90], me qëllim përafrimin e tij me Direktivat e BE-së për sektorin e Energjisë Elektrike. Ky ligj përcakton kërkesat minimale për alokimin e koncesioneve për ndërtimin dhe / apo rikonstruksionin e impianteve të prodhimit të energjisë elektrike dhe licencimin e subjekteve për prodhimin e energjisë elektrike. Procedurat dhe kushtet kryesore për dhënien e koncesioneve hidro-energjetike përmblidhen në seksionin 5.3 në vijim.

Ligji për Sektorin e Energjisë Elektrike ngarkon ERE si përgjegjëse për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të pjesëmarrësve të tregut, dhe për sigurimin e kontrollit rregullator në tregun shqiptar të energjisë.

Modeli Shqiptar i tregut të energjisë elektrike, zbatuar gjatë vitit 2016[91] paraqet rregullat tranzitore drejt liberalizimit final të tregut të energjisë elektrike në përputhje me ligjin e ri të sektorit të energjisë. Në korrik të vitit 2016, me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 519, datë 13 korrik 2016, Shteti Shqiptar miratoi modelin e ri të tregut shqiptar të energjisë elektrike ("Modeli Shqiptar i Tregut" ose "Tregu Shqiptar i Energjisë") si hapi i fundit drejt zhvillimit të një tregu plotësisht konkurrues të energjisë, në përputhje me detyrimet e Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Ky model parashikon krijimin dhe funksionimin e Bursës Shqiptare të Energjisë (BSHE) deri në fund të vitit 2017 dhe liberalizimin e aksesit të pjesëmarrësve në tregun shqiptar të energjisë.

Rregullat e tregut, së bashku me Kodin e Rrjetit, Kodin e Shpërndarjes, Kodin e Matjes dhe Modelin e Tregut si pjesë e akteve rregulluese të tregut të energjisë elektrike publikohen në faqen zyrtare të ERE www.ere.gov.al. Pjesëmarrësit kryesorë të tregut dhe roli i tyre prezantohet në vijim:

Figura 10 – Flukset e energjisë dhe bashkëpunimi midis pjesëmarrësve të tregut



[90] Ky ligj shfuqizoi Ligjin Nr.9072, datë 22.05.2003.
[91] Modeli Shqiptar i tregut të energjisë elektrike u miratua nga VKM nr. 519, i datës 13.07.2016.

Pjesëmarrësit kryesorë të tregut

KESH-i ka qënë dhe vazhdon të jetë shoqëri e administruar dhe zotëruar 100% nga Shteti Shqiptar që prej themelimit të tij.

Për shkak të strukturës aktuale të furnizimit dhe konsumit të energjisë në vend, prodhimi i gjeneruar nga KESH është shtylla kryesore e furnizimit me energji elektrike në vend.

Modeli i ri i tregut të energjisë e çliron KESH nga detyrimi për të furnizuar OSSH-në me çmime të rregulluara. Ky model krijon mundësinë që KESH të shesë energjinë në treg duke menaxhuar rezervën energjetike që të përfitojë nga çmimet e larta në

kohët e pikut.

Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH)

KESH është prodhuesi dhe furnizuesi kryesor i energjisë elektrike në Shqipëri. KESH zotëron dhe operon HEC-et më të mëdha mbi Lumin Drin, HEC-in e Fierzës, HEC-in e Komanit dhe HEC-in e Vaut të Dejës, me një kapacitet total të instaluar prej 1,350 MW, dhe një termocentral (TEC) në Vlorë ndërtuar në vitin 2009, me një kapacitet të instaluar prej 98MW. Tre HEC-et mbi lumin Drin janë në funksion të plotë dhe mbajnë peshën kryesore të prodhimit të energjisë elektrike në vend, ndërsa TEC-i Vlorës është përkohësisht jashtë funksioni për shkak të një defekti në turbinën e impiantit ftohës.

Hidrocentrali i Fierzës ndodhet në afërsi të fshatit Fierzë rreth 20 km nga qyteti i Bajram Currit. HEC-i është ndërtuar në periudhën nga viti 1971 deri në vitin 1978. HEC-i i Komanit, i ndërtuar në periudhën nga viti 1980 deri në vitin 1988, ndodhet në luginën e lumit Drin, rreth 2 km nga fshati Komanit, në mes të HEC-it të Fierzës dhe atij të Vaut të Dejës. HEC-i Vaut të Dejës, i ndërtuar në periudhën nga viti 1967 deri në vitin 1971, është i vendosur në pjesën e poshtme të Luginës së lumit Drin, rreth 18 km nga qyteti i Shkodrës.

KESH Gen kryen investime të vazhdueshme për mirëmbajtjen dhe sigurinë e digave[92] me qëllim rritjen e sigurisë dhe efikasitetin e furnizimit me energji elektrike. Detaje për impiantet e prodhimit të energjisë, prodhimin, importin e enegjisë dhe detaje të projekteve aktuale mund të gjenden në faqen e internetit: www.kesh.al.

KESH-i shet energjinë elektrike të prodhuar tek OSHEE në sasi dhe çmime të rregulluara nga ERE. Për të përmbushur detyrimet për furnizim publik, KESH importon energjinë me çmime tregu dhe njëkohësisht shet tepricat e energjisë mbi prodhimin e parashikuar në tregun vendas ose për eksport.

Operatori i sistemit të transmetimit (OST)[93]

OST është themeluar në vitin 2004 si një njësi e shkëputur nga KESH. OST operon në rrjetin e transmetimit duke përfshirë pronësinë, mirëmbajtjen dhe zgjerimin e tij. Sistemi i transmetimit përfshin linjat e transmetimit dhe linjat e interkoneksionit me tension nga 110-400kV dhe pikat e nënstacionit.

Përkrah operimit të sistemit të transmetimit, OST kryen njëkohësisht rolin e operatorit të tregut dhe administron likuidimet midis pjesëmarrësve të tregut për furnizimet e energjisë elektrike dhe devijimet (disbalancat) në furnizim.

[92] Projekti i sigurisë të Digave financohet nga Banka Botërore dhe organizata të tjera ndërkombëtare: http://projects.worldbank.org/P125856/dam-safety-additional-financing?lang=en.
[93] Burimi i informacionit për rrjetin e shpërndarjes - Raporti "Gjendja e Sektorit të Energjisë në Shqipëri dhe Veprimtaria e ERE – s gjatë Vitit 2015" publikuar nga ERE: www.ere.gov.al.

OST faturon përdoruesit e sistemit për shërbimin e transmetimit, shërbimet ndihmëse, pagesat sipas Marrëveshjes së Interkoneksionit dhe për blerjen e energjisë balancuese sipas Rregullave të Tregut. Tarifat për shërbimin e transmetimit janë të rregulluara nga ERE.

Rrjeti i transmetimit të OST-së përfshin linjat e mëposhtme të ndërlidhjes (interkoneksionit), të cilat sigurojnë infrastrukturën e nevojshme për shkëmbimin ndërkombëtar të energjisë:

- Linja 220 kV Fierze (Shqipëri) – Prizren (Kosovë)
- Linja 220 kV Koplik (Shqipëri) – Podgorice (Mali i Zi),
- Linja 400 kV Zemblak (Shqipëri) – Kardia (Greqi),
- Linja 400 kV Tirane (Shqipëri) – Podgoricë (Mali i Zi),
- Linja 400 kV Tirane (Shqipëri) – Prizren (Kosovë)[94],
- Linja 150 kV Bistricë (Shqipëri) – Myrtos (Greqi).

Në kuadrin e përmirësimeve të kapaciteteve të OST, në maj 2016, OST inauguroi Qendrën Kombëtare Dispeçer dhe Sistemit të Ri të kontrollit SCADA/EMS, si një nga projektet më të rëndësishme të Operatorit të Sistemit të Transmetimit me vlerë rreth 23 milion EUR. Projekti i Sistemit SCADA/EMS, ka qenë kushti kryesor për anëtarësimin e OST në rrjetin europian të operatorëve të sistemit të transmetimit për energjinë elektrike (ENTSO-E)[95].

OST ka qënë dhe vazhdon të jetë shoqëri 100% e zotëruar dhe administruar nga Shteti Shqiptar që prej themelimit të tij.

Modelit i ri i tregut shqiptar të energjisë, e ngarkon OST me përgjegjësinë për administrimin e Bursës Shqiptare të Energjisë.

[94] Burimi: faqja zyrtare e OST - http://www.ost.al/sq/inaugurohet-linja-400-kv-shqiperi-kosove-nje-nga-veprat-me-te-rendesishme/
[95] Burimi: http://www.ost.al/en/it-is-inaugurated-the-modern-dispatch-center-of-the-transmission-system-operator/

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes – OSSH (i njohur aktualisht si OSHEE)[96]

OSHEE është themeluar në vitin 2006 si një njësi e shkëputur nga KESH. OSHEE zotëron, mirëmban, zgjeron dhe operon sistemin e shpërndarjes në të gjithë vendin, përbërë nga nënstacionet 110/20, 15,600 km rrjet i shpërndarjes së linjave 35/20/10/6 kV, si dhe transformatorët 110/35/20/10/6kV dhe luan njëkohësisht rolin e Furnizuesi Universal (FU), për furnizimin e klientëve tariforë sipas tarifave të rregulluara nga ERE.

Për të përmbushur rolin e FU, OSHEE blen energjinë nga KESH dhe prodhues të pavarur të energjisë elektrike me tarifa të miratuara nga ERE dhe nëse energjia për t'u furnizuar tejkalon energjinë e buxhetuar dhe miratuar nga ERE, OSHEE paguan differencën me çmime tregu.

OSHEE siguron lidhjen dhe shpërndarjen e shërbimeve për klientët tariforë, klientët jo-tariforë, prodhuesit dhe furnizuesit të lidhur me shpërndarjen, në baza jodiskriminuese. Tarifat, termat dhe kushtet e shërbimeve të shpërndarjes janë të rregulluara nga ERE.

Pajisjet dhe rrjeti i shpërndarjes janë përdorur për një periudhë që varion nga 12 deri në 40 vite dhe janë relativisht të vjetëruara. Kushtet e dobëta teknike të rrjetit të shpërndarjes në kombinim me humbje financiare për shkak të vjedhjes së energjisë dhe faturave të papaguara i kanë shkaktuar OSHEE-së humbje të konsiderueshme, që arritën mbi 42% në vitet 2011 dhe 2012. Si rrjedhojë e masave të integruara nga OSHEE dhe Qeveria Shqiptare, humbjet u ulën në 28.04% në vitin 2016[97].

FPSH dhe FPP operojnë me licenca të veçanta të lëshuara nga ERE.

Prodhuesit privat të energjisë elektrike dhe koncesionet

Prodhuesit privat të energjisë elektrike ndahen në prodhues me prioritet dhe të pavarur. Prodhuesit e Pavaruar të Energjisë elektrike (PPE) janë prodhuesit e pavarur që lidhen direkt në sistemin e transmetimit. Ata mund të shesin energji tek Furnizuesit Publik me Shumicë me çmim të rregulluar ose tek operatorët e tjerë të tregut me terma të negociura lirisht.

Klientët e energjisë elektrike

Klientët tariforë blejnë energji elektrike nga Furnizuesi Universal - OSHEE me tarifa të rregulluara nga ERE.

Klientët jo-tariforë janë klientë që mund të zgjedhin lirisht furnizuesin e energjisë elektrike, duke përfshirë edhe Furnizuesin e Alternativës së Fundit.

Operatorë të tjerë të tregut

Tregtuesit e energjisë, si pjesëmarrës të licencuar në këtë treg, blejnë dhe shesin energji elektrike me shumicë tek operatorët e tregut, me përjashtim të Furnizuesit Universal dhe Klientëve Tariforë. Tregtuesit mund të blejnë energji nga Divizioni i Gjenerimit KESH Gen (për tepricat), PVE-të dhe PPE-të, për t'ja shitur Furnizuesve të Kualifikuar, Furnizuesit Publik me Shumicë ose OSHEE-së.

Furnizues të Kualifikuar janë furnizuesit vendas ose të huaj të licencuar nga ERE, te cilët mund të blejnë energji nga tregtuesit, nga PVE-të ose nga PPE-të për t'jua shitur Klientëve të Kualifikuar. Furnizuesit e Kualifikuar mund t'u shesin energji edhe Furnizuesit Publik me Shumicë, Tregtuesve ose

Në fund të vitit 2014 OSHEE zotërohet përsëri 100% nga Shteti shqiptar pas një privatizimi të pasuksesshëm tek CEZ AS.

[96] Raporti ERE 2016 -- www.ere.gov.al
[97] Raporti ERE 2016 -- www.ere.gov.al

Furnizuesve të Kualifikuar të tjerë. PVE-të dhe PPE-të duhet te licencohen që të bëhen Furnizues të Kualifikuar, nëse ata vendosin që t'i shesin direkt energji elektrike Klientëve të Kualifikuar.

Shteti si garantues ose huadhënës për KESH, OST dhe OSHEE

Përkrah përfitimeve në formën e taksave dhe tarifave nga sektori i hidroenergjisë, Shteti injekton fonde në këtë sektor nëpërmjet investimit në kapital dhe kreditimit direkt të shoqërive me pronësi shtetërore. Gjithashtu, Shteti paraqitet si garantues i huave bankare të marra nga shoqëritë me pronësi shtetërore, si KESH dhe OST. Në fund të vitit 2016 huatë e dhëna apo garantuar për shoqëritë KESH dhe OST për përmirësimin e infrastrukturës së gjenerimit dhe transmetimit të energjisë elektrike arritën përkatësisht në 101 miliardë Lek (të barabartë me 122,499 milionë Lek minus 21,524 milionë Lek).

Tabela 16 - Të dhëna kryesore financiare të shoqërive shtetërore[98]

Në milion Lek	2015				2016			
	KESH	OST	OSHEE	Total	KESH	OST	OSHEE	Total
Aktive Afatgjata Materiale	93,890	50,942	21,081	**165,913**	94,554	51,834	29,372	**175,760**
Aktive Jomateriale	-	86	373	**459**	-	284	512	**796**
Aktive Financiare të arkëtueshme	16,628	19	2	**16,649**	14,878	18	2	**14,898**
Totali i aktiveve afatgjata	**110,518**	**51,047**	**21,456**	**183,021**	**109,432**	**52,136**	**29,886**	**191,454**
Inventarët	2,432	709	2,464	**5,605**	2,489	654	4,469	**7,612**
Aktive Financiare të arkëtueshme	5,462	241		**5,703**	6,131	495		**6,626**
Llogari të arkëtueshme dhe të tjera	53,563	9,551	7,587	**70,701**	53,599	9,331	20,864	**83,794**
Mjete Monetare dhe ekuivalentë	1,260	607	6,619	**8,486**	805	223	6,740	**7,768**
Totali i aktiveve afatshkurta	**62,717**	**11,108**	**16,670**	**90,495**	**63,024**	**10,703**	**32,073**	**105,800**
Totali i Aktiveve	**173,235**	**62,155**	**38,126**	**273,517**	**172,456**	**62,839**	**61,959**	**297,254**
Huatë afatgjata	31,481	23,199	13,298	**67,978**	30,612	23,585	11,119	**65,316**
Të tregtueshme afatgjata dhe të tjera të pagueshme	1,445	2,411	-	**3,856**	1,318	1,512	-	**2,830**
Totali i detyrimeve afatgjata	**32,926**	**25,610**	**13,298**	**71,834**	**31,930**	**25,097**	**11,119**	**68,146**
Huatë afatshkurta	44,141	4,330	6,205	**54,676**	45,107	5,451	6,625	**57,183**
Të tregtueshme afatshkurta dhe të tjera të pagueshme	19,966	3,641	74,379	**97,986**	18,033	3,166	79,753	**100,952**
Totali i detyrimeve afatshkurta	**64,107**	**7,971**	**80,584**	**152,662**	**63,140**	**8,617**	**86,378**	**158,135**
Totali i detyrimeve	**97,033**	**33,581**	**93,882**	**224,496**	**95,070**	**33,714**	**97,497**	**226,281**
Kapitali	20,170	9,694	30,099	**59,963**	20,170	17,201	30,083	**67,454**
Rezerva	73,894	14,126	2,916	**90,936**	72,729	10,689	4,429	**87,847**
Fitimet e mbartura dhe EAN	(17,862)	4,754	(88,770)	**(101,878)**	(15,513)	1,235	(70,050)	**(84,328)**
Totali i Kapitalit	**76,202**	**28,574**	**(55,755)**	**49,021**	**77,386**	**29,125**	**(35,538)**	**70,973**
Totali i kapitalit dhe detyrimeve	**173,235**	**62,155**	**38,127**	**273,517**	**172,456**	**62,839**	**61,959**	**297,254**

Burimi: Pasqyrat financiare të KESH, OSHEE dhe OST për vitin 2015 dhe 2016.

[98] Përmbledhja e treguesve financiarë kryesorë paraqet të dhëna marrë nga pasqyrat financiare vjetore të KESH, OST dhe OSHEE. Kompanitë ndanë me ne këtë informacion për qëllim të këtij raporti.

Për shkak të situatës së vështirë financiare në sektorin e energjisë elektrike, niveli i huamarrjeve të garantuara nga Shteti parashikohet të rritet edhe më tej. Këto kredi do të përdoren për të financuar investime në përmirësimin e efikasitetit të prodhimit të energjisë, transmetimin dhe shpërndarjen, gjithashtu përmirësime në matjen e konsumit të energjisë nga ana e konsumatorëve tariforë dhe në mbledhjen e faturave për energji të konsumuar.

Në shtator 2014[99], Banka Botërore miratoi financimin prej 150 milionë USD nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (BNRZH) për Projektin e rimëkëmbjes së Sektorit Energjetik në Shqipëri miratuar me VKM 171, datë 25 shkurt 2015 "Për miratimin e planit të rimëkëmbjes financiare të sektorit të energjisë elektrike". Projekti do të mbështesë reformat e sektorit energjetik të Shqipërisë, veçanërisht ato të ndërmarra për përmirësimin e besueshmërisë së furnizimit me energji elektrike dhe qëndrueshmërinë financiare të sektorit, ku përfshihen reformat për diversifikimin e burimeve të prodhimit të energjisë, reduktimin e humbjeve dhe përmirësimin e arkëtimeve.

Në maj 2016[100], Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dha një kredi me garanci sovrane nga Shteti Shqiptar në shumën 218 milion EUR për rifinancimin e huave të KESH dhe asistencë teknike për përmirësimin e qeverisjes dhe operacioneve të shoqërisë në kuadrin e reformave në sektorin e energjisë.

[99] Burimi: http://www.worldbank.org/sq/neës/press-release/2014/09/29/world-bank-approves-us150-million-project-for-albanias
[100] Burimi: http://www.energjia.gov.al/al/njoftime/lajme/berzh-jep-218-milione-euro-hua-ne-shqiperi-per-kesh&page=5

5.3 HEC-et private dhe me koncesion

Ministria përgjegjëse për energjinë është Autoriteti Kontraktues për të gjitha koncesionet e dhëna në sektorin e hidro-energjisë. Koncesionet në sektorin e energjisë elektrike jepen në përputhje me Ligjin nr. 123/2013 "Për koncesionet dhe Partneritetin Publik-Privat"[101], i ndryshuar[102] ("Ligji për Koncesionet dhe PPP") dhe Rregulloren shoqëruese "Për vlerësimin dhe dhënien e koncesioneve dhe partneritetit publik-privat" miratuar me VKM Nr. 575, datë 10 korrik 2013 ("Rregullorja e koncesioneve").

Përkufizimi i partneritetit publik privat

Sipas ligjit për Koncesionet dhe PPP, Partneriteti publik privat nënkupton një formë bashkëpunimi afatgjatë, të rregulluar me kontratë, ndërmjet autoritetit kontraktues (partnerit publik) dhe një ose më shumë operatorëve ekonomikë (partnerit privat), ku partneri privat merr përsipër detyrimin për të ofruar shërbime publike brenda fushës së kompetencave të partnerit publik dhe/ose detyrimin për t'i siguruar partnerit publik parakushtet e nevojshme për ofrimin e shërbimeve publike.

Në parakushtet e nevojshme përfshihet ndërtimi ose rinovimi i infrastrukturës publike dhe/ose operimi dhe mirëmbajtja e saj.

Legjislacioni dhe rregulloret për koncesionet përcaktojnë parimet dhe procedurat për vlerësimin e mundësive të koncesionit në sektorin e hidroenergjisë dhe dhënies së këtyre koncesioneve. Sipas legjislacionit dhe rregullores, të gjitha koncesionet e hidroenergjisë dhe Marrëveshjet e PPP-ve miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Koncesionet hidro-energjetike janë të organizuara në përputhje me modelin Ndërtim-Administrim-Transferim (NAT) ose Rindërtim-Administrim-Transferim (RAT). Sipas modelit, operatori financon ndërtimin / rindërtimin e hidrocentralit dhe merr përsipër të gjitha rreziqet dhe përfitimet që rrjedhin nga financimi dhe administrimi i HEC-it. Shitja e energjisë së prodhuar nga Operatori garantohet përmes Marrëveshjeve së Blerjes së Energjisë Elektrike të nënshkruar midis Operatorit dhe Furnizuesit Publik me Shumicë të Energjisë me tarifa të rregulluara nga ERE, bazuar në modelin *"feed in"*. Sipas legjislacionit në fuqi, të gjitha koncesionet në Shqipëri jepen për një periudhë jo më të gjatë se 35 vjet.

Figura 11 – Procesi i dhënies dhe monitorimit të koncesioneve



Alokimi i HEC-ve me koncesion

Identifikimi i mundësive për koncesion

Ministria e Energjisë dhe Industrisë mund të identifikojë fushat për t'u dhënë me koncesion nëpërmjet shqyrtimit të propozimeve të marra

[101] Ky ligj është përafruar me direktivën e BE-së 2004/18/EC
[102] Ndryshuar me ligjin Nr. 88/2014, dhe me ligjin Nr. 77/2015

(ndryshe propozimet e pakërkuara) nga investitorët privatë apo institucione të tjera qeveritare dhe jo-qeveritare.

Para se të njoftojë për mundësinë për koncesion, MIE sigurohet për fizibilitetin teknik dhe ndikimin ekonomik, mjedisor dhe shoqëror të çdo mundësie për koncesion, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Në rastin e propozimeve të pakërkuara, paraqitur me iniciativë nga investitorët privatë, këta të fundit kryejnë një studim fizibiliteti, i cili paraqitet në Projekt-Propozimin në përputhje me kërkesat minimale të ligjeve në fuqi. Propozimi i dhënë për projektin i nënshtrohet një procesi të vlerësimit teknik në përputhje me VKM Nr. 191, datë 22 mars 2007 "Për vendosjen e oponencës teknike shtetërore për projektet e ndërtimit të HEC-ve me koncesion". Ky vlerësim kryhet nga grupi i ekspertëve të hidro-energjisë, gjeologjisë dhe mjedisit, të caktuar nga Ministri përgjegjës për ekonominë dhe miratuar nga AKBN në përputhje me Ligjin Nr. 8093, datë 1 mars 1996, "Për rezervat ujore" dhe Ligjit Nr. 8402, datë 10 shtator 1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"[103].

Procedurat e prokurimit

Nëse projekt-propozimet e marra kthehen në mundësi koncesioni, Ministria fton të gjithë aplikantët e interesuar në një procedurë tenderimi të publikuar me anë të një njoftimi të kontratës, në përputhje me Ligjin për Koncesionet dhe PPP. Me vendimin nr. 130, datë 12 mars 2014, Këshilli i Ministrave vendosi që procedura e koncesioneve, përfshirë pranimin e projekteve dhe komunikimin me operatorët do të bëhet nëpërmjet faqes zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik: www.app.gov.al.

Koncesionet jepen në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.9643, datë 20 nëntor 2006, i ndryshuar "Për prokurimet publike".

Sipas ligjit dhe rregullores së koncesionit çdo aplikant merr një trajtim të drejtë dhe jopreferencial, megjithatë neni 7 i ligjit të lejon që komisioni i prokurimit të caktojë një bonus deri në 10% të pikëve për propozuesin e projektit. Në rast se, koncesioni i caktohet një investitori të ndryshëm nga propozuesi fillestar, rregullorja e re e koncesionit parashikon kompensimin e propozuesit të projektit nga 0.5% deri në 2% të vlerës së koncesionit bazuar në shtrirjen e studimit të fizibilitetit të përfshirë në projekt-propozimin fillestar.

Çmimi i kontratës vlerësohet kundrejt:

- Avantazheve më të mëdha teknike dhe ekonomike siç vlerësohen nga Autoriteti Kontraktues, ose
- Tarifës më të lartë të koncesionit të ofruar për specifikimet teknike të kërkuara në njoftimin e kontratës.

Operatori duhet të garantojë përmbushjen e detyrave të tij deri në 10% të vlerës së investimit, garanci e ekzekutueshme në rastet e zgjidhjes së kontratës apo shkeljes të kushteve kontraktuale.

Miratimi i koncesioneve

Të gjitha kontratat e koncesionit janë firmosur nga Ministri i Energjisë dhe Industrisë në kapacitetin e autoritetit kontraktues nga Këshilli i Ministrave. Pas nënshkrimit të kontratës, operatori harton planin e detajuar të zbatimit. Përpara miratimit, ky plan i nënshtrohet përsëri oponencës teknike shtetërore. Ndërtimi i hidrocentraleve energjetike është subjekt i 10 deri në 20 lejeve nga organe të ndryshme rregullatore, duke përfshirë: lejen

[103] VKM Nr. 191 datë 22 mars 2007 "Për vendosjen e oponencës teknike shtetërore për projektet e ndërtimit të hidrocentraleve me koncesion"

mjedisore (vjetore), lejet për ndërtimin (para ndërtimit), leje për përdorimin e burimeve ujore (vjetore), licencë për prodhimin e energjisë (para fillimit të prodhimit), lejen për lidhjen me rrjetin e transmetimit etj.

Termat teknik dhe jo-teknik të marrëveshjeve koncesionare dhe partneritetit publik privat janë konfidenciale dhe nuk mund të zbulohen për palët e treta pa pëlqimin e të gjitha palëve të përfshira në marrëveshjen e koncesionit. Kushtet dhe termat kryesore të marrëveshjeve të koncesionit dhe PPP-ve për ndërtimin e hidrocentraleve paraqiten si më poshtë:

1. Objekti i marrëveshjes

   Objekti i marrëveshjes së koncesionit është financimi, projektimi, ndërtimi, vënia në punë, administrimi, mirëmbajtja e hidrocentralit dhe dorëzimi i tij tek Autoritetet Kontraktues (Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë) në përfundim të afatit të kontratës.

2. Kohëzgjatja e Koncesionit

   Koncensioni jepet për një periudhë deri në 35 vjet. Periudha e koncesionit mund të zgjatet vetëm në rastin e një Ngjarje të Forcës Madhore ose me miratim nga Këshilli i Ministrave.

3. Forma e Shoqërisë Koncesionare

   Pas hyrjes në fuqi të kontratës së koncesionit, Koncesionari duhet të themelojë Shoqërinë koncesionare, të cilës do ti kalojnë të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Koncesionarit sipas kontratës së koncesionit. Forma e shoqërisë duhet të jetë "shoqëri me përgjegjësi të kufizuar" ose "shoqëri aksionare", me objekt të vetëm të veprimarisë tregtare aktivitetin që ushtrohet në kuadër të kontratës së koncesionit. Kjo shoqëri do të ketë një kohëzgjatje në përputhje me afatin e kontratës së koncesionit.

4. Karakteristikat e hidrocentralit

   Në kontratë përcatohen qartë emri, vendndodhja, numri dhe karakteristikat teknike të HEC-ve dhe prodhimi vjetor i parashikuar i energjisë elektrike. Gjithashtu, përcaktohet fuqia e instaluar e hidrocentralit, të cilën Koncesionari duhet të zbatojë në projektin e ndërtimit.

5. Vlera e Investimit

   Vlera që koncesionari do të investojë në total shprehet në vlerë monetare në kontratë. Nga kjo vlerë në formë përqindjeje përcaktohet masa e investimit që duhet të shkojë për makineri dhe pajisje. Meqënëse kjo vlerë bazohet në vlerësime, në varësi të ndryshimeve që mund të ndodhin ajo mund të ndryshojë, por vlera e investimit nuk mund të jetë më e vogël se 95% e vlerës së parashikuar.

6. Tarifa koncesionare dhe vlera e riinvestimit

   Tarifa koncesionare shprehet në përqindje (%) të prodhimit vjetor të energjisë elektrike. Tarifa e koncesionit është fikse dhe nuk ndryshon deri në përfundim të kontratës së koncesionit. Koncesionari gjithashtu ka detyrimin te riinvestojë një pjesë të investimit fillestar (e dhënë në përqindje) për makineri dhe pajisje, pas 15 ose 25 vjet nga hyrja në fuqi e kontratës.

7. Sigurimi i kontratës

   Koncesionari duhet të depozitojë në një institucion bankar ose shoqëri sigurimesh, për llogari të Autoritetit Kontraktues një shumë që varion

nga 5-10% të vlerës totale të investimit, sipas negociatave të kontratës. Sigurimi i Kontratës do të shërbejë për të garantuar zbatimin në mënyrën e duhur dhe brenda afatit të parashikuar, mirëmbajtjen dhe plotësimin e termave të tjera të kontratës për periudhën e koncesionit.

8. Garantimi i përfitimeve të koncesionit

   Në përputhje me rregullat e tregut, Operatori mund të lidh një marrëveshje për shitjen e energjisë me Furnizuesin Publik me Shumicë dhe do të shesë energjinë e prodhuar me tarifat në fuqi, të përcaktuara nga ERE.

9. Të tjera lidhur me rrezikun e projektit

   Në rastin e veprave komplekse dhe me rrezik, kontrata parashikon kushtet për ndarjen dhe shtrirjen e rrezikut lidhur me koston e punimeve dhe karakteristika të tjera mes partnerit publik dhe privat.

Regjistri i koncesioneve dhe publikimi i kontratave

Deri në 2013, regjistri i koncesioneve mbahej nga Autoriteti Kontraktues në përputhje me ligjin e vjetër të koncesioneve. Ligji i ri përcakton njësinë ATRAKO, pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si autoritetin përgjegjës për mbajtjen e Regjistrit të Koncesioneve.

ATRAKO publikoi në faqen e saj të internetit listën e koncesionarëve dhe kushtet e plota të marrëveshjes së koncesionit: http://www.atrako.gov.al/?page_id=112

Një kopje e regjistrit të koncesioneve të hidrocentraleve është botuar nga ALBEITI në faqen e saj: www.albeiti.org.

Monitorimi i Koncesioneve

MIE në bashkëpunim me AKBN janë përgjegjës për monitorimin e zbatimit të kontratave të koncesionit dhe partneritetit publik-privat. AKBN raporton çdo tremujor tek Autoriteti Kontraktues, situatën e koncesioneve në fazën e ndërtimit dhe shkeljet përkatëse. Aktualisht, AKBN është në proces vlerësimi të investimit faktik dhe fuqisë së instaluar për koncesionet që kanë përfunduar fazën e ndërtimit dhe janë në proces prodhimi.

Licencimi i fuqisë prodhuese

Kur përfundon ndërtimi i HEC-it, Koncesionarët i nënshtrohen një kontrolli përfundimtar teknik, përpara se të aplikojnë për licencimin e fuqisë prodhuese. ERE jep licensa të fuqisë prodhuese bazuar në rregulloret në fuqi. Rregullat dhe praktikat e licencimit për prodhimin, tregtimin dhe furnizimin me energji si dhe regjistri i lejeve për çdo lloj licence publikohet dhe përditësohet vazhdimisht në faqen zyrtare të internetit të ERE: www.ere.gov.al.

Raportet e publikuara për sektorin e energjise elektrike

ERE publikon në tremujorin e parë të vitit pasardhës një raport gjithëpërfshirës për gjendjen e sektorit të energjisë elektrike gjatë vitit në raportim. Ky raport përfshin të dhëna për a) prodhimin, transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike; b) rregullimin dhe monitorimin e operatorëve të tregut të energjisë elektrike; c) veprimtarinë e licencimit dhe trajtimin e konflikteve; d) zhvillimet në legjislacion; e) marrëdhëniet ndërinstitucionale dhe ndërkombëtare në fushën e energjisë, etj.

5.4 Koncesionet dhe investimet private deri në vitin 2016

Bazuar në të dhënat e raportuara nga AKBN[104], Shteti shqiptar ka firmosur rreth 183 marrëveshje koncesioni për ndërtimin e 545 HEC-eve në të gjithë vendin gjatë periudhës nga viti 2002 në 2016. Sic tregohet në grafikun 34, Vitet 2009 dhe 2013 janë cilësuar si vitet me aktivitetin më të lartë koncesionar.

Grafiku 34 - Numri i HEC-eve dhënë me koncesion (2002-2016)



Burimi: Regjistri i Koncesioneve raportuar nga AKBN/Raporti ERE – www.ere.gov.al

Nga 545 HEC-e me koncesion, 74 HEC-e me kapacitet të instaluar prej 270 MW prodhuan energji (876 GWh) gjatë vitit 2016.

HEC-et kryesore private dhe me koncesion[105]

AKBN raporton se gjatë viteve 2008 – 2011, Qeveria Shqiptare nënshkroi marrëveshje koncesionare për ndërtimin e gjashtë hidrocentraleve të mëdha, si vijon:

HEC-et "Ashta 1 dhe Ashta 2" në lumin Drin[106]

Në vitin 2008, Qeveria Shqiptare dha një koncesion 35 vjeçar për ndërtimin, operimin dhe transferimin (BOT) të dy hidrocentraleve mbi lumin Drin, Ashta 1 dhe Ashta 2, të cilët do të shfrytëzonin ujin e mbetur nga HEC-i i Vaut të Dejës. HEC-et përfunduan ndërtimin dhe filluan prodhimin në vitin 2013. Ky projekt solli një teknologji të re në rritjen e efikasitetit të përdorimit të ujit, duke përdorur disa turbina të vogla në vend të një turbine të madhe. Investimi i partnerëve të projektit EVN AG dhe Verbund AG raportohet në vlerën 200 milionë euro. Të dy HEC-et kanë një kapacitet total prej 53MW dhe pritet të gjenerojnë një prodhim vjetor prej 240 GWh.

Ashta ka firmosur nje marrëveshje për shitjen e energjisë me KESH, sipas së cilës Ashta do të shesë energjinë me çmime të rregulluara nga ERE. Në rast se shoqëria nuk do të transmetojë energjinë ditore të buxhetuar (prodhimi deklaruar), ajo do të kompensojë KESH-in për disbalancat me çmime tregu dhe në rast të kundërt do të kompensohet për rastet e mbiprodhimit.

Detajet e projektit dhe investimet janë paraqitur në faqen e internetit të Ashtës: http://www.energji-ashta.al/.

[104] AKBN e raportoi këtë informacion për përpilimin e këtij raporti.
[105] Burimi: "Hydro-energetic Potential" publikuar nga AKBN- www.akbn.gov.al
[106] Informacioni i prezantuar më sipër është marrë nga faqja zyrtare e internetit të Shoqërisë - http://www.energji-ashta.al.

HEC-et në lumin Devoll[107]

Në vitin 2009, Qeveria e Shqipërisë dha me koncesion të drejtat për ndërtimin, zotërimin, operimin dhe transferimin (BOOT) e tre hidrocentraleve mbi lumin Devoll shoqërisë Devoll Hidropower Sh.a. (DHP), e cila është në pronësi të Statkraft Markets B.V. për 75 vjet.

Aktualisht projekti konsiston në ndërtimin e dy hidrocentraleve, Banja dhe Monglicë në luginën e Devollit, me një kapacitet të instaluar prej 256 MW. Hidrocentralet pritet të gjenerojnë një prodhim vjetor prej 729 GWh, i cili përfaqëson një rritje prej 15% krahasuar me prodhimin e brendshëm në vitin 2014. HEC Banja u inagurua dhe filloj prodhimin në vitin 2016, ndërsa HEC Moglica pritet të përfundojë në vitin 2018. Pas përfundimit me sukses të dy hidrocentraleve, DHP do të konsiderojë investimin në një HEC të tretë në lumin Devoll.

Devolli do të shesë energjinë me çmime të negociuara lirisht në treg. Detajet e projektit dhe investimet janë paraqitur në faqen e internetit të DHP: http://www.devollhydropower.al/.

HEC-i "Kalivaç" në lumin Vjosa

Në maj 2017, pas ndërprerjes së një koncesioni të pasuksesshëm të dhënë për Becchetti Energy Group (BEG SPA), Qeveria e Shqipërisë dha një koncesion të ri BOT për Hidrocentralin Kalivaç.

Oferta fituese iu dha sipërmarrjes së bashkuar midis Ayen Energy A.S. dhe Fusha Sh.p.k. duke u kualifikuar me pikët më të larta (95). Koncesionari do të ndërtojë një HEC me fuqi të instaluar prej 111 MW që pritet të prodhojë 366 GWh në vit. Tarifa e koncesionit është vendosur në 2.1%.

HEC Ulëz, Shkopet, Bistrica 1 and Bistrica 2

HEC Ulëz, Shkopet, Bistrica 1 and Bistrica 2 nën administrimin e KESH deri në tremujorin e dytë të vitit 2013 u privatizuan nga shoqëria Kurum International Sh.A. gjatë vitit 2013 për vlerën 130 milionë USD. Këto HEC-e kanë fuqi të instaluar 78 MW.

[107] Informacioni i prezantuar më sipër është marrë nga faqja zyrtare e internetit të Shoqërisë - http://www.devollihydropower.al.

5.5 Vlera e krijuar në sektorin e energjisë elektrike

Të ardhurat e gjeneruara nëpërmjet shitjes së energjisë kapën vlerën 27,245 milionë lekë[108] (ekuivalente me 219.5 milionë USD) në vitin 2016. Nevojat e energjisë elektrike në vend plotësohen nëpërmjet prodhimit vendas dhe importit. Tabela 17 paraqet një përllogaritje të vlerës së krijuar nga aktiviteti prodhimit, furnizimit, transmetimit dhe shpërndarjes.

Tabela 17 –Vlera e krijuar nga prodhimi, furnizimi, transmetimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike

Në million Lek	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Shitjet e energjisë prodhuar nga HEC-et private dhe me koncesion (i)	1,118	1,008	2,590	6,629	8,139	8,026	10,822
Prodhuesi publik i energjisë (KESH) (ii)	20,614	23,620	(2,683)	7,221	13,503	23,989	30,070
Transmetim dhe alokim kapacitetesh (OST) (iii)	3,895	4,415	5,767	5,534	6,417	6,394	5,714
Shpërndarja dhe furnizuesi universal (OSHEE) (iv)	24,588	(7,366)	12,990	16,237	976	8,766	8,144
Vlera në millionë Lek	**50,216**	**21,677**	**18,665**	**35,622**	**29,036**	**47,174**	**54,750**
Vlera në % ndaj PBB-se[109]	**4.1%**	**1.7%**	**1.4%**	**2.6%**	**2.1%**	**3.3%**	**3.7%**
(a) Prodhimi neto vendas *(GWh)*[110]	7,674	4,036	4,725	6,959	4,726	5,866	7,136
(b) Përdorimi nga konsumatorët *(GWh)*	(4,606)	(5,032)	(4,369)	(4,551)	(5,011)	(5,069)	(5,108)
(c) Humbjet në rrjet *(GWh)*	(2,167)	(2,179)	(3,250)	(3,306)	(2,783)	(2,196)	(1,986)
(d) Import / eksport *(GWh)*	(901)	3,174	2,895	898	3,067	1,399	42
Humbjet në rrjet në % ndaj energjisë në dispozion (a+d)	**32.0%**	**30.2%**	**42.7%**	**42.1%**	**35.7%**	**30.2%**	**28.04%**

i. Informacioni bazohet mbi te ardhurat e publikuara në raportin e ERE. (Burimi: Raportet vjetore të ERE 2010-2016).
ii. Vlera rrjedh nga gjenerimi i shitjes së energjisë minus koston e shkaktuar për blerjen e energjisë. (Burimi: Pasqyrat Financiare KESH).
iii. Vlera rrjedh nga të ardhurat nga transmetimi i energjisë dhe alokimi kapaciteteve të transmetimit. (Burimi: Pasqyrat Financiare OST).
iv. Vlera rrjedh nga të ardhuarat nga shitjet e energjisë minus shpenzimet për blerjet e energjisë. (Burimi: Pasqyrat Financiare OSHEE).

Grafiku 35 - Vlera në % ndaj PBB dhe humbjet në %



Burimi: Struktura e GDP dhe Bilanci i Energjisë, INSTAT

Kontributi i sektorit të energjisë elektrike (vlera e krijuar), duke perfshirë prodhimin, transmetimin dhe shpërndarjen përllogaritet të jetë rreth 54.75 miliardë Lek (ekuivalente me 441 milionë USD) ose 3.7% e PBB-së në vitin 2016. Grafiku 35 tregon që gjatë 7 viteve të fundit, kontributi është luhatur mjaft duke shënuar vlerën më të ulët 1.4% në vitin 2012 kur humbjet në rrjet arritën 42.7%.

Luhatjet në të ardhurat neto të gjeneruara nga KESH dhe OSHEE janë për shkak të detyrimit publik për të siguruar shërbimin e energjisë për të gjithë tarifat e konsumatorëve me çmimet e rregullara dhe të sigurojë energji ekstra me çmimet e tregut për të superuar humbjet në rrjet. Të dy operatorët e shesin energjinë me një çmim të rregulluar më të ulët se kostot e prokurimit nëpërmjet importit.

[108] Vlera e fituar nga shtimi i të ardhurave të gjeneruara nga KESH (16,423 milionë lekë) të paraqitura në pasqyrat financiare vjetore të audituara dhe të ardhurat e gjeneruara nga HEC-et private dhe koncesionare të paraqitura në raportin vjetor të ERE-s për vitin 2016.
[109] Burimi: "Prodhimi i brendshëm bruto sipas aktivitetit ekonomik" INSTAT – www.instat.gov.al
[110] Burimi: "Bilanci i Energjisë Elektrike, 2000-2015" INSTAT – www.instat.gov.al

5.6 Të ardhurat në Buxhetin e Shtetit

Shteti shqiptar merr pjesën e tij nga vlera e krijuar nga sektori hidroenergjetik nëpërmjet:

- Tatimit të veprimtarisë
- Taksave / tarifave, dhe
- Dividendëve apo fitimit nga shitja e investimeve direkte në sektorin e hidro-energjisë

Figura 12 – Shpërndarja e të ardhurave nga sektori i hidro-energjisë



Të ardhurat kryesore nga sektori hidro-energjisë analizuar më poshtë:

Tabela 18 - Të ardhurat kryesore nga sektori hidro-energjisë

	Të ardhura fiskale në MLek	Të ardhura fiskale në M$	Struktura në %	Buxheti i Shtetit	KESH	ERE
Tatimi mbi fitimin	1,181.5	9.5	24.50%	9.5	-	-
TVSH	1,519.6	12.2	42.90%	12.2	-	-
Pagesat për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	515.4	4.2	14.20%	4.2	-	-
Tatimi mbi të ardhurat nga punësimi	372.6	3.0	9.20%	3.0	-	-
Tatimi mbi dividendin	16.1	0.1	0.40%	0.1	-	-
Penalitete tatimore	4.0	0.0	0.20%	0.0	-	-
Tarifa kocesionare	688.6	5.5	5.70%	-	5.5	-
Pagesat per licencat dhe tarifa e rregullimit	116.8	0.9	3.00%	-	-	0.9
Total	**4,415**	**36**	**100.00%**	**22.9**	**1.4**	**0.8**

Këto të hyra përbënin rreth 0.9% të të ardhurave totale të regjistruara në buxhetin e shtetit në vitin 2016.

Tarifa koncesionare

Tarifa koncesionare i paguhet Autoritetit Kontraktues në përqindje mbi vlerën e prodhimit vjetor të energjisë elektrike dhe çdo përfitimi tjetër që rrjedh nga marrëveshja. Kjo përqindje është pjesë konfidenciale e marrëveshjes dhe ndryshon në koncesione të ndryshme. Tarifa përllogaritet në përqindje mbi çdo faturë mujore të energjisë së shitur tek KESH dhe mblidhet nga KESH për llogari të Autoritetit Kontraktues, në përputhje me

Urdhërin Nr. 4 datë 9 janar 2012 të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, përgjegjëse për sektorin e energjisë në atë kohë.

Të ardhura të tjera sipas marrëveshjeve të HEC

Krahas tarifës së koncesionit, HEC-et me koncesion mund të jenë subjekt gjobash të konsiderueshme për mospërputhje me marrëveshjen e koncesionin apo të PPP-së.

Marrëveshja e koncesionit parashikon penalitete për:

- Mosparaqitjen në kohë të projektit të zbatimit për miratim;
- Moszbatimin e kushteve dhe afateve të kontratës;
- Moskryerjen e investimeve deri në të paktën 95% të vlerës së rënë dakort;
- Mosrealizimin e instalimit të kapacitetit të rënë dakort;
- Mosrealizimin e prodhimit të energjisë elektrike vjetore të parashikuar në marrëveshje etj.

Autoriteti kontraktues përfiton garancinë e kontratës deri në 10% të vlerës së investimit, në rast se zgjidh kontratën, si pasojë e moszbatimit të kushteve kontraktuale nga partneri privat.

Deri në datën e këtij raporti, MIE nuk ka raportuar të ardhura nga penalitet gjatë vitit 2016.

Të ardhurat nga investimet dhe privatizimet e shoqërive me pronësi shtetërore

Sektori i energjisë elektrike dominohet nga shoqëri shtetërore. Shteti si pronar përfiton dividentët e shpërndarë nga fitimi i Shoqërive si dhe të ardhura nga shitja pjesore ose tërësore e aksioneve. MIE dhe MZHETTS nuk kanë raportuar të ardhura materiale nga privatizimi dhe shitja e aseteve në sektorin e energjisë dhe burimeve natyrore gjatë vitit 2016.

Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin mblidhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve si përqindje mbi të ardhurat neto të shoqërisë, e cila është 15%. Kërkesat e këtij ligji janë plotësisht të zbatueshme për sektorin e hidroenergjisë.

TVSH

Tatimi mbi vlerën e shtuar zbatohet në masën 20% mbi shitjet fiskale brenda vendit dhe 0% për eksportet në përputhje me Ligjin Nr. 92/2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar". TVSH e paguar përbën fluksin kryesor të të ardhurave fiskale nga sektori energjisë elektrike, kjo sepse shumica e energjisë së prodhuar dhe / apo tregtuar konsumohet brenda vendit.

Tarifat për licencimin dhe rregullimin e sektorit të energjisë elektrike

Të gjitha tarifat për licencimin për prodhimin, tregtimin, furnizimin dhe shpërndarjen e energjisë janë paguar në kohën kur është dhënë licensa, modifikuar ose transferuar sic është vendosur nga ERE. ERE mbledh çdo vit nga të licencuarit tarifa rregullatore vjetore, të cilat përllogariten mbi bazën e të ardhurave nga shitja realizuar nga aktiviteti i licencuar. Këto të ardhura shërbejnë për të mbuluar kostot operacionale të institucionit, dhe si të tilla mbeten në buxhetin e ERE-së.

6. Alokimi i të ardhurave

Transfertat lokale të rentës minerare përbëjnë të ardhurat kryesore të alokuara. Renta minerare e arkëtuar nga shitja e naftës, gazit dhe mineraleve është regjistruar në Buxhetin e Shtetit. Sipas Ligjit për Taksat Kombëtare nr. 9975, 28 Korrik 2008, i ndryshuar, një pjesë e taksës së rentës minerare do të transferohet tek secila njësi e qeverisjes vendore ("NjQV "), në përpjesëtim me kontributin e tyre në prodhimin dhe shitjen e mineraleve.

Udhëzimi Nr.26, datë 4.9.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar përcakton procedurat rakorduese për alokimin e rentës minerare. Prandaj, secila NjQV, në fund të muajit, është përgjegjëse për:

- të mbajtur një listë të azhornuar të shoqërive nxjerrëse të naftës dhe minerare që operojnë nën administrimin e tyre;
- Të mbledhur informacione mbi pagesat e rentës minerare nga shoqëritë nxjerrëse tek autoritetet e tatimeve dhe doganave në fund të muajit;
- Të mbledhur infomacione nga drejtoria rajonale e taksave dhe doganave përsa i përket rentës së mbledhur gjate muajit, dhe
- Të rakorduar shumat e raportuara nga shoqëritë nxjerrëse me ato të raportuara nga drejtoria rajonale e tatimeve dhe doganave.

Më pas, drejtoritë rajonale të tatimeve dhe doganave paraqesin brenda 5 ditëve nga fundi i muajve listën analitike të pagesave të rentës së mbledhur dhe rakordohen me secilën NjQV përfituese në Drejtorinë e Buxhetit në Ministrinë e Financave, e cila inicion transferimin mujor të rentës tek NjQV.

Për shoqëritë e naftës, veprimtaria e të cilave shtrihet në disa NjQV njëkohësisht, udhëzimi nr.26 përcakton përqindjen e rentës që do t'i shkojë çdo NjQV-je në varësi të vendburimit ku është prodhuar nafta apo gazi i shitur.

Tabela në vijim paraqet të dhëna për rentën minerare të mbledhur dhe shpërndarë gjatë vitit 2016.

Tabela 19 – Renta e mbledhur dhe shpërndarë gjatë vitit 2016

Shumat në milionë Lek

Renta Minerare Totale	3,542
Renta Minerare për t'u transferuar @ 5%	177
Renta Minerare e transferuar (*)	153
Diferenca	(24)

(*)Kjo shumë përfshin rentën minerare të transferuar deri më tani nga renta minerare e mbledhur për vitin 2016, duke përfshirë transfertat lokale të bëra në 2016 dhe 2017.

Pagesat totale të rentës minerare në vitin 2016 arrijnë në 148 milionë lekë, ku 2.8 milionë lekë janë paguar në janar 2016, nga renta e mbledhur në dhjetor 2015. Në janar të vitit 2017, MEF-i bëri transferimet drejt NJQV-ve të rentës në shumën 8.4 milionë lekësh, të mbledhura në dhjetor 2016.

Renta minerare është e taksa kryesore që Shteti mbledh nga sektori nxjerrës.

Duke filluar nga viti 2015, Buxheti i Shtetit transferon 5% të rentës minerare tek NjQV-të prodhuese.

Të dhënat e raportuara nga Ministria e Financave dhe Drejtoritë përgjegjëse për tatimet dhe doganat, tregojnë se renta e shpërndarë përfaqëson rreth 4.3% të rentës së mbledhur gjatë vitit 2016 (2015: 3.5%). Shuma prej 24 milionë Lek ende nuk është ndarë për NjQV-të gjeneruese në datën e këtij raporti.

Ministria e Financave shpjegon se NjQV-të janë përgjegjëse për të filluar procesin nëpërmjet procedurave të rakordimit dhe shuma që nuk është transferuar ende nuk është kërkuar nga NjQV-të.

Këto nën-deklarime, mund të shpjegohen deri diku nga vlera e shtuar nga rishitësit që e blejnë mineralin nga të licencuarit dhe e rishesin atë në eksport ose për përdorim të tregut vendas. Rishitësit mund të mos jenë pjesë e listës së shoqërive që mbahet nga NjQV, dhe si rezultat, nuk janë pjesë e procedurave mujore të rakordimit.

Bazuar në analizën rast-pas-rasti të pagesave të rentave nga shoqëritë, u vu re se 196 subjekte private jo të licencuara në sektorin e naftës, gazit apo sektorin minerar, paguan rentë minerare prej 140 milionë Lek në 2016.

Grafiku 36 tregon trendin e shpërndarjes së rentës minerare për shitjet lokale nga viti 2011 deri në 2016.

Deri në vitin 2014, vetëm NjQV-të naftë-prodhuese përfitonin transfertat kombëtare të rentës minerare, por nuk mund të bëhej një korrelacion i mirëfilltë midis rentës së arkëtuar dhe transfertave kombëtare. Që nga viti 2015, procedurat e transfertave të rentës minerare jep referenca të qarta për alokimin dhe kjo solli një nivel të rritur të transfertave kombëtare të rentës. Këto transferime do të jenë edhe më të larta kur renta minerare për 2016 të jetë plotësisht e ndarë sipas NjQV-ve prodhuese.

Grafiku 36 - Transfertat Kombëtare të Rentës Minerare 2011-2016



Burimi: Raportet EITI 2011-2016

Rakordimi i Transfertës Kombëtare të Rentës Minerare

Në vitin 2016, MSG përzgjodhi gjashtë NjQV që përfaqësojnë rrethet kryesore nxjerrëse në Shqipëri. Këtu përfshihen bashkia e Fierit, Patosit, Roskovecit, Kukësit dhe Krujës, si në tabelën më poshtë:

Tabela 20 – Rakordimi i Transfertës Kombëtare të Rentës Minerare

Bashkia	Renta e kërkuar nga NjQV	Renta e transferuar sipas MFE	Diferenca
Bulqizë	28,759,884	24,504,592	4,255,293
Krujë	*Nuk ka raportuar*	2,672,631	
Patos	42,579,479	43,525,958	(946,479)
Prrenjas	465,143	202,369	262,774
Roskovec	29,383,861	38,556,377	(9,172,516)
Kukës	*Nuk ka raportuar*	262,079	
Fier	*Nuk ka raportuar*	24,907,622	
Totali i rentës së transferuar tek NjQV		**134,631,628**	

Tabela 21 liston të gjitha transfertat kombëtare të rentës të bërë në 2016, duke informuar nëse transfertat lidhen me rentën e mbledhur në 2015, 2016 dhe 2017.

Tabela 21 – Lista e Transfertave Kombëtare të Rentës gjatë 2016

Nr.	Njësitë e qeverisjes vendore	Totali i Rentës së transferuar në 2016	Renta e transferuar në 2016 për vitin 2015	Renta e transferuar në 2017 për vitin 2016	Totali i Rentës së transferuar e bërë nga renta e grumbulluar në 2016	Në % të totalit të rentës së transferuar në vitin 2016
1	Berat	31,120	-	570	31,690	0.02%
2	Bulqizë	24,504,592	1,509,265	243,062	23,238,389	15.14%
3	Cërrik	43,312	12,923	23,400	53,789	0.04%
4	Devoll	37,115	-	-	37,115	0.02%
5	Dibër	38,183	4,976	-	33,207	0.02%
6	Durrës	73,332	-	2,848	76,180	0.05%
7	Elbasan	623,817	62,819	-	560,998	0.37%
8	Fier	24,907,622	839,586	1,439,213	25,507,249	16.62%
9	Gramsh	26,960	1,884	-	25,076	0.02%
10	Has	91,297	-	92,340	183,637	0.12%
11	Himarë	47,211	7,163	8,845	48,893	0.03%
12	Kamëz	6,801	-	-	6,801	0.00%
13	Kavajë	28,049	5,271	7,837	30,615	0.02%
14	Klos	427,110	76,102	-	351,008	0.23%
15	Kolonjë	9,387	-	-	9,387	0.01%
16	Korçë	87,790	16,475	4,730	76,045	0.05%
17	Krujë	2,672,631	-	134,246	2,806,877	1.83%
18	Kuçovë	180,729	2,018	-	178,711	0.12%
19	Kukës	262,079	-	86,446	348,525	0.23%
20	Kurbin	60,866	-	2,059	62,925	0.04%
21	Lezhë	594,431	59,971	22,151	556,611	0.36%
22	Librazhd	129,656	-	24	129,680	0.08%
23	Lushnje	5,061,371	-	359,803	5,421,174	3.53%
24	Malësi e Madhe	48	-	-	48	0.00%
25	Maliq	3,339	-	-	3,339	0.00%
26	Mallakastër	3,319,572	131,971	158,139	3,345,740	2.18%
27	Mat	65,513	6,229	96,620	155,904	0.10%
28	Mirditë	437,075	-	-	437,075	0.28%
29	Patos	43,525,958	4,274	3,108,525	46,630,209	30.38%
30	Përmet	11,123	-	-	11,123	0.01%
31	Pogradec	93,152	-	-	93,152	0.06%
32	Polican	24,616	-	331	24,947	0.02%
33	Prrenjas	202,369	-	-	202,369	0.13%
34	Roskovec	38,556,377	-	2,446,662	41,003,039	26.72%
35	Selenicë	511,005	7,233	-	503,772	0.33%
36	Shijak	73,314	-	5,473	78,787	0.05%
37	Shkodër	82,438	10,275	1,291	73,454	0.05%
38	Skrapar	319,141	-	59,814	378,955	0.25%
39	Tepelenë	18,205	17,550	-	655	0.00%
40	Tiranë	323,827	14,042	50,391	360,176	0.23%
41	Tropojë	189,405	-	-	189,405	0.12%
42	Ura Vajgurore	136,353	13,894	-	122,459	0.08%
43	Vau i Dejës	93,798	44,761	-	49,037	0.03%
44	Vlorë	806	-	-	806	0.00%
45	Vorë	35,261	-	5,248	40,509	0.03%
	TOTAL	**147,968,156**	**2,848,680**	**8,360,068**	**153,479,544**	**100.00%**

7. Cilësia e të dhënave, siguria dhe raportimi

7.1 Cilësia dhe siguria e të dhënave

Nuk aplikohen kërkesa të veçanta auditi për të licencuarit që veprojnë në sektorët nxjerrës dhe institucionet publike që sigurojnë mbikëqyrjen e sektorit të nxjerrjes.

Standardi EITI 4.9 (a) kërkon që flukset e përpiluara në raportin vjetor EITI të jenë të besueshme dhe i nënshtrohen sigurimit në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit. MSG sugjeroi që të licencuarit e përzgjedhur të raportojnë për të dhënë siguri mbi shifrat e raportuara të EITI, nëpërmjet termave të miratuara të referencave për vitin 2016. Sigurimi për të dhënat e raportuara nga EITI vjen me sfida dhe kosto shtesë në Shqipëri, për shkak se nuk ekzistojnë kërkesa të veçanta të auditimit në lidhje me shifrat e raportuar në EITI. Për më tepër këto të dhëna nuk mund të rregullohen lehtë dhe të konfirmohen me pasqyrat financiare të audituara dhe pasqyrat të tjera financiare të publikuara.

Kërkesat e sigurimit dhe raportimit për subjektet e përfshira në Shqipëri

Standardet e Kontabilitetit të aplikuara

Dispozitat rregullatore aktuale në Shqipëri kërkojnë që njësitë e inkorporuara të zbatojnë Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) ose Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK), të publikuara nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit për qëllime të kontabilitetit dhe raportimit ligjor. Fillimisht, SKK u derivua si një version i thjeshtuar i SNRF dhe më pas është rregulluar që të përputhej me SNRF për NVM-të, e cila është një version më i thjeshtë i lëshuar për t'u miratuar nga subjekte më të vogla dhe me veprimtari më pak komplekse. Në përputhje me ligjin e kontabilitetit, në vitin 2016, të gjitha njësitë e përfshira në Shqipëri duhet të adoptojnë SNRF, grupin e plotë të standardeve ose versionin e thjeshtuar për NVM-të.

Standardet e Auditit të aplikuara

Të gjitha subjektet, përfshirë shoqëritë aksionare me pjesëmarrje ("SHA") dhe shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar ("SHPK") janë subjekt i auditimit ligjor, duke përjashtuar SHPK të klasifikuara si njësi më e vogël, në përputhje me përkufizimin e parashikuar nga neni 41 i Ligjit mbi Auditimin nr. 10091 "Për auditimin ligjor, organizimin e auditorit të regjistruar dhe profesionin e kontabilitetit të akreditуar", të datës 5 mars 2009, të ndryshuar. Sipas këtij ligji, subjektet më të vogla janë ato që plotësojnë dy nga kriteret e mëposhtme:

- Totali i aktiveve është më i ulët se 50 milionë lekë;
- Jo më shumë se mesatarisht 30 persona të punësuar; dhe
- Të ardhurat vjetore nuk tejkalojnë 100 milionë lekë.

Krahas kësaj, ligji kërkon që të gjitha subjektet që zgjedhin të raportojnë sipas SNRF për qëllime ligjore, duke përfshirë edhe njësi të vogla që vullnetarisht miratojnë SNRF, t'i nënshtrohen auditimit ligjor.

Subjektet e regjistruara si degë të korporatave të huaja nuk i nënshtrohen procedurave të auditimit ligjor, vetëm nëse ata zgjedhin vullnetarisht për t'u audituar.

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe Sigurisë (IAASB: https://www.iaasb.org/) janë të zbatueshme për të gjitha angazhimet e auditimit të jashtëm dhe të sigurisë të kryera nga auditorët e licencuar në Shqipëri. Auditimi profesional dhe organi i kontabilitetit (Instituti i Auditorëve të Autorizuar të Shqipërisë, IEKA: www.ieka.org) është anëtare e Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (IFAC: www.ifac.org) që nga viti 2000.

Dispozitat e transparencës kontabël në Shqipëri kërkojnë që të gjitha subjektet e regjistruara në Shqipëri të dorëzojnë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (www.qkr.gov.al) raportet e tyre financiare dhe raportet e auditimit, kur i nënshtrohen auditimit ligjor, brenda 31 korrikut të vitit pasardhës kalendarik. Raportimi financiar vjetor, me informacion mbi pronësinë ligjore publikohet dhe mund të aksesohet lirisht nga të gjithë grupet e interesit në faqen zyrtare të QKB (link: http://qkr.gov.al/search/search-in-trade-register/search-for-subject/).

Udhëzim për qasjen dhe shkarkimin e pasqyrave financiare nga faqja e internetit të QKB

Plotësoni numrin NUIS siç tregohet më poshtë dhe kërkoni për ekstraktin e regjistrit tregtar dhe licencat e bashkangjitura në numrin NUIS. Emri i shoqërisë, aksionarët etj. mund të përdoren për kërkim, si mënyrë alternative në vend të NUIS.



Pasi shkarkon ekstraktin historik mund të bëni kërkime nëpër historinë e vendimeve dhe pasqyrave financiare të ngarkuara. Siç tregohet më poshtë, linku i pasqyrave financiare është i përfshirë në dokumentin e ekstraktit historik dhe këto dokumente mund të shkarkohen duke klikuar në linkun e treguar.



28/12/2017

Numri i ceshtjes: CN-609690-12-17 (APLIKIM PER DEPOZITIM PASQYRA FINANCIARE)
Arsyet e hapjes se ceshtjes: Depozitim i Pasqyrave Financiare i Vitit 2016.

Lista e Dokumenteve:
Akti i Pageses e kundravajtjes administrative (nëse ka)
Akti i miratimit te bilancit nga asambleja subjektit, ose nga individi tregtar)
Dokumenti i autorizimit
Raport Auditimi
Bilanci Kontabël
Mandati i Pageses

Aktualisht, ligjet e kontabilitetit dhe auditimit nuk parashikojnë kërkesa të veçanta për dhënien e informacioneve shpjeguese apo për auditimin e treguesve kryesorë të performancës ose të raportit EITI të koncesioneve dhe licencave të dhëna për sektorin nxjerrës në Shqipëri, si dhe shifrat e raportuara sipas EITI.

Analiza e situatës në 2016

Për vitin 2016, 135 nga 141 shoqëri të përzgjedhura kanë publikuar pasqyrat e tyre financiare në portalin e QKB-së. Vetëm një prej shoqërive që është zgjedhur për raportim nuk ka publikuar pasqyrat financiare në QKB, megjithatë i ka dorëzuar ato së bashku me raportimin e EITI.

Në përgjithësi, pasqyrat financiare japin informacion të kufizuar për nivelin e prodhimit, investimet e bëra dhe rezervat e vlerësuara. Nga 136 shoqëri, 65 prej tyre kishin pasqyrat e tyre financiare të audituara për vitin 2016. Nga analiza e raporteve të auditimit për pasqyrat financiare të publikuara në QKB, vërehet se 8 auditime të 65 subjekteve kishin mendime të modifikuara. Këtu përfshihen Albpetrol Sh.a., Phoenix Petroleum Sh.a., Kurum International sh.a., Brisel Sh.p.k, Al-Gem sh.a., TMC - Transport - Miniera - Ndërtim, KESH dhe Power Elektrik Slabinje sh.p.k.

Numri i shoqërive raportuese të përzgjedhura sipas sektorit	Numri i shoqërive raportuese që publikuan pasqyra financiare për 2016	Numri i shoqërive raportuese të përzgjedhura që publikuan opinionet e audituesve për 2016	Nunri i shoqërive raportuese që kanë opinione të kualifikuara për 2016
Nafta dhe gazi	9	4	2
Sektori mineral	115	50	3
Hidro-energji	12	11	3
Total	**136**	**65**	**8**

Arsyet për rastet kur opinioni i audituesit është modifikuar janë të ndryshme. Megjithatë, pamundësia e auditesit për të konfirmuar balancat e inventarit ishte arsyeja më e shpeshtë për një opinion të modifikuar në rastin e shoqërive të naftës dhe minerare, duke përfshirë edhe Albpetrolin. Pamundësia për të konfirmuar balancat e inventarit ndikon në mendimin mbi prodhimin dhe nivelin e të ardhurave. Në tre prej rasteve, aftësia e audituesit për të konfirmuar balancën e inventarit ishte e kufizuar sepse audituesi u emërua pas përfundimit të vitit kontabël. Shoqëritë mund ta shmangin këtë kufizim duke caktuar audituesin më herët se fundi i vitit kontabël.

Ju lutemi referojuni Shtojcës 6 për listën e plotë të subjekteve raportuese që publikojnë pasqyrat e tyre financiare dhe raportet e auditimit në portalin e QKB-së.

Siguria mbi shifrat e raportuara në kuadrin e raportit EITI

Subjekteve raportuese iu kërkua të japin raportin e sigurisë së shifrave të lëshuar nga auditorët e tyre ligjorë ose auditori i zgjedhur duke konfirmuar plotësinë dhe saktësinë e flukseve të raportuara në formularet e raportimit EITI. Subjektet raportuese u udhëzuan të zbatojnë standardet ndërkombëtare të auditimit në kryerjen e angazhimit të sigurisë.

Në datën e këtij raporti, vetëm 17 nga 121 subjekte kanë dorëzuar raportin e sigurisë. Numri i përgjithshëm i flukseve të siguruara arrin në 5.7 miliardë lekë dhe zë 39% të flukseve totale të raportuara nga të licencuarit në 2016.

Bankers Petroleum ishte e vetmja shoqëri nafte që dorëzoi raportin e sigurisë mbi flukset e raportuara të EITI në 2016.

Ju lutemi referojuni Shtojcës 6 për listën e plotë të subjekteve raportuese që ofrojnë siguri për të dhënat e raportuara për vitin 2016.

Raportimi rregullator dhe auditimi

Subjektet e angazhuara në sektorin nxjerrës të sektorit nxjerrës të naftës, minerar dhe sektorit të hidro-energjisë janë të detyruar të raportojnë tek AKBN për:

- Investimet e kryera
- Nivelin e prodhimit
- Sasitë dhe vlera e shitjeve
- Punimet e kryera
- Rehabilitimin e mjedisit
- Ndryshimet në rezerva, etj.

AKBN kryen auditimet e performancës për marrëveshjet e naftës, licencat minerare dhe operimit të koncesioneve hidroenergjetike në Shqipëri. Metodat e mbikqyrjes dhe procedurat e auditimit që përdor AKBN nuk janë bërë publike.

Bazuar në pyetjet me përfaqësuesit e AKBN, ne kuptojmë se auditimet e AKBN-së synojnë të monitorojnë përputhjen me marrëveshjen financiare dhe mjedisore të licencave dhe / ose koncesioneve.

AKBN informoi që statistikat mbi prodhimin e mallrave, rezervave dhe numrin e punonjësve, të dhëna për qëllime raportimi rrjedhin nga vet-deklarimet e raportuara nga të licencuarit tek AKBN-së si pjesë e raportimit vjetor dhe nuk janë konfirmuar përmes ndonjë procesi sigurimi.

Krahas AKBN-së, edhe Albpetrol është angazhuar në mënyrë aktive për të monitoruar prodhimin dhe operacionet e subjekteve që veprojnë sipas një licence nën administrimin e saj. Këto përfshijnë të gjitha licencat që operojnë në një fushë-prodhimi nafte. Albpetrol është përqendruar në monitorimin e përputhshmërisë me marrëveshjet dhe shlyerjen e detyrimeve kontraktuale ndaj Albpetrol.

Prodhimi i sektorit hidroenergjetik matet dhe raportohet nga operatorët e rrjetit të shpërndarjes dhe / ose të transmetimit, pasi prodhuesit e hidroenergjisë lidhen me këto rrjete. Pikat e lidhjes janë të pajisura me matësa që matin fuqinë e rrjedhës së energjisë. Krahas kësaj, shoqëritë hidroenergjetike bëjnë rregullisht rakordim të fuqisë së energjisë që transmetohet në rrjetin e shpërndarjes dhe transmetimit të energjisë.

AKBN mbledh dhe përpunon bilancin e hyrjeve dhe daljeve të energjisë nga secila shoqëri hidroenergjetike që prodhon ose operon në rrjetin hidroenergjetik duke prodhuar në fund raportin për balancën e energjisë për këtë sektor.

Auditimi i institucioneve qeveritare

Aktiviteti dhe llogaritë e Institucioneve qeveritare auditohen nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në Shqipëri (KLSH) në përputhje me ligjet dhe rregulloret e KLSH-së në faqen e internetit: (http://www.klsh.org.al/). Udhëzimet dhe standardet e auditimit bazohen në standardet e INTOSAI për auditimin e Qeverisë. Auditimet e pajtueshmërisë dhe të performancës publikohen dhe mund të arrihen lirisht nga të gjithë lexuesit e interesuar në faqen e internetit të SSA: http://www.klsh.org.al/web/Raporte_Auditimi_201_1.php

Subjektet e mëposhtme qeveritare u përzgjodhën për të raportuar flukset sipas EITI për vitin 2016:

Institucioni shtetëror	Flukset e raportuara për vitin 2016	Siguria mbi flukset e raportuara
Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	Po	Jo
Administrata Doganore Shqiptare	Po	Jo
AKBN	Po	Jo
Albpetrol	Po	Jo
MIE	Jo	Jo
Bashkia e Fierit	Jo	Jo
Bashkia e Bulqizës	Po	Jo
Bashkia e Krujës	Jo	Jo
Bashkia e Patosit	Po	Jo
Bashkia e Prrenjasit	Po	Jo
Bashkia e Roskovecit	Po	Jo
Bashkia e Kukësit	Jo	Jo

Pasi lexuam raportet e publikuara nga SSA gjatë 2017 dhe 2016 për institucionet publike dhe SoE-të (njësitë në pronësi shtetërore) që veprojnë në sektorin e energjisë dhe burimeve nuk identifikuan asnjë gjetje që mund të ndikojë në saktësinë dhe gjithëpërfshirjen e shifrave të raportit EITI. Megjithatë, fushëveprimi dhe frekuenca e këtyre raporteve nuk janë të përshtatshme për të dhënë siguri për të dhënat dhe numrat e raportuar nga institucionet publike dhe të përfshira në këtë raport.

Albpetroli ishte i vetmi entitet publik që publikoi pasqyra vjetore financiare, të cilat ishin subjekt i auditimit statutor financiar. Asnjë nga institucionet e tjera publike nuk mundësuan pasqyra vjetore financiare.

Analiza e pasqyrave financiare të audituara të Albpetrolit

Pasqyrat financiare të audituara të Albpetrol për vitin 2016 u krahasuan me flukset dhe të dhënat e raportuara nga Albpetrol për raportin EITI.

Pagesat tatimore të raportuara nga Albpetrol nuk mund të rakordoheshin me informacionin e disponueshëm në pasqyrat financiare, për shkak të bazave të ndryshme të raportimit (kontabiliteti rrjedhës kundrejt kontabilitetit me bazë paranë) dhe mungesës së deklarimit të të dhënave të hollësishme për flukset e dhëna në pasqyrat financiare të Albpetrol.

Për më tepër, ne vumë re që siguria e dhënë nga audituesi ligjor mbi inventarin dhe shitjet e Albpetrolit të vitit 2016 ishte e limituar, për shkak të pamundësisë së auditorit për të marrë pjesë në numërimin e inventarit në fund të vitit. Si rezultat i këtij limitimi, audituesi ligjor i Albpetrolit nuk

shprehu asnjë mendim mbi të ardhurat e raportuara nga Albpetrol për vitin 2016.

Sigurimi mbi të ardhurat dhe inventarin e Albpetrolit është një përparësi për transparencën. Në këtë kontekst, MSG do të shqyrtojë mundësinë që Albpetrol të emërojë audituesin e tij ligjor më herët dhe t'i japë të gjitha akseset e nevojshme për të shmangur kufizime të tilla në sigurimin e të ardhurave vjetore.

Rakordimi i shitjeve të Albpetrolit

Në përputhje me kërkesën 4.2 të EITI, në përpjekjen për të rritur saktësinë dhe plotësinë e të dhënave të tregtimit të komiditetit, MSG ra dakord për rakordimin e sasive dhe vlerave të naftës bruto të shitur nga Albpetrol tek kontraktuesit e saj.

Modeli i rakordimit përfshinte pyetje të hapura dhe ndonjë mosmarrëveshje midis Albpetrol dhe kontraktorëve të saj.

Gjithsesi, procedura nuk u implementua në mënyrë të suksesshme sepse Albpetrol nuk mundi t'i jepte akses kontraktorëve të tij. Një nga arsyet e përmendura ishte koha e kaluar që nga përfundimi i kontratës etj.

Përfshirja e SSA për subjektet qeveritare

Siç është përmendur edhe më lart, subjektet qeveritare, duke përfshirë Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Administratën Doganore Shqiptare, AKBN, njësitë e qeverisjes vendore, etj., nuk publikojnë pasqyrat vjetore financiare ose nuk kalojnë përmes auditimeve vjetore financiare. Megjithatë, këto subjekte sigurojnë kontribut kryesor për shifrat e raportuara sipas EITI. Për të rritur sigurinë e flukseve të raportuara nga këto njësi qeveritare, MSG mund të konsiderojë angazhimin e Auditorit të Lartë të Shtetit për të kryer procese specifike të auditimit dhe për të dhënë siguri mbi shifrat e raportuara në kuadër të raportit EITI.Përsa i përket sigurimit të flukseve të raportuara nga Albpetrol, MSG mund të kërkojë nga Albpetrol që të angazhojë audituesin e tij ligjor për të kryer procedura shtesë për shifrat e raportuara për EITI ose për të angazhuar SSA për të kryer procedurën e specifikuar të auditimit në këtë drejtim.

Analiza e nivelit të sigurisë së të dhënave të paraqitura në këtë raport

Grafiku 37 më poshtë paraqet një analizë strukturore të flukseve të raportuara nga të licencuarit e përzgjedhur. Flukset e raportuara nga 50 të licencuarit më të mëdhenj përbëjnë mbi 94% të totalit të flukseve të zgjedhura për rakordim mes 141 të licencuarve.

Grafiku 37 – Struktura e flukseve të raportuara



Kjo analizë tregon se flukset materiale të përzgjedhura për rakordim sipas EITI paguhen nga një numër dukshëm më i ulët i subjekteve raportuese. Në këtë kontekst, për qëllime të efikasitetit MSG mund të marrë në konsideratë

ndryshimin e pragut të materialitetit dhe të kërkojë vetëm njësitë më të mëdha për të raportuar sipas EITI.

Siç është paraqitur në grafikun 38, 50 të licencuarit më të mëdhenj në bazë të flukseve të raportuara, janë audituar ligjërisht në pothuajse të gjitha rastet, si dhe kanë ofruar siguri specifike për shifrat EITI për 38.5% të flukseve të raportuara.

Grafiku 38 – Siguria mbi flukset e raportuara



Subjektet raportuese, të cilat nuk sollën raport auditimi në vitin 2016, nuk ishin subjekt i auditimit ligjor në vitin 2016, për shkak se përmasat e tyre ishin brenda kufinjve të përcaktuara nga kërkesat rregullatore për auditimin në Shqipëri.

Më poshtë prezantohet një analizë risku që lidhet me çdo fluks të raportuar dhe nivelin e përgjithshëm të sigurisë mbi flukset e EITI-t për vitin 2016.

Pagesat fiskale të bëra tek autoritetet tatimore dhe doganore

Pagesat fiskale përbëjnë pjesën më të madhe të flukseve monetare të paguara nga shoqëritë e angazhuara në sektorin nxjerrës dhe sektorin e hidroenergjisë. Këto pagesa përbëjnë më shumë se 80% të totalit të flukseve të rakorduara në këtë raport.

Pagesat fiskale që janë bërë ndaj autoriteteve tatimore ose autoriteteve doganore përfshijnë:

- Tatimin mbi Fitimin
- Rentat Minerare
- Pagesat për sigurime shoqërore dhe shëndetsore
- Pagesat mbi të ardhurat personale
- TVSH
- Tatimin mbi Dividentin
- Penalitetet tatimore
- Etj.

Pagesat fiskale në Shqipëri janë mjaft të rregulluara nga ligji dhe entet rregullatore që prezantojnë kërkesa të qarta dhe instruksione mbi taksat që aplikohen. Çdo vonesë në raportimin e taksave dhe në pagimin e tyre është subjekt i penaliteteve të rënda dhe interesave.

Subjektet raportuese kanë qasje në kohë reale në statusin e tyre tatimor për pagesat e taksave dhe balancat ndaj autoriteteve tatimore.

Mundësia për të mospërfshirë taksat e raportuara nga EITI janë shumë të ulëta për shkak të rregullimit të lartë të këtyre pagesave dhe angazhimit aktiv të agjentëve fiskalë në luftimin e evazionit fiskal. Për shkak të këtij fakti, të licencuarit që paguajnë janë të prirur për të raportuar të gjitha pagesat e bëra dhe i kanë këto shifra të rakorduara me raportimin e agjentëve fiskalë.

Natyra e gabimeve ose mospërputhjeve që kanë lindur në të shkuarën por që janë prezente dhe në këtë raport janë kryesisht:

- Pagesat e raportuara mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara kundrejt pagesave të raportuara mbi baza monetare;
- Pagesat e raportuara mbi bazën e agreguar dhe analitike;
- Shumat e harruara në raportimin fillestar;
- Klasifikimi i gabuar i pagesave tatimore dhe penaliteteve tatimore përkatëse;
- Etj.

Shumica e gabimeve janë zgjidhur gjatë procesit të rakordimit, duke u analizuar në baza pagese-pas-pagese. Pagesat fiskale të raportuara për të dyja palët për vitin 2016 u rakorduan në masën 98% të flukseve të raportuara. Procedurat e rakordimit nuk kanë për qëllim zbulimin e evazionit fiskal. Megjithatë, ky rrezik zbutet nga fakti se 78.7% (grafiku 38) të flukseve janë raportuar nga njësitë ekonomike që kanë kaluar përmes auditimit ligjor.

Duke marrë parasysh faktet e listuara më sipër dhe nivelin e flukseve të rakorduara, çdo mospërfshirje ose keq deklarim që do të dilte në pah nga rakordimi, nuk do të ndikonte në mënyrë të ndjeshme në tërësinë e Raportit EITI.

Bonuset e mbledhura nga AKBN dhe Albpetrol

Pagesat e Bonuseve të bëra ndaj AKBN dhe Albpetrol bazuar në marrëveshjet aktuale të naftës në fuqi përbëjnë 0.3% të flukseve të raportuara. Pjesa e tyre ka qenë më e ulët se 1% e fluksit të raportuar për 5 vitet e fundit. Marrëveshjet hidrokarbure për operacionet shqiptare që kanë qasje në internet, nuk kanë zbuluar vlera të larta, të cilat mund të hedhin dyshime për ndonjë mospërfshirje të pagesave të raportuara në vitin 2016 dhe gjatë pesë viteve të fundit.

Për më tepër, Bankers Petroleum dorëzoi një raport sigurie mbi flukset e raportuara të EITI-t, duke dhënë një nivel sigurimi për 35% të pagesave të bonuseve të raportuara për vitin 2016.

Duke marrë parasysh materialitetin relativisht të ulët të këtij fluksi monetar të pagesave dhe nivelin e arritur të sigurisë, çdo mos-raportim apo deklarim i gabuar nuk do të kishte ndikim të ndjeshëm në tërësinë e raportit EITI.

Raporit i pagesave të naftës ndaj Albpetrol

Një pjesë të pagesave të naftës i bëhen Albpetrol-it në bazë të PSA-ve në fazën e prodhimit dhe përbëjnë 8% të totalit të pagesave të rakorduara në vitin 2016. Albpetrol i mbledh këto pagesa në naftë në vendin e prodhimit të shoqërisë. Bankers Petroleum, prodhuesi më i madh i naftës, ishte shoqëria e vetme e naftës që dorëzoi një raport sigurie që mbulonte të gjitha flukset e pagesave të raportuara në vitin 2016. Pagesat e raportuara nga Bankers Petroleum përbëjnë 45% të totalit të pagesave të naftës të rakorduara në vitin 2016.

Të gjitha pagesat e naftës të raportuara në vitin 2016 nga të licencuarit dhe Albpetrol u rakorduan plotësisht duke shënuar kështu vitin e pestë pa mospërputhje midis raportimit të flukseve nga të dy palët. Krahas kësaj, shoqëritë dhe Albpetrol i nënshtrohen rakordimeve periodike të pagesave të naftës çdo vit, duke përfshirë edhe vitin 2016.

Duke marrë parasysh shkallën e materialitetit relativisht të ulët të këtij fluksi të pagesave, nivelin e sigurimit të ofruar, dhe historinë e mospërputhjeve gjatë pesë viteve të dundit, çdo mos-raportim apo

deklarim i gabuar nuk do të kishte ndikim të ndjeshëm në tërësinë e raportit EITI.

Pagesa të tjera ndaj Shtetit

Pagesa të tjera për shtetin përbëjnë 9% të flukseve totale të pagesave të raportuara dhe të rakorduara në vitin 2016. Nga këto pagesa, 90% janë pagesa fiskale që u bëhen autoriteteve doganore për importin e holluesve dhe produkteve të tjera të naftës që u duhen shoqërive të naftës dhe shoqërive minerare në proceset e tyre të shkrirjes. Subjektet raportuese dhanë raportet e sigurimit për shumën që përbën 59% të flukseve të raportuara dhe të rakorduara në vitin 2016 për këtë fluks të pagesës.

*Duke marrë parasysh natyrën shumë të rregulluar të këtyre lloj pagesash, rrezikun e ulët të mospërputhjeve dhe nivelin e lart*ë të *sigurimit nga subjektet raportuese, çdo mos-raportim apo deklarim i gabuarnuk do të kishte ndikim të ndjeshëm në tërësinë e raportit EITI*.

Pagesa të tjera që i bëhen NjQV-ve

Pagesat e tjera për NJQV-në përbëhen nga taksat vendore të raportuara nga subjektet raportuese për shtatë NjQV të përzgjedhura, duke përfshirë bashkitë e Fierit, Patosit, Bulqizës, Roskovecit, Prrenjasit, Kukësit dhe Krujës, të cilat përfaqësojnë bashkitë kryesore nxjerrëse në Shqipëri. Këto pagesa përbëjnë 2% të flukseve totale të pagesave të raportuara dhe të rakorduara në vitin 2016.

Subjektet raportuese dhanë raportet e sigurimit për shuma që përbëjnë 61% të flukseve të raportuara dhe të rakorduara në vitin 2016 për këtë fluks pagese.

Duke marrë parasysh materialitetin relativisht të ulët të fluksit të pagesave dhe nivelin e sigurimit të ofruar, çdo mos-raportim apo deklarim i gabuar nuk do të kishte ndikim të ndjeshëm në tërësinë e raportit EITI.

Transfertat kombëtare e rentës minerare

Bazuar në vendimin e MSG, janë bënë transferimet kombëtare të rentës minerare për shtatë NjQV të përzgjedhura duke përfshirë: Bashkinë e Fierit, Patos, Roskovec, Bulqizë, Kukës, Krujë dhe Përrenjas të cilat përfaqësojnë rrethet kryesore nxjerrëse në Shqipëri, të cilat përbëjnë sëbashku 91% të transfertave në nivel lokal të rentës gjatë vitit 2016.

NjQV-të kanë raportuar shumat e pretenduara ndaj Ministrisë së Financave, në vend të rentës aktuale të transferuar. Shuma e kërkuar është krahasuar me transferimet e deklaruara nga Ministria e Financave. Rezultatet e rakordimit tregojnë se transfertat e rentës ishin më të larta se shuma e kërkuar në rastin e rretheve që operojnë në sektorin nxjerrës të naftës dhe më e ulët se shuma e kërkuar në rrethet që operojnë në sektorin nxjerrës të mineraleve (kapitulli 6). Subjektet nuk kanë dhënë detaje sqaruese deri në datën e këtij raporti.

Asnjë nga subjektet raportues nuk i janë nënshtruar procedurave të sigurimit. MSG mund të përfitojë nga përfshirja e SSA për të siguruar siguri në këtë fushë.

7.2. Informacioni i raportuar dhe niveli i ndarjes së informacionit

Publikimi i flukseve sipas shoqërive dhe flukseve të pagesave

Raportimi EITI në Shqipëri për sektorin minerar dhe të naftës rregullohet respektivisht me ligjin nr. 10304 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", të datës 15 korrik 2010 (i ndryshuar në mars 2015) dhe Ligjit

Nr.7746 "Për Hidrokarburet (Kërkimi and Prodhimi)" të datës 28 korrik 1993 (i ndryshuar në tetor 2014).

Të dyja ligjet kërkojnë raportimin e flukseve të bëra nga të licencuarit që veprojnë në sektorët e naftës dhe atë minerar dhe palët pranuese, duke përfshirë Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Administratën Doganore Shqiptare dhe institucionet publike qendrore dhe lokale që mbledhin të ardhura nga sektori. Kërkesat e raportimit EITI për institucionet qeveritare arkëtuese aktualisht janë në konflikt me detyrën e tyre statutore për të ruajtur konfidencialitetin mbi informacionin e marrë në lidhje me detyrat e tyre rregullatore. Këto dispozita konfidencialiteti, të referuara në ligjet e aplikueshme për procedurat tatimore dhe doganore në Shqipëri, lejojnë qasje në të dhënat vetëm me pëlqimin e shprehur nga i Licencuari. Organet qeveritare mund t'i shkëmbejnë të dhënat sipas kushteve strikte të konfidencialitetit.

Zbatimi aktual rregullator nuk trajton format e raportimit në lidhje me flukset e mjeteve monetare dhe informacionin kontekstual. Një version fillestar i formularëve të raportimit i zbatueshëm për raportimin nga sektori minerar aprovohet me VKM nr. 233 më 23 mars 2011. Për shkak të miratimit para publikimit të standardit të ri EITI në vitin 2016, forma nuk arrin të trajtojë shumë aspekte të kërkesave aktuale të raportimit, siç është publikimi i të dhënave në nivel analitik dhe procesi i sigurisë.

Për të kapërcyer këtë pengesë, formularët e raportimit përfshinin një letër që jep pëlqimin e qartë të të licencuarit për të patur qasje në të dhënat e raportuara:

- tek entet publike arkëtuese për raportimin e të dhënave për të licencuarit të cilat klasifikohen si konfidenciale sipas ligjeve, rregulloreve dhe marrëveshjeve qeverisëse;
- të lejojë publikimin e flukseve monetare sipas flukseve të pagesave nga ana e të licencuarit në një nivel analitik në raportin EITI.

Megjithatë, për shkak të vonesave të ndjeshme në procesin e raportimit nga të dy palët, si nga të licencuarit edhe nga institucionet publike arkëtuese, kjo procedurë rezulton të jetë jo efektive për qëllimin e këtij raportimi, pasi kemi marrë vetëm 58 konfirmime zyrtare të nënshkruara nga 102 të tilla.

Duke marrë parasysh numrin e ulët të autorizimeve zyrtare të nënshkruara, ne kemi dërguar një email direkt konfirmimi për pranimin ose mospranimin e publikimit të të dhënave:

- duke iu shpjeguar subjekteve raportuese që informacioni i raportuar nga ana e tyre për procesin e rakordimit EITI në vitin 2016 do të publikohet në raportin EITI i ndarë sipas nivelit të taksave të paguara nga secila licencë; dhe
- duke iu kërkuar subjekteve raportuese të shprehin mos-pëlqimin e tyre të qartë nëse nuk bien dakord për publikimin analitik të flukseve të raportuara nga ana e tyre.

Subjektet raportuese kishin kohë një muaj të jepnin pëlqimin ose mospëlqimin e tyre. Vetëm 3 nga 44 subjektet raportuese, shprehën mos-pëlqimin e tyre. Si rrjedhojë, flukset që i përkisnin këtyre tre subjekteve raportuese u grumbulluan dhe u prezantuan në total në shtojcat e këtij raporti.

Ndryshimet rregullatore pasardhëse

Qeveria e Shqipërisë është në proces të publikimit të një ligji të ri mbi zbatimin e EITI në Shqipëri. Ky ligj i ri përcakton rolet, përkufizimet, kërkesat e raportimit dhe afatet kohore për raportim.

Sipas projektligjit, subjektet private dhe publike që veprojnë në këtë sektor do të raportojnë pagesat dhe informacionin e kërkuara nga akti rregullator sekondar që do të shoqërojë ligjin për qëllimin e raportimit të EITI jo më vonë se më 31 mars të vitit pasardhës. Krahas flukseve të pagesave, subjektet publike rregullatore do të raportojnë mbi baza të vazhdueshme edhe informacione kontekstuale mbi rregulloren dhe aktivitetin e sektorit.

MSG njoftoi se ligji është në shqyrtim dhe pritet të finalizohet në vitin 2018.

Deklarimi i pronarëve përfitues

Ndryshimet e Standardit EITI në vitin 2016, kërkojnë që të gjithë vendet anëtare të sigurohen që shoqëritë që konkurojnë apo operojnë në pasuritë e tyre natyrore të bëjnë të ditur identitetin e pronarëve përfitues duke filluar nga 1 Janari 2020. Standardi rekomandon që informacioni për pronarët përfitues të organizohet dhe publikohet në një regjistër publik, ku ndër të tjera të identifikohet edhe nëse këta pronarë janë të ekspozuar politikisht.

Statusi aktual

Qeveria e Shqipërisë nuk mban dhe nuk publikon një regjistër ku renditen të gjithë pronarët përfitues dhe aksionet e tyre në përputhje me përkufizimin e EITI. Informacioni mblidhet në një farë mase, në momentin që të licencuarit i jepet PSA, megjithatë procesi për azhornimin, publikimin dhe sigurimin e saktësisë së informacionit nuk është themeluar.

Publikimi i tanishëm i transparencës përfshin dhënien e informacioneve të azhornuara mbi emrat e aksionarëve të drejtpërdrejtë ligjorë dhe aktivitetit të të gjitha shoqërive që operojnë në Republikën e Shqipërisë. Këto mund të gjenden në faqen e internetit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit: http://www.qkr.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-tregtar/kerko-per-subjekt/. Ky informacion është publikuar në ekstraktin e Regjistrit Tregtar ose në dokumentet e bashkangjitura në të.

Ndryshimet rregullatore pasardhëse

Në mënyrë që të ndërmerren hapat e nevojshme drejt zbatimit të kësaj kërkese, EITI Shqipëri është angazhuar në një rishikim ligjor me qëllim identifikimin e hapave drejt zbatimit të plotë (identifikimit dhe regjistrimit të pronarëve përfitues) deri në janar 2017 dhe në hartimin e një ligji të ri, i cili siguron përkufizimin për pronësinë e përfituesit dhe përcakton kërkesën për raportim.

Sipas projektligjit pronarët përfitues janë ata persona që individualisht zotërojnë ose kontrollojnë më shumë se 25% të aksioneve të një shoqërie ose të të drejtave të votimit dhe / ose nëse ai / ajo është politikisht i ekspozuar, pavarësisht nga pjesëmarrja e tyre në shoqëri, me kusht që, në rast se shoqëritë nuk kryejnë ndonjë aktivitet ekonomik, por veprojnë si ndërmjetës për kanalizimin e të ardhurave nga burime të tjera, pragu i zbatueshëm do të ulet në 10%.

Ligji e ngarkon ministrinë përgjegjëse për burimet nxjerrëse për të mbajtur dhe azhornuar regjistrin e burimeve nxjerrëse që ofrojnë, operojnë dhe / ose investojnë në pasuri nxjerrëse. Për këtë qëllim, pronarët përfitues do të shpallen, pasi procesi i ofertave dhe ndryshime të tjera do të publikohen në Ministrinë përgjegjëse brenda 10 ditëve pas kryerjes së transaksionit. Regjistri duhet të jetë i disponueshëm publikisht dhe në çdo kohë i

aksesueshëm, me përjashtim të informacioneve mbi datën e lindjes dhe adresën e banimit të pronarit përfitues.

Projektligji i detyron subjektet juridike publike dhe private që kryejnë veprimtari kërkimi dhe / ose shfrytëzimi në industritë nxjerrëse në Shqipëri të publikojnë dhe raportojnë të dhënat mbi pronarin (ët) e tyre përfitues çdo vit duke dorëzuar formularin e Deklarimit EITI të pronarëve përfitues që përfshin:

(a) emrin e plotë, datën e lindjes, shtetësinë, vendin ose rezidencën e banimit, adresat e banimit dhe adresën e shërbimit të secilit pronar përfitues; dhe
(b) një deklaratë të natyrës dhe shkallës së interesit të mbajtur nga secili pronar përfitues.

Personat e ekspozuar politikisht përcaktohen sipas ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhururve dhe të disa nëpunësve publikë", si individë që kanë pasur ose kanë funksione të rëndësishme në një qeveri dhe / ose në një shtet të huaj, si: kryetar i shtetit dhe / ose qeverisë, politikanët e lartë, zyrtarët e lartë të qeverisë, gjyqësori ose ushtria, udhëheqësit e lartë të shoqërive publike, zyrtarët kryesorë të partive politike, duke përfshirë anëtarët e familjes ose persona që kanë marrëdhënie të afërta personale, si pune ose biznesi.

Kërkesat e ligjit shtrihen gjithashtu edhe tek anëtarët e familjes ose personave të lidhur në marrëdhënie të ngushta personale, të punës ose të biznesit, duke përjashtuar punonjësit e nivelit të mesëm ose të ulët të menaxhimit, sipas dispozitave të legjislacionit të shërbimit civil. Sipas rezultatit të rishikimit ligjor, ky përkufizim është në përputhje me Task Forcën e Veprimit Financiar.

Aktualisht, i vetmi ligj që përcakton përkufizimin e "pronarit përfitues" është Ligji Nr. 9917, 19 maj 2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", të ndryshuar (Ligji kundër pastrimit të parave). Rishikimi i hollësishëm ligjor ka rekomanduar disa ndryshime në Ligjin për pastrimin e parave me qëllim që të inkorporojë një prag të përshtatshëm më të ulët dhe t'i referohet shprehimisht aplikimit të tij tek të gjitha shoqëritë në industrinë nxjerrëse.

MSG njoftoi se ligji është në shqyrtim dhe pritet të finalizohet në vitin 2018.

Informacionet mbi pronarët përfitues për vitin 2016

Krahas rishikimit ligjor, MSG vendosi t'i bëj kërkesë subjekteve raportuese në mënyrë që të marrë reagime mbi gatishmërinë e tyre për të bashkëpunuar.

Formularët e raportimit për vitin 2016 përfshijnë një hapësirë të veçantë ku jepet shpjegim mbi pronarët përfitues dhe kërkohej informacion nga subjektet raportuese. Në datën e këtij raporti ne kemi marrë informacion vetëm për 1 nga 12 subjekte hidroenergjetike dhe 31 nga 81 subjekte minerare të përzgjedhura për raportim. Asnjë nga shoqëritë e naftës nuk e plotësuan formularin e pronarëve përfitues. Këto formularë përmbajnë informacion për aksionarët, të publikuar edhe në Qendrën Kombëtare të Biznesit në www.qkb.gov.al.

Gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave, përfaqësues të subjekteve të përzgjedhura për raportim u shprehen se nuk ishin në gjendje ose nuk kishin autorizimin për të dhënë një informacion të tillë.

8. Pamje e përgjithshme e flukseve të raportuara dhe e shoqërive raportuese

Shoqëritë dhe njësitë qeveritare duhet të raportojnë taksat dhe të ardhurat materiale. MSG përcakton pagesat dhe Shoqëritë që do të përfshihen në raportim në bazë të peshës së të ardhurave që rrjedhin në Buxhetin e Shtetit nga industria nxjerrëse dhe sektori i hidro-energjisë.

Të licencuarit e përzgjedhur duhet të raportojnë këto pagesa të bëra në vitin 2016 lidhur me aktivitetin e naftës, gazit, minerar dhe hidro-energjisë. MSG, përmes termave të referencës për raportimin EITI, specifikon të ardhurat që duhet të rakordohen siç përshkruhet në vijim.

8.1 Përzgjedhja e pagesave dhe shoqërive raportuese në sektorin e naftës dhe gazit

Në përputhje me kërkesat e specifikuara në standardet EITI 4.1[111], MSG zgjodhi për raportim:

1. Të gjitha pagesat materiale që rrjedhin nga kushtet e Marrëveshjeve Hidrokarbure të tilla si ndarja e prodhimit të naftës dhe bonuset. Këto pagesa mblidhen nga Albpetrol për zonat nën administrimin e tij ose nga AKBN për zonat nën administrimin e AKBN-së. Aktualisht, marrëveshjet e hidrokarbureve të dhëna për zonat nën administrimin e AKBN-së nuk kanë hyrë në fazën e prodhimit dhe për këtë arsye nuk gjeneruan pagesa për ndarjen e naftës në vitin 2016.
2. Të gjitha pagesat materiale që rrjedhin nga investimet direkte të shtetit në këtë sektor. Këto zakonisht përfshijnë dividentë të paguar nga Albpetrol. Gjithsesi, asnjë pagesë dividenti / fatura nuk ishin deklaruar në vitin 2016.
3. Pagesat tatimore të tilla si renta minerare, tatimi mbi fitimin dhe tatimi mbi dividentët, që lidhen drejtpërdrejt me operacionet hidrokarbure. Krahas pagesave të renditura në kërkesat e EITI 4.1, MSG vendosi të përfshijë edhe pagesat për gjobat tatimore, pagesat për sigurimet



[111] KËRKESA E EITI-it 4.1 liston pagesat e detyrueshme për t'u përfshirë në rakordim.

shoqërore dhe shëndetësore, tatimin mbi të ardhurat personale, dhe TVSH-në pasi këto kanë treguar një fluks të konsiderueshëm të ardhurash në Buxhetin e Shtetit në vitet e mëparshme.

4. Pagesat të tjera më të mëdha se 50,000 USD për pagesat e bëra ndaj Shtetit dhe 5,000 USD për pagesat e bëra ndaj NjQV-ve.

MSG përzgjodhi për raportim të gjitha shoqëritë e naftës dhe gazit në vitin 2016, me përjashtim të Albanides Energy që nuk ishte përfshirë në listat e ofruara nga MIE dhe AKBN. Kësaj shoqërie iu dha një PSA në një bllok kërkimi nafte në vitin 2016 (miratuar me VKM nr 266, datë 6 prill 2016). Lista e detajuar jepet në Shtojcën 1.

Në Shqipëri, MSG-ja (përmes termave të referencës) ka përjashtuar pagesat që nuk janë të lidhura drejtpërdrejt me veprimtarinë e naftës dhe gazit të tilla si: taksat e importit dhe taksat vendore që kanë natyrë të përgjithshme dhe zbatohen njësoj për të gjitha industritë. Të tilla taksa dhe tarifa nuk kanë kërkesa të veçanta për zbatim në sektorin e naftës dhe gazit. Gjithashtu, tarifat për lejet vjetore nuk paraqesin pagesa thelbësore nga sektori bazuar në informacionin e mbledhur në vitet më të hershme dhe prandaj nuk janë përfshirë në rakordim.



Pagesat Sociale

U kërkua që shoqëritë të raportonin pagesat sociale të detyrueshme sipas marrëveshjes së licencës të kryera në shumën mbi 5 milionë Lek. Marrësi i pagesës nuk e ka të detyrueshme të konfirmojë marrjen, dhe si rezultat, nuk u kërkua rakordimi me deklarimin e marrësit të pagesës.

Pagesat në natyrë

Të licencuarit duhet të raportonin çdo kontribut të dhënë në natyrë Shtetit ose shoqërive të zotëruara prej tij. Gjithsesi, krahas ndarjes së prodhimit të naftës, nuk është raportuar asnjë pagesë tjetër në 2016.

8.2 Përzgjedhja e pagesave dhe Shoqërive raportuese në sektorin minerar

Pagesat e përzgjedhura në sektorin minerar përfshijnë të gjitha pagesat me natyrë tatimore të tilla si renta minerare, tatimi mbi fitimin dhe tatimi mbi dividentit, të cilat janë të lidhura drejtpërdrejtë me operacionet minerare. Krahas këtyre pagesave, MSG vendosi të përfshijë edhe pagesat për gjobat tatimore, pagesat për sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore, tatimin mbi të ardhurat personale, si dhe TVSH pasi këto kanë treguar një rrjedhë të konsiderueshme pagesash në Buxhetin e Shtetit në vitet e mëparshme.



Shoqëritë e përzgjedhura në sektorin minerar u udhëzuan të raportonin detaje për pagesa të tjera të konsiderueshme për shtetin që tejkalonin vlerën 50,000 USD dhe për njësitë e qeverisjes vendore mbi 5,000 USD.

Në sektorin minerar, MSG dhe EITI Shqipëri përzgjodhën për raportim të gjitha shoqëritë që kishin licencë kërkimi në përpjekje për të zbuluar pagesa të rëndësishme nga aktiviteti i kërkim-zbulimit dhe prodhuesit më të mëdhenj minerar bazuar në kriteret e mëposhtme:

- Për nën-sektorin e kromit, të gjitha shoqëritë me të ardhura vjetore >600,000 USD;
- Për nën-sektorin e bakrit, të gjitha shoqëritë që operojnë në këtë sektor;
- Për nën-sektorin e nikelit, të gjitha shoqëritë me të ardhura vjetore >300,000 USD;
- Për nën sektorin e bitumit ose rërës së bitumit të gjitha shoqëritë me të ardhura vjetore >320,000 USD;

- Për nënsektorin e gurit gëlqeror të gjitha shoqëritë me të ardhura vjetore> 250,000 USD;
- Për nënsektorin e argjilës të gjitha shoqëritë me të ardhura vjetore> 260,000 USD;
- Për nënsektorin e gips alabastrës të gjitha shoqëritë me të ardhura vjetore> 650,000 USD;
- Për nënsektorin e gurit gëlqeror të gjitha shoqëritë me të ardhura vjetore >180,000 USD;

Përzgjedhja përfshinte 120 subjekte raportuese për vitin 2016, dhe lista e përzgjedhur e subjekteve në sektorin e minerar paraqitet në Shtojcën 2).

Nuk pati raportime të pagesave të konsiderueshme lidhur me koncesionet minerare në vitin 2016.

Përzgjedhja mbulon mbi 80% të vlerës së përllogaritur të prodhimit minerar për vitin 2016. Megjithatë, kjo analizë është e kufizuar për shkak se informacioni i dhënë nga AKBN për prodhimin minerar për vitin 2016 nuk përfshin detaje të cilësisë së mineraleve (përqëndrimi). Në këto rrethana, prodhimi minerar nuk mund të vlerësohet duke përdorur çmimet ndërkombëtare të mineraleve. Krahas kësaj, siç shpjegohet në seksionin 4.1, AKBN njofton se të dhënat e raportuara të prodhimit bazohen në vetë-deklarimet e dorëzuara nga të licencuarit. AKBN nuk ka kryer verifikime të mëtejshme për të konfirmuar sasinë e prodhimit të nxjerrë.

8.3 Përzgjedhja e pagesave dhe shoqërive raportuese në sektorin e hidro-energjisë

MSG vendosi të përfshijë sektorin hidro-energjetik në kuadrin e raportimit EITI duke filluar nga viti 2013. Për të vlerësuar rëndësinë e sektorit dhe pagesat kryesore nga sektori, MSG kontraktoi Deloitte Audit Albania Sh.p.k në 11 Shkurt 2015 "Për të kryer një studim për vlerësimin e kontributit të sektorit të hidro-energjisë për ekonominë Shqiptare dhe përfshirjen e tij në kuadrin të raporteve EITI".

Studimi solli faktet kryesore lidhur me:

- Pjesëmarrjen e Shtetit në sektor, flukset kryesore të pagesave dhe marrëdhëniet midis Shtetit dhe shoqërive shtetërore;
- Pagesat e gjeneruara nga shoqëritë në sektor në fazën e prodhimit dhe para-prodhimit bazuar në ligjin dhe rregulloret në fuqi; dhe
- Kufirin për përzgjedhjen e pagesave materiale (me peshë në totalin e të ardhurave nga sektori)

Studimi zbuloi se flukset materiale paguhen kryesisht nga shoqëritë në fazën e prodhimit, ndërsa KESH, prodhuesi shtetëror i energjisë kontribuon me pjesën më të madhe të pagesave. MSG përzgjodhi për raportim 12 prodhuesit më të mëdhenj të hidro-energjisë, duke përfshirë KESH, të cilët gjeneronin 90% të prodhimit në vitin 2016. Lista e subjekteve të përzgjedhura raportuese është paraqitur në Shtojcën 3.





Pagesat e përzgjedhura për rakordim në sektorin e hidro-energjisë përfshijnë:

1. *Tarifa koncesionare*, të cilat paguhen në përputhje me marrëveshjen koncesionare bazuar në prodhimin vjetor të gjeneruar nga shoqëritë që operojnë në HEC-t me koncesion;
2. *Pagesat me natyrë tatimore* të tilla si renta minerare, tatimi mbi fitimin dhe tatimi mbi dividentët të cilat lidhen direkt me aktivitetin në sektor. Përveç këtyre pagesave, MSG vendosi të përfshijë edhe pagesat për gjobat tatimore, pagesat për sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore, dhe tatimin mbi të ardhurat personale dhe TVSH pasi

këto kanë treguar një rrjedhë të konsiderueshme pagesash në Buxhetin e Shtetit në vitet e mëparshme;
3. *Investimet dhe pagesat e tjera të kryera nga KESH ndaj Shtetit* në cilësinë e aksionerit të saj;
4. *Shoqëritë e përzgjedhura në sektorin e hidro-energjisë* u udhëzuan të raportonin detaje për pagesa të tjera materiale për shtetin që tejkalojnë vlerën 50,000 USD dhe për NjQV-të, mbi 5,000 USD.

8.4 Kufizime të tjera në analizën e pagesave të rëndësishme

Sistemet e administrimit të informacionit të Qeverisë nuk mund të raportonin informacion të veçantë për të ardhurat e gjeneruara nga çdo sektor sipas flukseve të të ardhurave. Ne kuptojmë që të ardhurat dhe shpenzimet e Qeverisë janë regjistruar në sistemin e administrimit të parasë: Sistemi i Thesarit. Ky sistem mund të japë informacion të përmuajshëm mbi të ardhurat e gjeneruara nga çdo taksë. Megjithatë, nuk mund të identifikojë dhe të regjistrojë veçmas të ardhurat sipas taksave të gjeneruara nga sektori nxjerrës i naftës dhe gazit, sektori minerar dhe i hidro-energjisë.

Në mungesë të këtij informacioni, MSG nuk mund të marrë informacion të saktë dhe të plotë nga sistemet e informacionit të Qeverisë mbi totalin e të ardhurave të krijuara për secilin sektor, pra ai i naftës dhe gazit, sektori minerar dhe i hidro-energjisë.

Përveç kësaj, sistemet e informacionit të Qeverisë nuk mund të prodhojnë informacion mbi të ardhurat e përgjithshme të paguara nga çdo licencë individuale për shkak të arsyeve të mëposhtme:

1. Shoqëritë mund të kenë një ose më shumë licenca, megjithatë nuk i kontabilizojnë taksat dhe pagesat veçmas për çdo licencë individuale, por për të gjithë biznesin i cili vepron me një numër unik të identifikimit tatimor (NUIS). Për këtë arsye, sistemet e informacionit të Qeverisë mund të nxjerrin të dhëna për tatimet e paguara nga një NUIS, por jo për taksat e paguara nga çdo licencë;

2. Çdo institucion publik që mbledh të ardhura, mban sistemin e tij kontabël për regjistrimin dhe administrimin e pagesave të bëra nga secili NUIS. Më konkretisht, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Administrata Doganore Shqiptare, Drejtorite e Taksave vendore, Ministritë dhe subjektet e tjera publike, të cilat mbledhin të ardhura mbajnë të dhënat e tyre për të ardhurat e përllogaritura dhe pagesat e bëra nga çdo NUIS, por ky informacion nuk konsolidohet në sistemin e informacionit të Qeverisë për të siguruar infromacion për të ardhurat e mbledhura nga çdo NUIS individualisht. Prandaj, MSG nuk mund të marrë informacion për të ardhurat e përgjithshme të paguara nga çdo shoqëri e licencuar në një vit fiskal me qëllim identifikimin e subjekteve me flukse të konsiderueshme pagese.

Për më tepër, edhe vete sistemet e administrimit të pagesave dhe kontabilitetit të mbajtura veçmas nga çdo subjekt publik (duke përfshirë edhe organet tatimore) nuk mund të japin informacion të ndarë për të ardhurat nga sektori i naftës dhe gazit, sektori minerar dhe i hidro-energjisë. Ne kuptojmë se klasifikimi i sektorëve në sistemet e tyre të administrimit nuk është i programuar në mënyrë që të përfshijë të licencuarit që operojnë në sektorin e nxjerrjes dhe përpunimit të naftës dhe gazit, minerar dhe sektorin e hidro-energjisë. Prandaj, MSG-të nuk mund të marrin informacion të saktë dhe të plotë për totalin e të ardhurave të gjeneruara nga secili sektor më vete në total dhe sipas llojit të pagesës apo taksës.

9. Qasja, metodologjia dhe puna e kryer

Shoqëritë dhe njësitë qeveritare duhet të raportojnë taksat dhe të ardhurat materiale. MSG përcakton pagesat dhe shoqëritë që duhet të përfshihen në raportim, bazuar në të ardhurat e konsiderueshme që rrjedhin në Buxhetin e Shtetit nga sektori nxjerrës dhe hidro-energjisë.

Ne e kryem punën tonë në përputhje me kushtet e përcaktuara në kontratën datë 18 korrik 2016 ("Kontrata jonë e Angazhimit"). Qëllimi i angazhimit tonë ishte përpilimi i raportit EITI për vitet 2015 dhe 2016 në përputhje me standardin EITI publikuar, dhe ndryshuar në shkurt 2016.



Në përputhje me qëllimin tonë të punës kemi listuar procedurat në vijim:

1. **Mbledhja e informacionit të nevojshëm kontekstual në përputhje me kërkesat në vijim:**
    a. Përshkrimi i kuadrit ligjor dhe regjimit fiskal që rregullon industrinë nxjerrëse (Kërkesa 2);
    b. Paraqitja e pamjes së përgjithshme të industrisë nxjerrëse, duke përfshirë edhe çdo aktivitet të rëndësishëm në kërkim-zbulim (Kërkesa 3);
    c. Kontributi i industrive nxjerrëse në ekonomi për vitet fiskale të mbuluara nga raporti EITI (Kërkesa 6) deri ku mundësohet nga analizat dhe informacionet e publikuara nga Instituti Shqiptar i Statistikave;
    d. Të dhënat për prodhimin në vitet fiskale mbuluar nga raporti EITI (Kërkesa 3);
    e. Informacion në lidhje me pjesëmarrjen e Shtetit në industrinë nxjerrëse dhe në sektorin hidro-energjetik (Kërkesa 4);
    f. Shpërndarja e të ardhurave në industrinë nxjerrëse (Kërkesa 5);
    g. Informacion për regjistrin e të licencuarve dhe procesi për dhënien e licencave (Kërkesa 2);
    h. Një përshkrim kompakt i hapave dhe udhëzimeve të licencimit, kërkesave dhe institucionet e përfshira për secilën prej industrive të analizuara në këtë raport;
    i. Çdo informacion i kërkuar nga MSG mbi strukturën dhe analizën për gjithë zinxhirin e pronësisë së shoqërive të licencuara deri tek përfituesi final i të adhurave (Kërkesa 2);
    j. Çdo informacion i kërkuar nga MSG për kontratat (Kërkesa 3).

Procesi dhe qasja për mbledhjen dhe analizën e informacionit kontekstual

Ne kryem një vlerësim paraprak dhe analizë të informacionit kontekstual të mëposhtëm:

- Ligjet dhe rregulloret e zbatuara, duke përfshirë edhe marrëveshjet e qeverisjes dhe politikat tatimore;
- Konkluzionet dhe rekomandimet nga raportet e mëparshme në raportet EITI duke përfshirë edhe komentet nga procesi fillestar i validimit.
- Faktet dhe procedurat e publikuara në faqet e internetit të:
- Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë - www.energjia.gov.al,
- Ministrisë së Financave - www.financa.gov.al/;
- Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë - www.ekonomia.gov.al/;
- Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve – www.tatime.gov.al;
- Administratës Doganore Shqiptare – www.dogana.gov.al;
- AKBN-së – www.akbn.gov.al/
- Albpetrol-it – www.albpetrol.al/;
- Institutit Shqiptar të Statistikave – www.instat.gov.al/;
- Entit Rregullator të Energjisë – www.ere.gov.al/;
- KESH – www.kesh.al/;
- OSHEE – www.oshee.al/;
- OST – www.ost.al; and
- Shoqëritë më të mëdha që operojnë në sektorin privat të naftës dhe gazit, sektorin minerar dhe të hidro-energjisë: www.bankerspetroleum.com; www.albchrome.al; www.beralb.com; www.devollhydropower.al; www.energji-ashta.al etc.

Bazuar në përmbledhjen paraprake dhe analizën e informacionit kontekstual hartuam format e raportimit për të mbledhur informacionin i cili nuk ishte publik / i aksesueshëm në faqet e internetit të institucioneve qeveritare në korrik 2017.

Subjektet publike dorëzuan raportimin e informacionit kontekstual përmes emailit nga muaji gusht deri në shkurt 2018. Ne mblodhëm, analizuam dhe konfirmuam nëpërmjet pyetjeve informacionin e marrë nga institucionet publike.

Ne identifikuam dhe analizuam kufizimet dhe pengesat lidhur me analizën dhe publikimin e informacionit kontekstual në raport, nëse ishte e nevojshme.

Kufizime dhe limitime

Puna jonë në bazë të informacionit kontekstual është kufizuar në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave të paraqitura në këtë studim, në përputhje me termat e referencës, pjesë integrale e kontratës sonë. Puna jonë nuk përfshin dhënien e sigurisë apo rakordimin e të dhënave dhe informacionit kontekstual paraqitur në këtë studim. Të gjitha burimet e informacionit janë të referuara qartë në të gjithë studimin.



2. Qasja për mbledhjen dhe rakordimin e pagesave

Në përputhje me rolin e Administratorit të përcaktuar në standardin EITI dhe termat e referencës që ishin pjesë integrale e kontratës sonë së angazhimit, për rakordimin e pagesave të konsiderueshme, ne:

- Rishikuam kufijtë e materialitetit, subjektet dhe pagesat e përzgjedhura për raportim nga Grupi Shqiptar i Punës. Komentuam, sipas rastit, për kufizimet e të dhënave të përdorura në përcaktimin e materialitetit dhe përzgjedhjen për rakordim;
- Bazuar në pagesat e përzgjedhura për rakordim nga Grupi Shqiptar i Punës për EITIn, hartuam formularët draft të raportimit për rishikim dhe miratim nga Sekretariati i EITI-t në Shqipëri dhe Grupi Shqiptar i Punës;
- Dhamë udhëzimet dhe sqarimet për procesin e rakordimit si dhe për përpilimin dhe dorëzimin e raportimit nga shoqëritë që operojnë në sektorin e naftës dhe gazit, sektorin minerar dhe sektorin e hidro-energjisë;
- Shpërndamë formularët dhe instruksionet për raportim me email të gjitha shoqërive të përzgjedhura për raportim. Në shumicën e rasteve, informacioni i marrë për shoqëritë e përzgjedhura si NUIS, personat dhe të dhënat e kontaktit (email, numër telefoni), adresat, etj. ishtin të gabuara. Kjo e vështirësoi procesin e mbledhjes dhe krahasimit të pagesave duke e shtyrë atë përtej afateve të përcaktuara;
- Mblodhëm të dhënat për pagesat e raportuara nga institucionet publike dhe shoqëritë e licencuara dhe ndërtuam bazën për krahasimin e detajuar të pagesave. Institucionet publike dhe shoqëritë e licencuara e dorëzuan raportimin e tyre elektronik me email nga data 11 nëntori në 13 shkurt 2018, ndjeshëm përtej afatit të përcaktuar për raportim më 30 shtator 2017;
- Informuam në mënyre të vazhdueshme ALBEITI-in për statusin e raportimit të institucioneve publike dhe shoqërive të licencuara, në mënyrë që të siguronim bashkëpunimin maksimal të subjekteve raportuese në kohën e përcaktuar në kontratën tonë të angazhimit;
- Krahasuam shumat e raportuara nga institucionet publike me shumat e raportuara nga shoqëritë e licencuara, për të identifikuar ndonjë mospërputhje midis të ardhurave të raportuara nga institucionet publike dhe pagesave të raportuara nga të licencuarit;
- Kontaktuam institucionet publike dhe shoqëritë e licencuara për të sqaruar arsyen e mospërputhjeve. Për shkak të vonesave të konsiderueshme në raportim nga të dyja palët, procesi i hetimit dhe sqarimit të mospërputhjeve u zgjat deri në shkurt 2018;
- Rakorduam dhe krahasuam pagesat përkundrejt informacioneve të tjera të publikuara, duke përfshirë llogaritë e Buxhetit të Shtetit, kur informacioni ishte mjaftueshëm i detajuar për të mundësuar krahasimin;
- Përgatitëm draftin e raportit duke përmbledhur rezultatet e punës dhe mësimet e nxjerra, dhe rekomandimet për përmirësime si dhe përditësimin mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve të viteve të mëparshme;
- Komentuam për kufizimet dhe barrierat e identifikuara gjatë procesit, nëse ishte e nevojshme,
- Mblodhëm dhe pasqyruam në raportin tone komentet nga grupet e interesit dhe dorëzuam raportit përfundimtar.

Figura 13 në vijim përmbledh procesin e rakordimit dhe raportimit.

Figura 13 – Procesi i rakordimit



Ne morëm pasqyrat financiare të Albpetrol dhe KESH, por për arsye se këto shoqëri mbledhin pagesa në natyrë dhe jo në para ne nuk mundëm të krahasonim drejtëpërdrejtë informacionin për pagesat e raportuara nga shoqëritë e licencura me informacionin e paraqitur në pasqyrat financiare të audituara të Albpetrol-it dhe KESH-it për vitin 2016. Ne kërkuam pasqyrat financiare të audituara të AKBN-së, por nuk i morëm deri në datën e këtij raporti.

Ne kërkuam nga shoqëritë e licencuara konfirmime nga audituesit e jashtëm që informacioni i raportuar është i plotë dhe në përputhje me pasqyrat e tyre financiare të audituara, por arritëm të merrnim vetëm disa letra konfirmimi (respektivisht 17 nga 121). Ne kuptojmë që kjo kërkesë ka kosto shtesë për shoqëritë, sidomos në rastet që procesi i auditimit të pasqyrave financiare ka përfunduar. Prandaj, rekomandojmë që MSG të kërkojë që letra e konfirmimit të integrohen në programin e përvitshëm të punës së auditimit të shoqërisë dhe të sigurohet që të gjitha njësitë raportuese të auditohen, pavarsisht formës së tyre legale.

Deri në datën e këtij raporti, 102 nga 141 shoqëri të përzgjedhura raportuan flukset e paguara ndaj Shetit. Ndër këto, vetëm 58 shoqëri dorëzuan raportimin zyrtar e të nënshkruar nga administratori i shoqërisë.

Meqënëse llogaritë vjetore të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Administratës Doganore Shqiptare nuk ofrojnë informacione të detajuara për të ardhurat e mbledhura nga sektori i naftës dhe gazit, minerar dhe ai i hidro-energjisë, ne nuk mund të krahasonim informacionin e përfshirë në këtë raport me atë të llogarive vjetore të publikuara nga institucionet.

Standardi EITI nuk ka materialitet për shpjegimin e mospërputhjeve. Si rrjedhojë, të gjitha devijimet duhet të shpjegohen panvarësisht nga materialiteti i tyre. Në rast mospërputhjesh, ne kontaktuam shoqëritë e licencuara dhe institucionet publike për sqarime të mëtejshme.

Për shkak se llogaritë e të ardhurave në Buxhetin e Shtetit nuk paraqiten të ndara sipas industrive, nuk mundëm të krahasonim flukset e raportuara nga kjo industri me llogaritë e publikuara të Buxhetit të Shtetit në vitin 2016.

Ky proces nuk konfirmon që nuk ka patur pagesa të tjera që i janë bërë Shtetit përveç atyre të raportuara, duke qenë se këto shuma mund të mos jenë raportuar nga të licencuarit dhe institucionet shtetërore njëkohësisht.

Rregullorja aktuale e EITI nuk kërkon që ne të kryenim testime të detajuara për të zbuluar nëse ka shuma të paraportuara; dhe zbulimi i shumave të paraportuara do të ishte i vështirë edhe nëpërmjet testimit të detajuar të të gjitha shoqërive të licencuara.

Rezultati i procedurave tona paraqitet në kapitullin 10.



Në përfundim të procesit, në mënyrë që të theksonim faktet kryesore dhe të paraqisnim një informacion lehtësisht të kuptueshëm, përmblodhëm gjetjet dhe faktet kryesore të procesit në një përmbledhje ekzekutive në seksionin 2.1 dhe përmblodhëm rezultatet e rakordimit në kapitullin 10.

10. Rezultatet e rakordimit

Ky kapitull paraqet rakordimin e flukseve të pagesave nga të licencuarit në sektorin e naftës dhe gazit, të licencuarit e përzgjedhur në sektorin minerar dhe shoqëritë hidro-energjetike të përzgjedhura, si dhe rakordimi i pagesave të kryera nga Albpetrol në Buxhetin e Shtetit.

Tabela e mëposhtme paraqet rezultatet e rakordimit për vitin 2016:

Tabela 22 – Rezultatet e rakordimit për vitin 2016

Shumat në mijë Lek

Fluksi i të ardhurave	Shuma e Paguesit	Shuma e Arkëtuesit	Mospërputhja e shpjeguar		Raportimi i korrigjuar		Mospërputhja e pashpjeguar	
			Paguesi	Arkëtuesi	Paguesi	Arkëtuesi	Pa-identifikuar	Pa-kundërparti
Sektori i naftës dhe gazit	7,262,967	7,107,077	4,547	-	7,267,514	7,107,077	63,708	96,728
Sektori Minerar	3,430,665	3,901,967	4,585	7,201	3,435,250	3,909,168	(730,879)	256,961
Sektori i hidro-energjisë	2,820,163	2,938,945	-	-	2,820,163	2,938,945	30,557	(149,339)
Total	**13,513,795**	**13,947,989**	**9,132**	**7,201**	**13,522,927**	**13,955,190**	**(636,614)**	**204,350**

10.1 Përmbledhja e rakordimit të pagesave nga sektori naftës dhe gazit

Në total, 9 shoqëri hidrokarbure duhet të raportonin pagesat e bëra në Buxhetin e Shtetit në vitin 2016, përkatësisht 6 të licencuar në prodhim dhe 4 në kërkim. Bankers Petroleum zotëron njëkohësisht licencë në prodhim dhe në kërkim. Ne morëm deklarime nga të gjitha shoqëritë e naftës dhe Albpetrol.

Tabela më poshtë paraqet një përmbledhje të pagesave të raportuara nga shoqëritë hidrokarbure.

Tabela 23 - Përmbledhja e rakordimit të pagesave nga sektori i naftës dhe gazit në vitin 2016
Shumat në mijë Lek

Pagesat totale	Raportimi Fillestar	Mospërputhja e shpjeguar		Shuma e Rregulluar	Pa-kundërp arti
		Paguesi	Arkëtuesi		
Të licencuarit	7,262,967	4,547	-	7,267,514	-
Qeveria	7,107,077	-	-	7,107,077	63,708
Diferenca	**155,890**	**4,547**	-	**160,437**	**(63,708)**

Shoqëritë e licencuara raportuan fillimisht pagesa ndaj Shtetit në shumën 7,262,967 mijë Lek, të cilat ishin 155,890 mijë Lek më të larta se pagesat e raportuara nga Shteti për këto shoqëri.

Mospërputhja prej 4,547 mijë Lek u shpjegua nëpërmjet punës rakorduese. Një përmbledhje e mospërputhjeve të hasura është paraqitur më poshtë në rakordimin sipas llojit të të ardhurave.

Kolona "pa kundërparti", përfshin shuma të raportuara në mënyrë të njëanshme nga Qeveria, për shoqëritë e përmendura më sipër, të cilat nuk raportuan deri në datën e publikimit të këtij Raporti dhe anasjelltas.

Rakordimi i pagesave nga sektori i naftës dhe gazit sipas llojit të të ardhurave

Tabela 24 - Përmbledhja e rakordimit të pagesave nga sektori i naftës dhe gazit – sipas llojit të të ardhurave
Shumat në mijë Lek

Të ardhurat nga pagesat kryesore	Shuma e paguesit	Shuma e Arkëtuesit	Mospërputhja e shpjeguar		Mospërputhja e pashpjeguar	
			Paguesi	Arkëtuesi	Pa-identifikuar	Pa-kundërparti
Bonuset - AKBN	60,082	60,078	-	-	4	-
Bonuset - Albpetrol	22,858	14,481	-	-	8,377	-
Pagesa të tjera- NJQV	171,550	141,646	-	-	(41)	29,945
Pagesa të tjera- Shteti	966,286	887,985	-	-	44,935	33,366
Pagesat për Sigurime & TAP	1,401,252	1,390,091	1,118	-	12,279	-
Renta Minerare - eksport	1,925,844	1,928,613	-	-	(2,769)	-
Renta Minerare – shitje Brenda vendit	342,273	341,050	1,082	-	2,304	-
Ndarja e Prodhimit	1,029,637	1,029,637	-	-	-	-
Tatimi mbi Fitimin	928,206	914,581	250	-	13,795	80
Penalitetet Tatimore	212,985	159,429	-	-	53,240	316
TVSH	201,994	239,487	2,098	-	(35,395)	-
Total	**7,262,967**	**7,107,077**	**4,547**	**-**	**96,728**	**63,708**

Renta minerare përbënte fluksin kryesor të të ardhurave në Buxhetin e Shtetit nga sektori i naftës dhe gazit me rreth 31% të totalit të pagesave. Renta e paguar në doganë për eksportet ishte rreth 27% e totalit të

pagesave raportuar nga sektori i naftës dhe gazit për vitin 2016, i cili lidhet ngushtë me trendin e eksportit të naftës së papërpunuar. Pagesat për Sigurime dhe TAP përbënin fluksin e dytë më të madh të raportuar në vitin 2016, me rreth 19% të totalit të pagesave të raportuara më sipër. Kontribuesi më i madh ishte Bankers Petroleum, të ardhurat e të cilit përbëjnë 70% të totalit.

Çështje të tjera të lidhura me raportimin

Deri në datën e këtij raporti, vetëm 4 nga 9 të licencuar dorëzuan formularët e nënshkruar dhe autorizimin për publikimin e të dhënave, përkrah raportimit elektronik të dërguar fillimisht me postë elektronike. Në mënyrë që të rritet informimi, ne i kërkuam shoqërive jo raportuese për të informuar nëse nuk ishin dakord me publikimin analitik të flukseve.

Të gjitha shoqëritë e naftës ishin dakort për të publikuar në mënyrë analitike të gjitha flukset, kështu që të gjitha flukset e raportuara janë paraqitur në baza të shpërndara sipas subjektit raportues dhe fluksit të pagesave.

Mospërputhjet kryesore nga rakordimi

Në total, 2 shoqëri nafte korigjuan raportimin e tyre fillestar, ndërsa Institucionet Qeveritare nuk kanë bërë korigjime në raportimin e tyre fillestar. Mospërputhjet e identifikuara në 35 raste u shpjeguan nëpërmjet rakordimit. Ka ende 32 raste mospërputhjesh të pazgjidhura deri në datën e këtij raporti, mospërputhjet në vlerën 160,437 mijë Lek mbetën të pazgjidhura.

Arsyet kryesore dhe shpjegimet për mospërputhjet e zgjidhura mund të përmblidhen si më poshtë:

- Raportim jo i plotë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për disa shuma. Për këto raste, të licensuarit raportuan dokumente pagesat duke treguar Shoqëritë përfituese;
- Në disa raste, të licencuarit fillimisht nuk raportuan pagesa të cilat ishin deklaruar nga autoritetet tatimore;
- Në disa raste palët raportuan shuma apo detyrime të përllogaritura në vend të pagesës;
- Supozime të ndryshme të përdorura për konvertimin e sasisë nga fuçi në ton;
- Në shumë raste, të licencuarit dhe autoritetet tatimore raportuan taksa qe nuk ishin pjesë e punës rakorduese;
- Shumë nga të licencuarit ngatërruan pagesat për taksa të ndryshme ose penalitetet e paguara;
- Të licencuarit raportuan depozitimin për rentën minerare në vend të rentës së paguar në momentin e eksportit në llogari të doganës(*).

(*) Në rastin e eksporteve shoqëritë depozitojnë një parapagim për rentën minerare në llogari të doganës. Renta mbahet nga kjo depozitë në datën e eksportit dhe përpara kësaj date parapagimi i depozituar i përket të licencuarit. Për këtë arsye, parapagimet e rentës nuk konsiderohen si të ardhura deri sa pagesa e rentës të ekzekutohet në momentin e eksportit.

Një pamje e detajuar për çdo shoqëri është paraqitur në Shtojcën 1.

Pagesat Sociale

Shoqëritë e naftës nuk raportuan ndonjë pagesë të detyrueshme ose vullnetare si pagesa sociale për vitin 2016.

10.2 Rakordimi i pagesave të bëra për buxhetin e shtetit nga sektori minerar

Në total, 120 shoqëri minerare duhet të raportonin pagesat e bëra në Buxhetin e Shtetit, ku 3 shoqëri ishin të licencuar edhe në kërkim.

Ne morëm deklarime për 81 nga 120 shoqëri minerare. Shoqëritë që nuk raportuan deri në datën e këtij raporti ishin 39, të cilat janë detajuar në Shtojcën 2.

Tabela më poshtë paraqet një përmbledhje të pagesave të raportuara nga shoqëritë minerare.

Tabela 25 - Përmbledhja e rakordimit të pagesave nga sektori minerar

Shumat në mijë Lek

Pagesat totale	Raportimi Fillestar	Mospërputhja e shpjeguar		Shuma e Rregulluar	Pa-kundërparti
		Paguesi	Arkëtuesi		
Të licencuarit	3,421,746	5,525	-	3,427,271	(88,971)
Qeveria	3,901,967	-	7,201	3,909,168	(649,887)
Diferenca	**(480,221)**	**5,525**	**7,201**	**(481,897)**	**(738,858)**

Shoqëritë e licencuara raportuan fillimisht pagesa ndaj Shtetit në shumën 3,421,746 mijë Lek, të cilat ishin 480,221 mijë Lek më pak se pagesat e raportuara nga Shteti për këto shoqëri.

Mospërputhjet prej 5,525 mijë Lek dhe 7,201 mijë Lek u shpjeguan nëpërmjet punës rakorduese. Një përmbledhje e mospërputhjeve të hasura është paraqitur më poshtë në rakordimin sipas llojit të të ardhurave.

Kolona "pa kundërparti", përfshin shuma të raportuara në mënyrë të njëanshme nga Shteti, për shoqëritë e përmendura më sipër që nuk raportuan deri në datën e këtij Raporti dhe anasjelltas.

Rakordimi i pagesave nga sektori minerar sipas llojit të të ardhurave

Tabela 26 - Përmbledhja e rakordimit të pagesave nga sektori minerar – sipas llojit të të ardhurave

Shumat në mijë Lek

Të ardhurat nga pagesat kryesore	Shuma e paguesit	Shuma e Arkëtuesit	Mospërputhja e shpjeguar		Mospërputhja e pashpjeguar	
			Paguesi	Arkëtuesi	Pa-identifikuar	Pa-kundërparti
Pagsat për sigurime & TAP	1,180,592	1,302,323	(67)	-	8,178	(129,976)
Tatimi mbi fitimin	603,338	733,309	(39)	186	11,647	(141,844)
TVSH	496,555	714,088	24	-	125,102	(342,611)
Renta minerare - Eksport	467,608	600,988	4,523	5,256	5,827	(139,940)
Pagesa te tjera - Shteti	300,151	250,702	-	-	39,668	9,781
Renta minerare – shitje brenda vendit	172,927	180,277	1,116	1,758	4,528	(12,520)
Pagesa te tjera - NJQV	86,889	68,713	-	-	19,219	(1,043)
Tatimi mbi Dividentin	84,177	44,813	-	-	27,889	11,475
Penalitetet Tatimore	29,508	6,753	(32)	-	14,903	7,820
Total	**3,421,745**	**3,901,966**	**5,525**	**7,200**	**256,961**	**(738,858)**

Pagesat për sigurimet sociale dhe shëndetsore, Tatimi mbi fitimin dhe Renta minerare përbënin përkatësisht 35%, 18% dhe 19% të pagesave të raportuara nga sektori minerar. Kontributi nga prodhuesit më të mëdhenj të kromit dhe gurit gëlqeror përbëjnë së bashku 43% të pagesave totale të

raportuara nga sektori minerar. Këto tre shoqëri ishin përkatësisht Albchrome (krom) me kontribut 20%, Fushë-Kruja Cement (gur gëlqeror) me 6% dhe Antea Cement (gur gëlqeror) me 17%.

Çështje të tjera të lidhura me raportimin

Deri në datën e këtij raporti, vetëm 46 nga 81 të licencuar dorëzuan formularët e nënshkruar dhe autorizimin për publikimin e të dhënave, përkrah raportimit elektronik të dërguar në fillim me postë elektronike. Në mënyrë që të rritet informimi, ne i kërkuam shoqërive jo raportuese për të informuar nëse nuk ishin dakord me publikimin analitik të flukseve.

Tre shoqëri minerare, duke përfshirë Alb Lea International, Salillari, Xhireton, nuk ishin dakort për të publikuar në mënyrë analitike flukset e raportuara, kështu që flukset e raportuara nga ana e tyre janë paraqitur në një bazë të përmbledhur.

Të gjitha shoqëritë hidro-energjitike ranë dakort për publikimin analitik të flukseve, kështu që të githa flukset e raportuara janë paraqitur në mënyrë të zbërthyer, sipas njësive dhe pagesave.

Mospërputhjet kryesore nga rakordimi

Mospërputhjet e identifikuara në 10 raste u shpjeguan nëpërmjet rakordimit. Ka ende 300 raste mospërputhjesh të pazgjidhura deri në datën e këtij raporti, që arrijnë në vlerën 256,961 mijë Lek .

Arsyet kryesore dhe shpjegimet për mospërputhjet e zgjidhura mund të përmblidhen si më poshtë:

- Raportim jo i plotë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për disa shuma. Për këto raste, të licensuarit raportuan dokumente pagesat duke treguar Shoqëritë përfituese;
- Në disa raste, të licencuarit fillimisht nuk raportuan pagesa të cilat ishin deklaruar nga autoritetet tatimore;
- Në disa raste palët raportuan shuma apo detyrime të përllogaritura në vend të pagesës;
- Në shumë raste, të licencuarit dhe autoritetet tatimore raportuan taksa qe nuk ishin pjesë e punës rakorduese;
- Shumë nga të licencuarit ngatërruan pagesat për taksa të ndryshme ose penalitetet e paguara;
- Të licencuarit raportuan depozitimin për rentën minerare në vend të rentës së paguar në momentin e eksportit në llogari të doganës(*).

(*) Në rastin e eksporteve shoqëritë depozitojnë një parapagim për rentën minerare në llogari të doganës. Renta mbahet nga kjo depozitë në datën e eksportit dhe përpara kësaj date parapagimi i depozituar i përket të licencuarit. Për këtë arsye, parapagimet e rentës nuk konsiderohen si të ardhura deri sa pagesa e rentës të ekzekutohet në momentin e eksportit.

Një pamje e detajuar për çdo shoqëri është paraqitur në Shtojcën 2.

Pagesat Sociale

Trade Minerals Al raportoi se ka bërë pagesa sociale vullnetare në vlerë prej 282,620 lekë për Bashkinë e Tiranës dhe Kukësit.

Asnjë nga shoqëritë e tjera të përzgjedhura minerare nuk raportuan ndonjë pagesë të detyrueshme ose vullnetare si pagesa sociale për vitin 2016.

10.3 Përmbledhja e rakordimit të pagesave nga sektori hidro-energjisë

Në total, 12 shoqëri hidro-energjetike, përfshirë KESH, që përbëjnë prodhuesit më të mëdhenj të energjisë duhet të raportonin pagesat e bëra në Buxhetin e Shtetit, duke kontribuar në 90% të prodhimit vendas në vitin 2016.

Tabela më poshtë paraqet një përmbledhje të pagesave të raportuara nga shoqëritë hidro-energjetike.

Tabela 27 - Përmbledhja e rakordimit të pagesave nga sektori i hidro-energjisë në vitin 2016

Shumat në mijë Lek

Pagesat totale	Raportimi Fillestar	Mospërputhja e shpjeguar		Shuma e Rregulluar	Pa-kundërparti
		Paguesi	Arkëtuesi		
Të licencuarit	2,820,163	-	-	2,820,163	30,557
Qeveria	2,938,945	-	-	2,938,945	-
Diferenca	**(118,782)**			**(118,782)**	**30,557**

Shoqëritë e licencuara raportuan fillimisht pagesa ndaj Shtetit në shumën 2,820,163 mijë Lek, të cilat ishin 118,782 mijë Lek më pak se pagesat e raportuara nga Shteti për këto shoqëri.

Mospërputhjet nuk janë shpjeguar nëpërmjet procesit të rakordimit. Një përmbledhje e mospërputhjeve të hasura është paraqitur më poshtë në rakordimin sipas llojit të të ardhurave.

Kolona "pa kundërparti", përfshin shuma të raportuara në mënyrë të njëanshme nga Shteti, për shoqëritë e përmendura më sipër që nuk raportuan deri në datën e këtij Raporti dhe anasjelltas.

Rakordimi i pagesave nga sektori i hidro-energjisë sipas llojit të të ardhurave

Tabela 28 - Përmbledhja e rakordimit të pagesave nga sektori i hidro-energjisë sipas llojit të të ardhurave

Shumat në mijë Lek

Të ardhurat nga pagesat kryesore	Shuma e paguesit	Shuma e Arkëtuesit	Mospërputhja e shpjeguar		Mospërputhja e pashpjeguar	
			Paguesi	Arkëtuesi	Pa-identifikuar	Pa-kundërparti
Tarifa Koncesionare	82,331	215,454	-	-	(147,141)	14,018
Pagesa të tjera - NJQV	10,163	-	-	-	-	10,163
Pagesa të tjera- Shtetit	53,960	53,984	-	-	(24)	-
Pagesat për Sig SHSH dhe TAP	711,642	713,722	-	-	(2,079)	-
Tarifa Rregulluese	6,124	-	-	-	-	6,124
Tatimi mbi fitimin	974,121	971,640	-	-	2,482	-
Penalitete tatimore	14,217	4,327	-	-	9,639	252
TVSH	967,604	979,819	-	-	(12,215)	-
Total	**2,820,163**	**2,938,945**	**-**	**-**	**(149,338)**	**30,557**

Tatimi mbi fitimin, TVSH dhe pagesat për sigurime sociale dhe shëndetsore përbënin përkatësisht 35% dhe 34% dhe 25% të pagesave të raportuara nga sektori i hidro-energjisë në vitin 2016. KESH dhe Energji Ashta ishin kontribuesit kryesorë të pagesave me rreth 41% dhe 15% të totalit të pagesave të treguara më sipër.

Çështje të tjera të lidhura me raportimin

Deri në datën e këtij raporti, vetëm 8 nga 12 të licencuar dorëzuan formularët e nënshkruar dhe autorizimin për publikimin e të dhënave, përkrah raportimit elektronik të dërguar në fillim me postë elektronike.

Mospërputhjet kryesore nga rakordimi

Edhe shoqëritë e licencuara edhe institucionet shtetërore nuk kanë bërë ndryshime në raportimin e tyre fillestar. Ka ende 49 raste mospërputhjesh të pazgjidhura deri në datën e këtij raporti, që arrijnë në vlerën 135,265 mijë Lek.

Arsyet kryesore dhe shpjegimet për mospërputhjet e zgjidhura mund të përmblidhen si më poshtë:

- Pagesat për tatimin mbi fitimin janë paraqitur me balancën e TVSH-së së arkëtueshmë dhe rezultuan në flukse neto më të ulëta ose zero;
- Në disa raste palët raportuan shuma apo detyrime të përllogaritura në vend të pagesës;
- Raportim jo i plotë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për disa shuma. Për këto raste, të licensuarit raportuan dokumente pagesat duke treguar Shoqëritë përfituese;
- Në disa raste, të licencuarit fillimisht nuk raportuan pagesa të cilat ishin deklaruar nga autoritetet tatimore;
- Në shume raste, të licencuarit dhe autoritetet tatimore raportuan taksa qe nuk ishin pjesë e punës rakorduese;
- Shumë nga të licencuarit ngatërruan pagesat për taksa të ndryshme ose penalitete të paguara.

Një pamje e detajuar për çdo shoqëri është paraqitur në Shtojcën 3.

Pagesat Sociale

Devoll Hydropower raportoi se ka bërë pagesa në dobi të komuniteteve në total, në shumën 282,502,587 lekë. Shoqëria nuk dha detaje nëse këto pagesa ishin të detyrueshme si rrjedhojë e marrëveshjes së koncesionit ose të bëra në baza vullnetare.

Asnjë nga shoqëritë e tjera të përzgjedhura hidroenergjetike nuk raportuan ndonjë pagesë të detyrueshme ose vullnetare si pagesa sociale për vitin 2016.

10.4 Përmbledhja e rakordimit të pagesave të Albpetrol ndaj Buxhetit të Shtetit

Në vitin 2016, Albpetrol kontriboi si më poshtë në Buxhetin e Shtetit:

Tabela 29 - Përmbledhja e rakordimit të pagesave nga Albpetrol në Buxhetin e Shtetit në vitin 2016

Shumat në mijë Lek

Të ardhurat nga pagesat kryesore	Shuma e paguesit	Shuma e Arkëtuesit	Mospërputhja e shpjeguar		Mospërputhja e pashpjeguar	
			Paguesi	Arkëtuesi	Pa-identifikuar	Pa-kundërparti
Renta minerare – shitje brenda vendit	138,780	136,054	-	-	2,726	-
TVSH	198,991	234,292	-	-	(35,301)	-
Tatimi mbi fitimin	21,199	7,404	-	-	13,795	-
Pagesat për Sig SHSH dhe TAP	368,114	370,784	-	-	(2,670)	-
Tatimi mbi dividentin	202,566	149,341	-	-	53,225	-
Dividenti paguar Shtetit	-	-	-	-	-	-
Pagesa të tjera - NJQV	5,000	-	-	-	-	5,000
Total	**934,650**	**897,874**	**-**	**-**	**31,776**	**5,000**

Mospërputhjet në shumën 31,776 mijë Lek mbetën të pazgjidhura deri në datën e këtij raporti.

Në përputhje me marrëveshjet hidrokarbure nën administrimin e tij, Albpetrol mblodhi të ardhurat e mëposhtme nga sektori i naftës.

Tabela 30 - Përmbledhja e pagesave arkëtuar nga Albpetrol në vitin 2016

Shumat në mijë Lek

Të ardhurat nga pagesat kryesore	Shuma e paguesit	Shuma e Arkëtuesit	Mospërputhja e shpjeguar		Mospërputhja e pashpjeguar	
			Paguesi	Arkëtuesi	Un-identified	Pa-kundërparti
Ndarja e Prodhimit	1,029,637	1,029,637	-	-	-	
Bonuset - Albpetrol	22,858	14,481	-	-	8,377	-
Total	**1,052,495**	**1,044,118**		**-**	**8,377**	**-**

Pjesa nga ndarja e prodhimit të naftës u pagua plotësisht në natyrë në sasinë e 52,151 ton në vitin 2016. Vlerat e paraqitura më sipër janë përftuar duke zbatuar çmimet mesatare të shitjes së Albpetrol në vitin 2016 prej 159.04 USD / ton. Shumat në USD u përkthyen në Lek me kursin mesatar të këmbimit të USD në Lek sipas Bankës së Shqipërisë në vitin 2016, ku 1 USD ishte i barabartë me 124.14 Lek.

11. Komente dhe rekomandime

Ky kapitull paraqet rakordimin e flukseve monetare nga të licencuarit e naftës dhe gazit, të licencuarit e përzgjedhur minerar dhe shoqëritë hidroenergjitike, si dhe një rakordim të pagesave të bëra nga Albpetrol në Buxhetin e Shtetit.

Gjatë rrjedhës së këtij angazhimi, ne identifikuam dhe përmblodhëm si më poshtë aspekte që mund të përmirësohen më tej, që ndikojnë në shtrirjen e raportimit EITI dhe vetë procesin. Përcaktimi i prioriteteve dhe kohës së zbatimit të rekomandimeve të pranuara është përgjegjësi e Grupit Shqiptar të Punës.

Në zbatim të rekomandimeve përfshirë në raportin EITI 2010, me qëllim forcimin e aksesit në të dhëna të besueshme brenda afatit të raportimit, Grupi Shqiptar i Punës caktoi pika kontakti kordinuese për procesin EITI në çdo institucion qeveritar raportues përfshirë MIE-n, AKBN-në, Shërbimin Gjeologjik Shqiptar, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Administratën Doganore Shqiptare etj, si dhe shoqëritë e mëdha që operojnë në sektorin hidrokarbur dhe atë minerar.

Emërimi i pikave kyçe EITI në institucionet shtetërore kontribuoi pozitivisht për të rritur ndërgjegjësimin dhe koordinimin e aktiviteteve të EITI. Megjithatë, përpjekje të mëtejshme nevojiten për të përmirësuar raportimin dhe analizimin e aktivitetit të industrisë dhe pagesat nga industria nxjerrëse.

Gjatë punës tonë vume re disa pengesa dhe kufizime në mbledhjen e të dhënave të besueshme dhe gjithëpërfshirëse në kohën e kërkuar për të hartuar këtë raport, përfshirë këtu: aspektet rregullatore, gatishmërinë e subjekteve raportuese dhe institucioneve publike, cilësinë e dobët të të dhënave në dispozicion etj.

Disa nga këto pengesa dhe veprimet korrigjuese të sugjeruara janë listuar në vijim.

Nëse nuk është vërejtur ndryshe, këto gjetje dhe rekomandime janë paraqitur vazhdimisht në raportet e mëparshme të EITI dhe janë përditësuar për zbatueshmërinë gjatë vitit 2016. **Rekomandimet e reja janë vërejtur si "Të reja" në kolonën e progresit.**	**Progresi bërë në vitin 2016**
Aksesi në kohë i informacionit të besueshëm nga të licencuarit	
1. Vonesat dhe mospërputhjet Subjektet e përzgjedhuar raportuan me shumë vonesë, përtej çdo afati dhe me shumë mospërputhje. Përmes pyetjeve drejtuar shoqërive raportuese ne kuptuam se në pjesën më të madhe të rasteve, informacioni i kërkuar nuk ishte i disponueshëm dhe i gjindshëm në llogaritë kontabël dhe sistemin e raportimit financiar ose kërkonte	Raportimi për vitin 2016 ishte me vonesa të konsiderueshme. Deri në mes të nëntorit 2017, vetëm 40 nga 141 subjekte të zgjedhura

përpunim shtesë. Për shkak të kohës së kufizuar, disa prej tyre refuzuan të bashkëpunonin me ne gjatë procesit të rakordimit. Në shumicën e rasteve, shoqëritë nuk përfshinë pagesat e plota në raportimet e tyre fillestare ose raportuan detyrimet në vend të pagesave. Më së shumti, mospërputhjet u identifikuan gjatë rakordimin të pagesave ndaj autoriteteve tatimore. Në shumë raste, shoqëritë ngatërruan pagesat me kompensimet tatimore neto si dhe pagesat e kryera për lloje të ndryshme taksash. Ky fakt ishte më i dukshëm në rastet kur pagesat ishin për shkak të gjetjeve që dalin nga inspektimet tatimore. **Rekomandimet në vitet e mëparshme** Në mënyrë që të lehtësohet procesi i rakordimit dhe përpilimi i raportit, ne sugjerojmë që të përcaktohet një kalendar vjetor për kryerjen e procesit të raportimit dhe rakordimit. Afati vjetor për raportim duhet të planifikohet para kohe dhe të përfshihet në kalendarin vjetor të raportimit të shoqërive. Për këtë arsye, përzgjedhja e shoqërive raportuese dhe kërkesave për raportim duhet të planifikohet dhe të komunikohet disa muaj përpara afatit për dorëzimin e raportimit. Ministria duhet të ndjekë zbatimin rigoroz të legjislacionit shqiptar në fuqi lidhur me raportimin financiar dhe auditimin e pasqyrave financiare të shoqërive në sektorin nxjerrës dhe atë të hidro-energjisë. Kjo do të sjellë përmirësim të cilësisë dhe sasisë së informacionit financiar prodhuar për aktivitetet nxjerrëse në Shqipëri.	kanë dorëzuar formularët e tyre të raportimit. Qeveria është në proces të nxjerrjes së një projektligji që do të bëj të zbatueshme me ligj raportimin e EITI në të gjithë sektorët në fjalë. Afati i ri do të jetë 31 Mars, i vitit pasardhës. Megjithatë, ky projektligj i ri nuk adreson kërkesat e sigurisë, të cilat janë të kundërshtuara fuqishëm nga shoqëritë për shkak të kostove dhe përpjekjeve shtesë.
2. Procedurat verifikuese (raportimi i të licencuarve) Shoqëritë e licencuara nuk paraqitën konfirmimin për saktësinë e raportimit EITI nga audituesit e pasqyrave financiare. Një pjesë e mirë e tyre nuk ju nënshtruan auditimit ligjor për shkak të formës së organizimit (si për shembull regjistrimi si degë e shoqërisë së huaj dhe jo si shoqëri më vete) ose niveli i ulët i aktivitetit gjatë vitit. Megjithatë, edhe kur shoqëritë i ishin nënshtruar auditimit ligjor të pasqyrave financiare, refuzuan t'i angazhonin audituesit e tyre për verifikimin e informacionit të raportuar për EITI-n. Në kuptimin tonë kjo kërkesë nuk pati sukses sepse mbarte kosto shtesë auditimi kur procesi i auditimit kishte përfunduar më herët. **Rekomandimet në vitet e mëparshme** Në kontekstin e përmirësimit të cilësisë të raportimit të Shoqërive dhe njëkohësisht për të marrë siguri mbi informacionin e raportuar, ne rekomandojmë që MSG t'ju kërkojë shoqërive të licencuara të paraqesin pagesat dhe informacione shtesë sipas standardit EITI në një raport të veçantë ose në një aneks të pasqyrave financiare vjetore. Në të dy rastet, ky informacion duhet të jetë subjekt i auditimit të pavaruar vjetor.	Në vitin 2016, 17 nga 102 subjekte paraqitën një raport sigurie. Numri i përgjithshëm i flukseve të siguruara arrin në 5.7 miliardë lekë dhe zënë 39% të flukseve totale të raportuara nga të licencuarit në 2016. Qeveria është në proces të nxjerrjes së një projektligji që do të bëj të zbatueshme me ligj raportimin e EITI në të gjithë sektorët në fjalë. Megjithatë, ky projektligj i ri nuk adreson kërkesat e sigurisë. Këto kërkesa sigurie janë të kundërshtuara fuqishëm nga shoqëritë për shkak të kostove dhe përpjekjeve shtesë.
3. Aspekte të tjera cilësore të analizës së pagesave (raportimi sipas licencave) Shoqëritë e licencuara në Shqipëri tatohen në bazë të rezultateve financiare të biznesit të tyre raportuar sipas numrit identifikues tatimor të biznesit. Ky numër mund të përfshijë informacion financiar dhe tatimor për një ose më shumë licenca me aktivitet minerar, hidro-energjetik dhe sektorë të tjerë të ekonomisë. Për shembull, disa nga shoqëritë e përzgjedhura raportuan pagesa të identifikuara me të njëjtin numër tatimor për aktivitetin minerar (guror) dhe aktivitetin e ndërtimit. **Rekomandimet në vitet e mëparshme** Ne rekomandojmë që MIE të rrisë kërkesat rregullatore për të siguruar raportimin e pagesave dhe taksave për secilën licencë më vete (niveli i projektit). Për të arritur raportimin sipas licencave, MIE mund t'i kërkojë të licencuarve të kenë	Asnjë progres nuk është bërë në vitin 2016.

një numër unik tatimor për secilën licencë. Kjo do të kërkojë llogaritjen dhe raportimin e investimeve, aktiviteteve, kthimeve dhe fitimeve për secilën licencë (projekt) më vete.

Raportimi sipas licencave mund të lejojë krahasimin e pagesave për çdo licencë me nivelin e prodhimit dhe tatimit, dhe MIE mund të përftojë një bazë të mjaftueshme të dhënash për buxhetimin e të ardhurave dhe analizën e efektivitetit të politikave fiskale në periudhë afatmesme dhe afatgjatë.

Aksesi në kohë i informacionit të besueshëm nga institucionet publike raportuese

Institucionet publike raportuan me shumë vonesë përtej çdo afati dhe me shumë mospërputhje. Përmes pyetjeve drejtuar institucioneve publike ne kuptuam se strukturat dhe sistemet e tyre të administrimit të informacionit nuk mund të prodhonin informacionin e kërkuar për qëllime të raportit EITI.

4. Mangësitë e raportimit të konsoliduar në qeverisjen qëndrore dhe vendore

Asnjë progres nuk është bërë në vitin 2016.

Grupi i raportimit të Qeverisjes qëndrore nuk mund të gjenerojë të dhëna për taksat e paguara nga çdo taksapagues. Arkëtimet dhe pagesat e Qeverisë regjistrohen në një sistem të veçantë për administrimin e parasë: Sistemi i Thesarit. Ne kuptojmë që ky sistem mund të prodhojë informacion për arkëtimet mujore në total sipas taksave, por nuk mund të prodhojë informacion të detajuar për çdo taksapagues. Për këtë arsye, MSG i kërkoi agjencive qeveritare që mbledhin pagesat në sektor të raportojnë arkëtimet nga të ardhurat kryesore në sektor, meqënëse nuk mund ta merrte këtë informacion nga një burim i vetëm.

Rekomandimet në vitet e mëparshme

Për të përmirësuar kohën, kostot dhe cilësinë e raportimit nga Qeveria ne rekomandojmë:

Bashkëpunimin me ekipin e raportimit të Qeverisë për të krijuar raporte që mund të gjenerohen nga sistemi i Thesarit me informacion për pagesat e mbledhura për çdo taksapagues sipas llojit të taksave. Për disa arsye shpjeguar më poshtë, ne mendojmë se qasja në raportet e prodhuar nga sistemet e raportimit të Qeverisjes Qëndrore do të ishte zgjidhja më e mirë.

Megjithatë, nëse kjo nuk mund të realizohet në një periudhë afatshkurtër apo afatmesme, ne rekomandojmë vlerësimin e mundësisë për të marrë këtë informacion nga sistemet e informacionit të agjencive qeveritare që arkëtojnë të ardhura në sektor.

5. Raportimi i Njësive të Qeverisjes Vendore

Raportimi i NjQV erdhi me vonesë dhe kishte shumë mospërputhje në vitin 2016.

Qeveria është në proces të nxjerrjes së një projektligji që do të bëj të zbatueshme me ligj raportimin e EITI në të gjithë sektorët në fjalë, duke përfshirë dhe NjQV-të.

Duke qenë se raportimi nga njësitë e licencuara përfshin një numër të madh njësish qeverisëse, MSG zgjodhi vetëm shtatë NjQV për raportim bazuar në nivelin e aktivitetit prodhues raportuar nga AKBN për vitin 2016. Procesi i raportimit nuk përfshin të gjitha NjQV nga sektori naftës dhe gazit, sektori minerar dhe ai i hidro-energjisë.

Panvarësisht bashkëpunimit të vazhdueshëm midis Sekretariatit ALBEITI dhe NjQV-ve, raportimi ishte jo i plotë dhe me vonesa të konsiderueshme. Për më tepër, tre NjQV nuk kanë dorëzuar raportimin e tyre në datën e këtij raporti.

Rekomandimet

Gjithësesi, NJQV-të kanë autonomi të caktuar në biznesin dhe tatimin e aktivitetit në zonat nën administrim. Për të përmirësuar transparencën në aspektin e pagesave të tatimeve dhe taksave lokale, tarifave për shërbimet, kontributet dhe aktivitetet në dobi të komunitetit lokal, etj., ne rekomandojmë zgjedhjen e një numri të caktuar të NjQV-sh bazuar në nivelin e aktivitetit prodhues të raportura nga AKBN. Zgjedhja e NJQV-ve që do të raportojnë duhet të planifikohet dhe komunikohet muaj përpara punës rakorduese, në mënyrë që tu përshtaten kërkesave të raportimit.

ALBEITI do të theksojë domosdoshmërinë për të siguruar pagesa analitike dhe informacione komentuese mbi metodat e vendosjes së këtyre pagesave kur këto nuk janë të specifikuara në Ligjin për taksat vendore 9632 datë 30.10.2006, të ndryshuar dhe rregullat shoqëruese.

Ligji për Naftën dhe Gazin (i ndryshuar në Mars 2015) dhe ligji për Sektorin Minerar (i ndryshuar në Tetor 2014) i kërkon njësive të licencuara që operojnë në sektorin e naftës dhe gazit, si dhe në sektorin minerar të raportojnë të dhënat dhe informacionet në zbatim të Standardit EITI. Gjithashtu, të dy ligjet kërkojnë raportim nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, organet e administratës doganore, si dhe organet e qeverisjes qëndrore dhe vendore që marrin të ardhura nga ky sektor.

Në mënyrë që të sigurohet zbatimin i këtyre kërkesave, ne rekomandojmë MSG të prezantojë rregullore plotësuese për bashkëpunimin e vazhdueshëm të NjQV-ve me EITI-n dhe dhënien e informacioneve të tyre shpjeguese që do të prodhohen nga NjQV-të që administrojnë zona industriale nxjerrëse.

6. Kufizimet në raportet e prodhuara nga Autoritetet Tatimore

Forma e raportimit e autoriteteve tatimore erdhi në kohë dhe kishte vetëm pak mospërputhje në vitin 2016. Autoritetet tatimore kanë zhvilluar raporte që mundësojnë eksportim të shpejtë të pagesave nga sistemi i tyre i raportimit.

Sistemi i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, gjeneroi informacion për taksat e paguara mbi bazen e NIPT-eve të përzgjedhura nëpërmjet sistemit informatik. Raportimi u nxorr duke përdorur filtra në databazen e të dhënave. Gjithsesi, këto raporte ishin jo të plota dhe përmbanin shumë gabime për periudhat e mëparshme raportuese.

Rekomandimet

Siç rekomandohet edhe më sipër, për të përmirësuar eficencën dhe efektivitetin e raportimit nga agjencitë qeveritare, MSG dhe EITI Shqipëri duhet të bashkëpunojnë me ekipin e raportimit të Qeverisë për të hartuar raporte që mund të prodhohen nga sistemi i raportimit të Qeverisë.

Megjithatë, nëse kjo nuk mund të realizohet në një periudhë afatshkurtër apo afatmesme, dhe duke konsideruar madhësinë e të ardhurave që mbledh DPT në sektor ne rekomandojmë kërkimin e mundësive për të prodhuar raporte dhe informacion nga sistemi i tatimeve.

7. Proceset e sigurimit (institucionet qeveritare dhe NSH-të)

Rekomandim i ri i përfshirë në këtë raport.

Raportimi nga institucionet qeveritare

Të ardhurat e raportuara nga institucionet publike që grumbullojnë të ardhura nga sektorët nxjerrës duke përfshirë MIE, AKBN, Autoritetet tatimore, Autoritetet doganore dhe NjQV nuk ishin të njëtja me shifrat e audituara të publikuara. Këto institucione nuk publikojnë pasqyrat vjetore financiare të audituara, por ato i nënshtrohen auditimeve të performancës dhe pajtueshmërisë të kryer nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në Shqipëri.

Raportimi nga Albpetrol

Albpetrol prodhon pasqyra vjetore financiare dhe i nënshtrohet procesit të auditimit ligjor në përputhje me kuadrin rregullator. Të ardhurat e raportuara nga Albpetrol në lidhje me bonuset dhe pagesat e naftës në natyrë (ndarja e prodhimit) nuk mund të rakordohen me pasqyrat financiare të audituara, sepse pasqyrat vjetore financiare janë përgatitur në bazë të kontabilitetit rrjedhës.

Rekomandimet

Në kontekst të përmirësimit të cilësisë së raportimit dhe në të njëjtën kohë të sigurimit të informacionit të raportuar nga institucionet qeveritare, rekomandojmë që MSG të konsiderojë angazhimin e Auditorit të Lartë të Shtetit për të siguruar siguri në raportimin EITI të prodhuar nga MIE, AKBN, Autoritetet tatimore, autoritetet doganore dhe NjQV-të e përzgjedhura.

Sa i përket Albpetrol, MSG mund t'i kërkojë këtij të fundit të raportojë të ardhurat e EITI në formatin e kërkuar dhe informacione të tjera si një raport të veçantë ose në

një shtojcë të pasqyrave financiare vjetore. Në të dy rastet, ky informacion duhet t'i nënshtrohet auditimeve të pavarura vjetore.

Çështje lidhur me cilësinë e informacionit kontekstual paraqitur në raport	
8. Publikimi i statistikave dhe fakteve mbi industrinë nxjerrëse Standardi i ri EITI kërkon paraqitjen në raport të kontekstit në të cilin operon industria nxjerrëse dhe informacion për rregullimin e industrisë në vend, duke përfshirë sa më poshtë: ▪ Pamje e përgjithshme e industrisë nxjerrëse, informacion për rezervat, vendburimet, strukturën aktuale dhe madhësinë e industrisë, aktiviteteve të rëndësishme kërkimore etj; ▪ Kontributin e industrisë në ekonomi, punësim dhe nivelin e eksporteve; ▪ Totalin e të ardhurave gjeneruar nga industria nxjerrëse dhe fondet e përcaktuara për programet specifike / rajonet gjeografike ose transfertat midis Shtetit dhe pushtetit vendor; ▪ Studimet e kryera mbi impaktin mjedisor dhe social kryer për sektorin; ▪ Informacion publik për alokimit e licencave, regjistrin e të licencuarve, pronarët përfitues, kushtet e kontratës etj. Ne vumë re disa përmirësime në publikimin e informacionit në faqet e MIE, AKBN dhe Albpetrol, megjithatë të dhënat publikohen nga burime të ndryshme, si rrjedhojë përmirësime të mëtejshme janë ende të nevojshme për të siguruar një raportim të plotë dhe të qëndrueshëm mbi industrinë nxjerrëse. Në disa raste informacioni i raportuar nga AKBN përfshiu mospërputhje në krahasimin me burime të tjera (*siç është shënuar në seksionin 4.1, numri i punonjësve të raportuar nga AKBN për vitin 2016 ishte dukshëm më i ulët se numri i raportuar nga DPT)*. Informacioni kontekstual i përfshirë në këtë raport i është referuar burimeve të ndryshme të shpërndara në të gjithë sektorin publik. Shpesh ky informacion nuk ishte publik. Disa analiza u kufizuan për shkak të mungesës së statistikave për këtë sektor dhe atje ku ishin të disponueshme, këto statistika përfshinin informacione për një sektor më të gjerë *(dmth. PBB i publikuar për Energjinë dhe burimet përfshin: industritë nxjerrëse, furnizimin me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër dhe të tjera që lidhen me menaxhimin e mbetjeve)*. **Rekomandimet** Për të përmirësuar plotësinë dhe saktësinë, besueshmërinë dhe aksesin në informacionin kontekstual, ne rekomandojmë që Ministria e Energjisë dhe Industrisë të publikojë në mënyrë periodike (të paktën çdo vit) fakte mbi industrinë duke përfshirë: potencialin e industrisë dhe prodhimin aktual, kontributin në ekonomi, strategjinë e sektorit, ngjarje dhe fakte, rregullimin aktual dhe ndryshimet e ardhshme etj. Informacioni kontekstual mund të përfshijë informacione të tjera të dobishme për statistikat e sektorit të tilla si: ▪ Madhësia e prodhimit dhe detaje të cilësisë (graviteti i naftës, përqëndrimi i sulfurit, përqendrimi i mineraleve, etj); ▪ Investimet (numri i puseve dhe galerive të minierave nën administrim / zhvillim); ▪ Projektet për rehabilitimin mjedisor dhe kostot përkatëse; ▪ Fuqia punëtore e punësuar, paga mesatare dhe nënkontraktimi, shpenzimet sociale, etj. Këto informacione mund të mblidhen e të përpunohen çdo vit dhe të shërbejnë si bazë për raportimin e statistikave dhe fakteve për industrinë. AKBN, si institucion i angazhuar gjerësisht në monitorimin e sektorit mund të kontribuojë në përpilimin e statistikave të sektorit nëpërmjet grumbullimit të informacionit nga raportimet vjetore të shoqërive për çdo licencë në AKBN, bazuar në treguesit e përcaktuar nga MSG për	MIE ka publikuar nivelin e naftës së prodhuar dhe të rafinuar për vitet 2011-2016 në faqen e internetit të saj. Megjithatë, përmirësime të mëtejshme duhet të bëhen për të siguruar publikimin e plotë të aktiviteteve.

prodhimin, rezervat, shitjen, numrin e punonjësve, investimet në mjedis, pagesat sociale etj.

Me qëllim që të rritet gjithëpërfshirja dhe saktësia e të dhënave të raportuara, MIE dhe AKBN mund të inkorporojnë procedurat e rakordimit dhe kontrollit të ndërsjelltë me institucionet e tjera publike duke mbledhur dhe administruar të dhëna të tilla si DPT, ADSH etj.

Ndër të tjera, përmes përdorimit të treguesve, AKBN mund të përmbledhë fakte të bazuara në studimet vjetore të mjedisit duke theksuar rreziqet dhe trendet në nivel vendi, si dhe zona të veçanta ku përqendrohet veprimtaria e operatorëve në sektorin e nxjerrjes dhe të energjisë.

Në kuadër të përmirësimit të raportimit dhe statistikave në industrinë nxjerrëse, ne rekomandojmë Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë të shqyrtojë nëse do të zbatojë kërkesat e raportimit të ngjashme si në Direktivat e BE-së për Kontabilitetin dhe Transparencën.[112]

---

9. Të dhënat për sasinë dhe vlerësimin e prodhimit

Përmes pyetjeve drejtuar AKBN-së, ne kuptuam se sasia e prodhimit raportuar nga AKBN përftohet nga vetëdeklarimet e dorëzuara nga shoqëritë e licencuara në AKBN, si pjesë e raportimit vjetor. AKBN na informoi se nuk kryen procedura kontrolli për të marrë siguri mbi saktësinë e të dhënave të vetëdeklaruara për prodhimin, të ardhurat dhe rezervat.

Për më tepër, AKBN nuk mund të japë detaje për përbërjen dhe cilësinë (përqendrimin) e mineraleve të prodhuara. Në mungesë të një informacioni të tillë, prodhimi minerar mund të vlerësohet duke u bazuar tek çmimet mesatare ndërkombëtare.

Rekomandimet

Përtej mbledhjes së vetë-deklarimeve nga subjektet, ne rekomandojmë që AKBN:

- të kryejë matje të prodhimit minerar të nxjerrë dhe ta krahasojë atë me vetëdeklarimet e shoqërive duke përfshirë të dhëna për cilësinë e mineraleve (nivelin e përqëndrimit);
- një përmbledhje të vlerave të transaksioneve në tregun vendas dhe tregjet e eksportit dhe krahasimin e tyre me çmimet në tregjet ndërkombëtare të mineraleve.

Të dhënat e prodhimit ende grumbullohen përmes vetë-deklarimeve të dorëzuara nga të licencuarit dhe AKBN-ja nuk ofron ndonjë siguri për këto.

AKBN siguroi disa indikatorë të përqëndrimit të mineraleve, megjithatë nuk mund të ofronte një analizë të vlerave të bazuara në shitjet e brendshme dhe të eksportit në vitin 2016.

---

10. Publikimi i të ardhurave totale që merr Shteti nga industria nxjerrëse

Ne nuk mund të merrnim një raport të plotë të të ardhurave të Qeverisë nga sektori nxjerrës për vitin 2011 - 2016. Siç është theksuar në pikat e mëparshme, sistemi i raportimit të Qeverisë nuk mund të identifikojë dhe të regjistrojë në mënyrë analitike të ardhurat totale dhe sipas taksave gjeneruar nga industria nxjerrëse apo të ardhurat gjeneruar nga secili taksapagues më vete.

Mungesa e këtij informacioni, kufizon analizën e madhësisë relative të pagesave sipas llojit, trendin e pagesave në krahasim me prodhimin, madhësinë relative të pagesave nga taksapaguesit individual, etj.

Rekomandimet

Sistemi qëndror i Thesarit mbledh informacion për çdo pagesë kryer nga taksapaguesit individual, pavarësisht institucioneve që mbledhin këto të taksa ose sektorit ekonomik ku vepron taksapaguesi. Siç është theksuar në pikat e mëparshme, nëpërmjet bashkëpunimit me ekipin e raportimit të Qeverisë, MSG mund të marrë të dhëna të plota për të ardhurat gjeneruar nga sektori nxjerrës dhe i hidro-energjisë. Kjo mund të arrihet duke mbajtur një regjistër të përditësuar të licencave në sektor me të dhëna të sakta për numrin e licencës dhe numrin e identifikimit tatimor. Sistemi i informacionit

Publikimi e të ardhurave të qeverisë është përmirësuar në vitin 2016 si rezultat i përmirësimit të cilësisë dhe shumëllojshmërisë së të dhënave të raportuara nga autoritetet tatimore.

Identifikimi dhe sigurimi i plotësisë së licencave të sektorit mbetet një çështje e pazgjidhur për shkak të mospërputhjeve në mes të regjistrit të licencave të ofruara nga AKBN, MIE, ALBEITI etj.

Për më tepër, të ardhurat e publikuara mund të lidhen me aktivitetet e

---

112 EU Accounting Directive 2013/34/EU

të Qeverisë mund të përdorë të dhënat nga ky regjistër për të prodhuar raportet. Nëse kjo nuk mund të realizohet në një periudhë afatshkurtër apo afatmesme, ne rekomandojmë bashkëpunimin për të marrë këtë informacion nga sistemet e informacionit të agjencive qeveritare që arkëtojnë taksa në sektor si tatimet, doganat, dhe NjQV-të, të cilat përfaqësojnë njëkohësisht agjentë të rëndësishëm tatimorë. Përveç përmbushjes së kerkesave të standardit EITI, informacioni i përditësuar nga sistemi i raportimit të Qeverisë do të përmirësojë analizat statistikore në sektor. Informacioni mund të krahasohet me informacione të tjera si niveli i prodhimit, struktura e industrisë, numri i licencave, etj.	tjera jo-nxjerrëse të kryera nga licenca të tjera nën të njëjtat numra tatimesh.
11. Rezervat Ne kuptojmë se Qeveria nuk ka ndërmarrë studime mbi rezervat gjeologjike për naftën dhe mineralet e tjera në 25 vitet e fundit. Në këtë rast sugjerojmë që MIE të publikojë rezultatet e studimeve dhe hartat gjeologjike të viteve 80 dhe 90. Gjithsesi, saktësia e tyre është e kufizuar për shkak të avancimit teknologjik për kërkimin dhe nxjerrjen e naftës dhe mineraleve të tjera, si dhe mungesës së të dhënave zyrtare e të sakta për prodhimin e nxjerrë në të gjithë vendin që nga koha e këtyre studimeve të fundit gjeologjike. **Rekomandimet** Ne e kuptojmë se vlerësimi i rezervave kombëtare mund të kërkojë shumë vite dhe përbën një kosto të rëndë në Buxhetin e Shtetit. Megjithatë, rezervat janë të rëndësishme për të siguruar informacion kontekstual për vlerën e përgjithshme të pasurisë kombëtare në përputhje me kërkesat e kapitullit 3 të standardit EITI. Ne rekomandojmë që MIE të vlerësojë përfitimet përkundrejt kostove për vlerësimin e rezervave në të gjithë vendin dhe të caktojë prioritetet për zonat me interes të lartë. Gjithashtu, informacioni koherent për rezervat e provuara dhe të mundshme kombinuar me kontroll efektiv të aktiviteteve të kërkimit dhe nxjerrjes së naftës dhe mineraleve në vend, mund të ndihmojë në planifikimin efektiv të prodhimit dhe atë fiskal si dhe parandalimin e abuzimeve me burimet kombëtare.	Asnjë progres nuk është bërë në vitin 2016.
12. Mbajtja e një regjistri të përditësuar publik të të licencuarve dhe koncesioneve MIE, AKBN dhe Albpetrol nuk publikojnë në faqen e tyre të internetit një regjistër në dispozicion të publikut për të gjithë licencat që operojnë në sektorët nxjerrës të naftës, gazit dhe minerar, në përputhje me kërkesën 2.3. të EITI-t. Kjo mospërputhje zbutet nga angazhimi i ALBEITI-t, i cili përpilon dhe përditëson regjistrat publikë të licencave të naftës, gazit dhe minerare çdo gjashtë muaj. Këto regjistra paraqesin, deri ku mundet, informacionin e kërkuar nga Standardi EITI dhe informacione të tjera plotësuese për veprimtarinë e të licencuarit. **Rekomandimet** Meqenëse ALBEITI nuk është Autoriteti Kontraktues, as Autoriteti Mbikëqyrës, MSG mund të konsiderojë t'i kërkojë MIE-s dhe AKBN-së për të konfirmuar dhe pranuar regjistrat e publikuar nga ALBEITI dhe për të siguruar lidhje të drejtpërdrejta me regjistrin më të azhornuar në faqen e internetit ALBEITI-t. Në mënyrë alternative, MSG mund t'i kërkojë MIE-s dhe AKBN-së të azhornojnë regjistrat e tyre me të njëjtën shpeshtësi ose më shpesh, në mënyrë që qytetarët të kenë qasje në regjistra të krahasueshëm.	Disa përparime janë bërë për shkak të angazhimit të ALBEITI për të ndërtuar një listë në përputhje me kërkesat e Standardit EITI. Përveç hartimit të listave, ALBEITI kryen edhe kontrolle dhe verifikime të informacionit në dokumentet burimore.
13. Transparenca mbi alokimin e licencave Standardi EITI 2.2 kërkon që Qeveria e Shqipërisë të krijojë dhe mirëmbajë proceset e dhënies së licencës, ku vendimet për dhënien e licencave bëhen në bazë të kritereve / parametrave të përcaktuara, të qëndrueshme dhe të kuptueshme, dhe që janë të shpallura publikisht për secilin aplikant. Kjo mund të përfshijë kualifikimet teknike dhe	Progresi i bërë në vitin 2016 në lidhje me alokimin e licencave minerare. MIE publikoi të gjitha kadastrat minerare në dispozicion për licenca

financiare të nevojshme për mbajtjen e të drejtave ne kërkimin dhe prodhimin e naftës, gazit dhe mineraleve të tjera, kriteret ligjore, kriteret për shëndetin, sigurinë dhe mjedisin, programet e punës etj.

Proceset në fuqi përfshijnë njoftimin e zonave të naftës dhe zonave minerare për t'u licencuar dhe detajet teknike shoqëruese dhe udhëzimet për aplikim.

Licencat minerare

Njoftimet konkurruese për zonat minerare listojnë kriteret teknike dhe financiare nën vlerësimin dhe peshën përkatëse. Procesi administrohet nga Agjencia e Prokurimit Publik, e cila është një agjenci e pavarur publike që i raporton Parlamentit Shqiptar.

Procesi i themeluar në përgjithësi i plotëson kërkesat e EITI-t të përcaktuara në pikën 2.2, përveç për publikimit të emrave të aplikantëve jo-fitues. Listimi i pjesëmarrësve jo-fitues i vihet në dispozicion të pjesëmarrësve në konkurim nëpërmjet postës elektronike, por nuk publikohet për të gjithë.

MIE informon se një publikim i tillë nuk është parashikuar në ligjin për prokurimin publik dhe çdo ndryshim duhet të shqyrtohet me kujdes nga perspektiva e aplikantëve që nuk janë fitues. MIE argumentoi zyrtarisht se përfshirja e Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Komisionit të Prokurimit Publik në mbikëqyrjen për alokimit e drejtë të licensave minerare dhe në baza jodiskriminuese, duhet të jetë i mjaftueshëm për të parandaluar praktikat e korruptuara ose diskriminuese, dhe adresimin e shqetësimeve të pjesëmarrësve në kohën e duhur.

Licencat e naftës

Negociatat për licencat e naftës ndryshojnë shumë nga rasti në rast. Blloqet e kërkimit të naftës dhe fushat e naftës në dispozicion publikohen vazhdimisht nga MIE, AKBN dhe Albpetrol, në faqet e tyre të internetit. Procesi për vlerësimin dhe negocimin e PSA-ve përshkruhet në faqen zyrtare të MIE dhe AKBN.

Megjithatë, janë vërejtur disa mospërputhje me dhënien e informacioneve shpjeguese për çmimet e kontratës. Siç është përmendur në këtë raport dhe në raportin e mëparshëm EITI-t, në disa raste procedurat e negocimit të kontratës nuk bëhen publike derisa ato të finalizohen dhe ratifikohen nga VKM, siç është rasti i PSA-së dhënë Albanides Energy.

Në këtë rast, MIE nuk dhënë informacion nëse kjo kontratë është ndarë përmes një procesi tenderimi ose procesi negocimi, dhe cilët ishin aplikantët jo fitues.

Rekomandimet

Licencat minerare

Ne rekomandojmë që MIE të konsiderojë publikimin e emrave të aplikantëve jo fitues dhe çdo parregullsi që haset me ALBEITI-n në bazë të një marrëveshjeje konfidenciale. MSG mund të shqyrtojë nëse do të kërkojë procedura specifike për qëllim të zbatimit të nismës EITI.

Licencat e naftës dhe gazit

Ne rekomandojmë që MIE të publikojë në mënyrë të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse qasjen e publikut në informacionin e mëposhtëm për çdo PSA të alokuar në periudhën raportuese:

i. një përshkrim të procesit për transferimin ose dhënien e licencës (procesi konkurimi apo negociata);
ii. kriteret teknike dhe financiare të përdorura (p.sh. nëse rezervat janë të vlerësuara apo kërkohet që kandidati që t'i vlerësojë ato);
iii. informacion mbi përftuesin(t) e licencës së dhënë ose transferuar, duke përfshirë anëtarët aty ku ka bashkim operatorësh; dhe
iv. çdo devijim jo të parëndësishëm nga kuadri ligjor dhe rregullator i zbatueshëm që rregullon transferimet e licencave dhe çmimet.

Aty ku licencat jepen përmes një procesi konkurues gjatë periudhës kontabël të mbuluar nga Raporti EITI, qeverisë i kërkohet të japë informacion shpjegues për listën e aplikantëve dhe kriteret e konkurimit.

duke përfshirë specifikimet teknike të zonës dhe llojin e procedurës së planifikuar.

Përveç kësaj MSG, mund të dëshirojë të konsiderojë publikimin e informacioneve shtesë që janë në interes të komuniteteve përreth, si:

- Detajet e kushteve të punësimit, kushtet e ruajtjes së mjedisit, shpenzimet sociale, marrëveshjet e shkëmbimit, etj. nëse janë pjesë e kushteve të licencës; dhe

- Një përshkrim të përfitimeve ekonomike dhe sociale që pritet nga licenca e dhënë dhe veprimet e planifikuara për menaxhimin e rrezikut mjedisor.

Përveç plotësimit të kërkesave të EITI, këto zbulime do të rrisin transparencën e procesit dhe do të kontribuojnë në përmirësimin e efektivitetit të ofertave dhe negociatave.

Për më tepër, Shqipëria ka nënshkruar traktate investimi me shumë vende (lista e plotë e traktateve në fuqi është dhënë në: http://investmentpolicyhub.unctad.org/IIA/CountryBits/2#iiaInnerMenu). Këto marrëveshje imponojnë kërkesa të forta për transparencën e procedurave të licencimit dhe të prokurimit. Në këto rrethana, mungesa e transparencës dhe proceseve joefektive për ndarjen e të licencuarve, mund ta ekspozojnë vendin kundër pretendimeve ndërkombëtare të arbitrazhit.

---

14. Rakordimi i transfertave të rentës minerare

Siç është vërejtur në kapitullin 6, në nëntor të vitit 2014, Parlamenti shqiptar paraqiti ndryshime në Ligjin mbi taksat kombëtare për alokimin e transfertave lokale të rentës minerare dhe procedurave përkatëse të rakordimit.

Viti i parë i zbatimit të këtyre ndryshimeve rezultoi në mospërputhje, ku shifrat e raportuara nga Ministria e Financave, për vitin 2015, për transferimet lokale të rentës minerare ishin shumë më të ulëta se pjesa e transferueshme e përcaktuar në ligj.

Rekomandimet

Në mënyrë që të rritet transparenca dhe për të siguruar zbatimin e të gjitha ndryshimeve ligjore, ne rekomandojmë që MSG të përfshijë rakordimin e transfertave kombëtare të rentës minerare ose procedurave të tjera rakorduese në raportet e ardhshme EITI.

MSG zgjodhi 7 NjQV për procesin e rakordimit në 2016, të cilat përfaqësojnë dhe administrojnë rrethet më të mëdha nxjerrëse bazuar në rezultatet e shpallura nga AKBN.

Megjithatë, vetëm katër nga shtatë NjQV-të raportuan për vitin 2016. Siç është përmendur më herët në pikën 4, MSG duhet të zbatojë dispozitat rregullatore për të siguruar që NjQV të krijojë një proces të brendshëm dhe të promovojë në mënyrë proaktive përfitimet e një bashkëpunimi aktiv me EITI.

---

15. Pjesëmarrja e qeverisë në sektorin nxjerrës

Publikimi i politikave në marrëdhëniet financiare mes MIE dhe Albpetrol

MIE dhe Albpetrol nuk kanë politikë për shpërndarjen e dividentëve. Dividentët e shpërndarë nga Albpetrol deri më tani kanë qenë të paqëndrueshme dhe jo të lidhura ngushtë me fitimet e tyre dhe nivelin e fitimeve të pashpërndara.

Deklarimi i nivelit të pjesëmarrjes në shoqëritë që veprojnë në sektorin nxjerrës

Nga kërkimi në QKR për vitin 2016, u zbuluan disa Ndërmarrje Shtetërore të angazhuara në sektorin e naftës dhe atë minerar të cilat nuk ishin deklaruar më parë nga MIE apo MEF. Analiza e aktiviteteve të tyre dhe madhësisë relative nuk kanë shënuar pagesa materiale të cilat mund të ishin lënë jashtë këtij raporti të EITI, por kjo marrëdhënie mund të sjellë rritje të pagesave materiale në të ardhmen.

Rekomandimet

Në përputhje me standardin EITI 2.6, Qeveria duhet të japë informacione për të gjithë pjesëmarrësit në industritë nxjerrëse që krijojnë pagesa material. Vendet

Rekomandim i ri i përfshirë në këtë raport.

zbatuese duhet të deklarojnë:

a. Një shpjegim të rregullave dhe praktikave mbizotëruese në marrëdhëniet financiare midis Qeverisë dhe Ndërmarrjeve Shtetërore (NSH), p.sh. rregullat dhe praktikat që qeverisin transfertat e fondeve ndërmjet NSH-ve dhe shtetit, fitimet e pashpërndara, riinvestimet dhe financimi i palëve të treta;
b. Publikimi i informacioneve shpjeguese nga Qeveria dhe NSH rreth nivelit të tyre të pronësisë në shoqëritë minerare, naftës dhe gazit që operojnë brenda sektorit të naftës, gazit dhe minerare, duke përfshirë ato që mbahen nga filialet e ndërmarrjeve shoqërore dhe ndërmarrjet e përbashkëta dhe çdo ndryshim në nivelin e pronësisë gjatë periudhës raportuese.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave të pikës 2.6, MIE duhet të mbajë një regjistër të azhornuar që ka të renditura të gjitha NSH dhe pjesëmarrjet e tjera në shoqëritë që operojnë në sektorin nxjerrës të naftës. Regjistri do të përditësohet për blerjet e reja, shitjet, privatizimet etj.

Përveç kësaj, MIE do të deklarojë nivelin e angazhimit nga ana e Ministrisë në drejtimin e veprimtarive ekonomike dhe financiare të këtyre shoqërive nëpërmjet pjesëmarrjes në Bordin e Drejtorëve apo marrëveshjeve të tjera, duke përfshirë:

- Investimet aktuale dhe të planifikuara;
- Kreditë dhe garancitë e bëra;
- Shpërndarjet e fitimit dhe politikat e ri-investimeve;
- Marrëveshje të tjera etj.

16. Vendosja e pragjeve të materialitetit

Rekomandim i ri i përfshirë në këtë raport.

Numri i entiteteve raportuese të përzgjedhura është rritur çdo vit, për shkak të rritjes së numrit të shoqërive minerare. MSG vazhdimisht synonte të mbulonte të paktën 80% të vlerës së prodhimit të raportuar nga sektori minerar. Megjithatë, kjo rritje rezultoi në përpjekje shtesë të rakordimit dhe rritje të konsiderueshme të numrit të subjekteve jo-raportuese në 2016.

Bazuar në deklarimet e njëanshme nga agjencitë qeveritare, flukset e mjeteve monetare nga këto shoqëri ishin 640,432 mijë lekë ose 19% të totalit të flukseve monetare të raportuara nga të licencuarit në sektorin minerar dhe 4.7% të totalit të flukseve monetare.

Rekomandimet

MSG duhet të hetojë arsyet për mos-raportim dhe inkurajon zbatimin e kërkesave aktuale rregullatore për raportimin e EITI-t.

Në të ardhmen, MSG mund të konsiderojë rishikimin e pragut të materialitetit për të arritur një ekuilibër midis gjithëpërfshirjes së publikimit të informacioneve shpjeguese dhe cilësisë së raportimit.

Siç tregohet në seksionin 7.1, flukset e raportuara nga 50 të licencuarit më të mëdhenj përbëjnë mbi 94% të totalit të flukseve të përzgjedhura për rakordim mes 141 të licencuarve. 50 të licencuarit më të mëdhenj, kanë kaluar përmes auditimit ligjor në pothuajse të gjitha rastet dhe përveç kësaj kanë ofruar siguri specifike për shifrat e flukseve të raportuara në kuadrin e raportit EITI në masën 38.5%.

17. Deklarimi i ndarjes së prodhimit të Albpetrol

Rekomandim i ri i përfshirë në këtë raport.

Albpetroli dhe shoqëritë e naftës raportojnë shumat e mbledhura të pagesave në natyrë dhe nuk identifikojnë pagesat e bëra për PEP nga ato të bëra për ASP. Këto pagesa do të konfirmohen përmes procedurave të rregullta të rakordimit ndërmjet dy palëve. Mungesa e disagregimit mund të pengojë çështjet e rakordimit.

Rekomandimet

Për të forcuar zbatimin, MSG do të sigurojë që raportet e ardhshme të EITI-t të ndajnë në mënyrë të qartë të ardhurat në natyrë të shtetit nga nafta e kapitalit të Albpetrol, siç ka bërë në Raportet e mëparshme të EITI dhe që këto pagesa, duke përfshirë çdo detyrim të papaguar janë rakorduar midis palëve për periudhën e mbuluar nga raporti

i EITI.

18. Alokimi i të ardhurave që nuk janë regjistruar në buxhetin e shtetit

Rekomandim i ri i përfshirë në këtë raport.

AKBN është i vetmi institucion publik jo-buxhetor që mbledh të ardhura në sektorin nxjerrës dhe nuk i depoziton këto në Buxhetin e Shtetit. Në përputhje me standardin EITI 5, AKBN do të deklarojë se si këto të ardhura janë shpenzuar ose alokuar në buxhetet e tjera.

Në vitin 2016, njësoj si në vitet e mëparshme, AKBN nuk ka dhënë pasqyrat financiare vjetore të detajuara për nivelin e fitimeve të pashpërndara të kryera në llogaritë bankare, të ardhurat e mbledhura dhe shpenzimet e financuara, investimet dhe shpenzimet e buxhetuara etj.

Rekomandimet

Në përputhje me kërkesat 5.1, MSG duhet të sigurojë që alokimi i të ardhurave nga sektori i nxjerrjes, të cilat nuk janë të regjistruara në buxhetin e shtetit janë shpjeguar, duke bërë lidhjen me raportet përkatëse financiare.

Kuadri regullator për raportimin EITI

19. Detyrimi për transparencë përkundrejt detyrimit për ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave

Qeveria e Shqipërisë është në proces të nxjerrjes së një ligji të ri mbi zbatimin e EITI në Shqipëri. Ky ligj i ri përcakton rolet, përkufizimet, kërkesat e raportimit dhe afatet kohore për raportim.

Ligji për hidrokarburet (ndryshuar në mars 2015) dhe Ligji Minerar (ndryshuar në tetor 2014) i kërkojnë respektivisht të licencuarve në kërkimin dhe prodhimin e naftës dhe mineraleve të tjera të raportojnë informacionin në përputhje me standardin EITI. Gjithashtu, të dy ligjet kërkojnë raportim nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Administrata Doganore Shqiptare, institucione të tjera publike në nivel qeverisje qëndrore dhe vendore të raportojnë të ardhurat e mbledhura nga këta dy sektorë. Kërkesa për raportim EITI nga ana e institucioneve qeveritare aktualisht është në konflikt me detyrimin e tyre ligjor për të ruajtur konfidencialitetin mbi informacionin e marrë gjatë punës së tyre. Këto dispozita konfidencialiteti, të referuara në ligjet e aplikueshme për procedurat tatimore dhe doganore në Shqipëri[113] lejojnë akses në të dhënat vetëm me pëlqimin e shprehur nga shoqëritë e licencuara. Institucionet qeveritare mund të shkëmbejnë të dhëna sipas disa kushteve strikte konfidencialiteti.

Sipas projektligjit, subjektet private dhe publike që veprojnë në këtë sektor do të raportojnë pagesat dhe informacionin e kërkuar nga akti rregullator sekondar që do të shoqërojë ligjin për qëllimin e raportimit të EITI jo më vonë se më 31 mars të vitit pasardhës kalendarik. Përveç flukseve të pagesave, subjektet publike rregullatore do të raportojnë mbi baza të vazhdueshme të tjera informacione kontekstuale mbi rregullimin dhe aktivitetin e sektorit.

Kuadri rregullator në fuqi nuk parashikon formën e raportimit të pagesave dhe informacionit kontekstual. Një model raportimi fillestar për sektorin minerar u miratua me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 233 datë 23 mars 2011. Për shkak se është hartuar dhe miratuar përpara hyrjes në fuqi të Standardit të ri EITI në vitin 2016, modeli nuk parashikon shumë kërkesa të reja si raportimi i të dhënave të detajuara për çdo shoqëri / licencë dhe procesi i verifikimit të të dhënave.

Për të qënë në përputhje me klauzolat e konfidencialitetit, format e raportimit u përditësuan për të përfshirë dhënien e autorizimit nga i licencuari:

- për institucionet publike që mbledhin të ardhurat për të raportuar pagesat e marra, të cilat klasifikohen si informacion konfidencial sipas ligjeve, rregulloreve dhe marrëveshjeve në fuqi;
